

# STRATEGJIA TERRITORIALE
# VIZIONI STRATEGJIK
# OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT

## PLANI I PERGJITHSHEM VENDOR
## BASHKIA SHKODER

2015-2030

**Univesiteti Polis**
**Arizona State University**
**Metropolis sh.p.k**
**Bashkia Shkodër**

## Autorësia dhe kontributet

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Shkodër me mbështetjen teknike të Universitetit POLIS, MetroPOLIS Sh.p.k, Arizona State University, nën drejtimin e kryetares të bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.


**Grupi i punës:**
Prof. Dr. Besnik Aliaj, Dr. Sotir Dhamo, Prof. Dr. Sherfi Lushaj, Dr. Godiva Rembeci, Dr. Ledian Bregasi, Dr. Braden Kay, Prof. Dr. David Pijawka, Michael Underhill, Prof. Dr. David Swindell, Akheil Singa, Elona Karafili, Mikail Chester, Rob Pahle, Ledio Allkja, Artan Kacani, Amanda Terpo, Iva Tavanxhiu, Sindi Haxhija, Besjana Qaja, Ina Brata, Alda Subashi, Sadmira Malaj, Prof. Dr. Molnar Kolaneci, Michiel Van Driessche, Deborah Lambert

Bashkia Shkodër: Znj. Voltana Ademi, Z. Dritan Meta, Z. Arben Gjuraj, Taulant Dibra, Aljon Koçkiçi, Kreshnik Kopliku, Aida Shllaku.



Falenderojmë Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër për ofrimin e hapësirave për zhvillimin e dëgjesave publike, Z. Sulejman Vekshari për kontributin me anë të studimit të tij, qytetarët e Shkodrës për pjesëmarrjen aktive dhe konstruktive në procesin e hartimit të PPV, të gjitha OJF/OJQ lokale të cilat kanë ndihmuar në këtë process me anë të ideve dhe vënies në dispozicion të studimeve.

# Përmbajtja


Autorësia dhe kontributet ........ 2

**Kapitulli 1- Hyrje ........ 5**

1.2 Parimet e Planifikimit për Strategjinë e Bashkisë Shkodër ........ 6

1.3 Procesi ........ 7

**Kapitulli 2- Implikimet nga PPK, PINS Bregdeti, Analiza Metabolike dhe SWOT, Skenarët ........ 9**

2.1 Përcaktime nga PPK ........ 9

2.2 Përcaktime nga PINS BREGDETI ........ 20

2.3 Direktivat Sektoriale ........ 25

Direktiva nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ........ 25

Direktiva nga Ministria e Mjedisit ........ 27

Direktiva nga Ministria e Zhvillimit Urban ........ 28

Direktiva nga Ministria e Punëve të Brendshme ........ 29

2.4 Analiza Metabolike e Territorit ........ 31

2.4.1 Fluksi i mbetjeve ........ 31

2.4.2 Fluksi i Energjisë ........ 32

2.4.3 Fluksi i Ujit ........ 35

2.4.4 Fluksi i Ushqimit ........ 37

2.4.5 Konkluzionet ........ 39

2.5 Analiza S.W.O.T ........ 39

2.6 Skenarët Territoriale ........ 44

**Kapitulli 3- Vizioni dhe Objektivat dhe Sistemet ........ 51**

3.2 Objetivat Strategjike ........ 53

3.3 Sistemet Territoriale ........ 59

**Kapitulli 4- Programet dhe Politikat dhe Konsiderata Financiare ........ 66**

**Kapitulli 5- Plani i Veprimit dhe Konsiderata Financiare ........ 110**

5.1 Konsiderata Financiare ........ 110

5.2 Plani i Veprimeve ........ 111

5.3 Fishat e Projekteve Prioritare ........ 142

**Kapitulli 6- Monitorimi dhe implementimi ........ 183**

**Shtojca 1 – Raport mbi degjesta dhe konsultimet ........ 188**

Takime Nderkufitare. ........ 188

Raporti mbi komunikimin dhe pjesmarrjen e qytetareve ne procesin e hartimit te PPV Bashkia Shkoder ........ 189

Dëgjesat Publike ..... 189
Fokus Grupe ..... 196
Komunikimi në internet dhe me media ..... 206
Televizioni ..... 206
Komunikimi në Internet ..... 207
**Shtojca 2 – Projekt Fishat** ..... 214

## Kapitulli 1- Hyrje

Strategjia e Territoriale e Bashkisë Shkodër hartohet në bashkëpunim midis Bashkisë Shkodër, Universitetit POLIS, MetroPOLIS dhe Universitetit të Arizonës. Kjo strategji formon dokumentin bazë mbi të cilin do të hartohet Planin i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja e Zhvillimit. Strategjia ka si qëllim:

- Të ofrojë një vizion dhe drejtim konsistent, si dhe një vlerësim strategjik jo vetëm të asaj çka është e dëshirueshme, por edhe asaj që është e mundshme në kontekste të ndryshme.
- Të mbrojë të drejtat e njerëzve. Në momentin që njerëzit kanë akses në tokë, në fakt ata marrin disa të drejta dhe obligime. Eshtë e nevojshme që të menaxhohet ndryshimi në mënyrë të tillë që të drejtat dhe obligime të respektohen.
- Të mbrojë sistemet natyrore. Sistemet natyrore kanë kërkesat e tyre operacionale të cilat duhet të respektohen për të mbrojtur qëndrueshmërinë afat-gjatë të zhvillimit njerëzor dhe nëse duam të evitojmë degradimin mjedisor në shkallë të madhe.
- Të arritjë një përdorim eficent të burimeve, si toka, uji, energjia, financat, materialet e ndërtimit, aftësitë etj.
- Të arrijë një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimeve nga të gjitha sferat e qeverisjes.
- Të koordinojë veprimet dhe investimet: që të sigurojë impaktin pozitiv maksimal nga investimi i burime, është e nevojshme që investimet te koordinohen në hapesire dhe në kohë. Ky koordinim mund të jetë dy llojesh: koordinimi i formave të ndryshme të veprimeve dhe investimit nga autoritetet publike; si dhe një koordinim midis veprimeve publike dhe private;
- Të vendose prioritete. Të mundësojë krijimin "e rrugëve" të ndërmjetme që nevojat për zhvillim të një vendi të arrihen në mënyra të drejta.
- Të evitojë dublikimin e përpjekjeve nga departamente dhe sfera të ndryshme të qeverisjes.

Bazuar në VKM nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", neni 52 "Hartimi i Strategjisë Territoriale të njësisë vendore", Strategjia territoriale duhet të përmbajë të paktën:

1. *parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proces hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor;*
2. *analizën metabolike dhe vlerësimin e përgjithshëm të territorit të njësisë vendore;*
3. *përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;*
4. *identifikimin e problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme;*
5. *vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore;*
6. *objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore;*
7. *drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;*
8. *programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë;*
9. *planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve;*
10. *hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve;*
11. *hartën e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem*

## 1.2 Parimet e Planifikimit për Strategjinë e Bashkisë Shkodër

Në kuadër të hartimit të Strategjisë Territoriale të Bashkisë Shkodër, grupi i punës ka përcaktuar një sërë parimesh të cilat do të udhëheqin metodologjinë dhe më pas hartimin e strategjisë. Kjo gjë shërben për të garantuar cilësinë dhe për të pasur një përqasje sa më të hapur e transparente në planifikimin e territorit si dhe për të respektuar bazën ligjore e plotësuar qëllimet e një dokumenti kaq të rëndësishëm si Strategjia Territoriale. Si të tillë, parimet të cilat kanë udhëhequr punën për strategjinë territoriale janë si më poshtë:

- Parimi Demokratik

Qeverisja e mirë rezulton në mënyrë të ndërsjellë në një planifikim të qëndrueshëm. Planifikimi I territorit është një detyrë kryesore e qeverisjes dhe ndikon drejtpërsëdrejti në jetën e njerëzve. Eshtë e rëndësishme që vendimet e planifikimit të hartohen dhe të merren me autoritet legjitime nga "organet të cilat janë të përgjegjshme, me anë të proceseve demokratike". Këto vendime duhet të jenë transparente, të ligjshme dhe që sigurojnë drejtësinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

- Parimi i Pjesëmarrjes

Procedurat efektive për përfshirjen e komunitetit do të përmirësojnë legjitimitetin e *vendimbërjes,* duke krijuar një ndjenjë të fortë të pronësisë lokale. Procesi i *vendimbërjes* duhet të jetë transparent, në mënyrë që të gjithë qytetarët të jenë në dijeni të arsyes së marrjes së vendimit dhe të ndikimit të tij mbi ta.

- Parimi i Integrimit dhe Bashkërendimit

Procedurat e planifikimit duhet të marrin në konsideratë integrimin dhe bashkërendimin e polikave dhe planeve, për të pasur një harmonizim sa më të mirë të zhvillimit të territorit. Integrimi duhet të ndodhë mes niveleve të qeverisjes, si dhe mes institucioneve, sektorëve dhe aktorëve brenda një niveli. Madje, e gjithë korniza *strategjike, institucionale dhe ligjore e planifikimit duhet të jetë e integruar.* Një ndryshim apo ndërmarrje sado e thjeshtë në dukje, për çështje të planifikimit, do të ketë ndikim në një sërë sektorësh dhe ligjesh të tjera. Një kornizë e integruar eleminon edhe mbivendosjet institucionale, ligjore dhe të kompetencave.

- Parimi i Proporcionalitetit

Ështё e nevojshme që planifikimi të dëshmojë për një *angazhim të fortë dhe udhërrëfyes të Qeverisë, në proceset zhvilluese*, në formën e politikave të qarta dhe robuste. Kjo kontribuon në krijimin e qartësisë dhe redukton rrezikun për të ardhmen. Mirëpo, në të njëjtën kohë, politikat *e planifikimit duhet të kenë fleksibilitet të mjaftueshëm,* për t'u adaptuar me ndryshimet ekonomike, sociale dhe teknologjike, si dhe për të stimuluar inovacionin. Gjithashtu, këto politika duhet të peshojnë interesat e palëve, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale dhe të garantojnë që *"ekuilibri midis interesave publike dhe private"* në zhvillimin e tokës, si dhe interpretimi dhe administrimi i saktë i të *"drejtës së zhvillimit",* të jenë pjesë integrale, e mendësisë dhe realitetit të zbatimit.

- Zhvillimi në bazë zone

Ky parim kthehet në një qasje të re për të eleminuar përfundimisht zhvillimin në bazë parcele, i cili nuk koordinohet me politikat e autoriteteve publike dhe thith në mënyrë të padrejtë të gjitha të drejtat e zhvillimit në një zonë.

- Zhvillimi ligjor i tokës dhe rikuperimi i vlerës së krijuar

Procesi i zhvillimit të një parcele përmes *të drejtës së zhvillimit, që vendos planifikimi,* krijon përfitim për pronarin ose zhvilluesin dhe kosto për territorin, pra bashkinë dhe si rezultat shoqërinë. Zhvillim i drejtë ndodh kur vlera e krijuar i kthehet atij që e krijon – pra shoqërisë, dhe përfituesi mbulon kostot e veprimit të tij.

- Evidentimi i të drejtës së zhvillimit, si një vlerë e shtuar mbi pronën dhe ndarja e tij prej të drejtës së pronësisë.

Ky parim aktualisht është i garantuar nga Kodi Civil dhe Kushtetuta, por ka mbetur i paqartë në legjislacionet sektoriale dhe të planifikimit dhe kjo paqartësi është reflektuar në proceset e zhvillimit të territorit në vite.

- Vendimarrja e drejtuar për qëndrueshmërinë

Zgjidh investime dhe politika të cilat promovojnë qëndrueshmërinë, jetueshmërinë dhe aftësitë për të përballuar presionet mjedisore, ekonomike dhe sociale.

- Investime Strategjike

Investo në infrastrukturë, programe dhe projekte të cilat shfaqin një ndikim të qartë tek qytetarët dhe zhvillimi ekonomik

- Politika efektive

Qeveris me theksin tek pjesëmarrja e qytetarëve, partneritetet të shëndetshme publike-private, dhe zbatueshmëri të vazhdueshme

## 1.3 Procesi

Procesi i Hartimit të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit është bazuar praktikën e "Planifikimit Strategjik". Në këtë kuadër, fillimisht janë shqyrtuar të gjitha dokumentet e planifikimit të hierarkive më të larta:

- Plani i Përgjithshëm Kombëtar
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin
- Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Euro Rajonin Adriatik – Jon EUSAIR (BE/Adrigov Operational Plan)
- Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020
- Plani i Menaxhimit të Alpeve IPA 2010
- Plani Rajonal Shkodër- Lezhë (EPTISA 2006)
- Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis (REC)
- Studim mbi zonat funksionale në Shqipëri (DLDP)
- Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal (GIZ/ Këshilli i Qarkut Shkodër)
- "Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër" (2015)
- Strategjia Kombëtare e Strehimit Social 2015-2025
- Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020
- Ligji Nr. 8756 datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile"
- Strategjia Kombëtare e RSH për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Mbrojtjen Civile, 2014-2018
- Programi për Zhvillimin Rural (Ministria e Bujqësisë)
- Programi për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Blegtorisë
- Programi për Prodhimin Organik Bujqësor
- Strategjia Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim 2015-2020

Më pas janë analizuar të gjitha planet vendor të hartuar për njësitë administrative të bashkisë Shkodër:

- Plani Rregullues i qytetit të Shkodres 1994
- Studim urbanistik pjesor - Qendra e qytetit të Shkodrës
- Projekti për zhvillimin e zonës liqenore të qytetit të Shkodrës
- Plan rregullues i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës
- Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër (2010)
- Plani i Përgjithshëm Vendor Komuna Rrethinat (2013)
- Plani i Përgjithshëm Vendor Velipojë (2015)
- Plani i Zhvillimit Komuna Dajç (2009)
- Plani i Zhvillimit Komuna Gur i Zi (2009)

Pas studimit dhe vlerësimit të materialeve të mësipërme dhe strategjive përkatëse, grupi i punës është thelluar më tej në analizat e gjeneruara me anë të sistemit GIS në bazë të parashikimeve. Ndërkohë, grupi i punës është angazhuar në një sërë takimesh dhe konsultash në vende të ndryshme të bashkisë Shkodër me aktorë dhe palë të ndryshme të interesuara. Përtej dëgjesës së parë publike, të hapur për qytetarët, grupi i punës ka zhvilluar konsulta intensive me grupe të ndryshme interesi në lidhje me strategjinë dhe me projektet. Në këtë kontekst janë zhvilluar 3 konsulta, në zonën e Postribës ku të ftuar ishin pjesëtarë të njësive administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Theksi i kësaj konsulte ka qënë zhvillimi rural në zonat malore. Takim konsultativ në Dajç me përfaqësues të njësive administrative Dajç, Rrethina, Ana e Malit, Bërdicë dhe Gur i Zi. Diskutimi është bazuar tek zhvillimi rural dhe bujqësia. Takim Konsultativ në njësinë administrative Velipojë. Në këtë takim është diskutuar mbi zhvillimin e turizmit bregdetar dhe më tej mbi zhvillimin e Velipojës si një qëndër e specializuar për turizmin.

Takim Konsultativ me grupime të agjencive, drejtorive të ndryshme rajonale, muzeve dhe shoqatave me karakter social të cilat operojnë në Shkodër. Në këtë takim, rëndësia është vendosur tek zhvillimi i turizmit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe shërbimet sociale. Takim me grupin e interesit të të rinjve të Shkodrës dhe me organizata jo fitimprurëse. Në këtë takim në fokus kanë qënë nevojat e të rinjve për të rritur atraktivitetin e Shkodrës dhe në lidhje me ekonominë e të ardhmes.

Në mënyrë që të arrihet një gamë sa më e gjerë e qytetarëve, grupi i punës ka zhvilluar dhe një pyetësor "online" në lidhje me shërbimet publike e sociale të cilat ofrohen në bashkinë Shkodër, punësimin dhe ekonominë, si dhe me pyetje mbi problematikat, mundësitë e zhvillimit të Shkodrës, projektet të cilat qytetarët e Shkodrës do të dëshironin dhe në fund vizionin e tyre për Shkodrën në 2030. Mbledhja e të dhënave cilësorë dhe sasiore me anë të këtij pyetësori si dhe në konsultat me grupet e interesit është shumë e rëndësishme për parashikimet e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të territorit. ( imazhe gjate takimeve )

Gjithashtu janë zhvilluar dy takime me bashkitë dhe grupi interesi ndërkufitare. Takimi i parë u organizua nga Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Planifikimit në Mal të Zi. Në këtë takim ishin pjesëmarrës disa përfaqësues të enteve të ndryshme publike në Shqipëri e Mal të Zi si dhe grupet e konsulentëve për hartimin e planeve vendore. Takimi i parë kishte më shumë karakter njohës me planet përkatëse. Ndërkohë, me iniciativë të grupit konsulent të U_POLIS, METROPOLIS dhe ASU u kërkua dhe zhvillua një takim i dytë në Podgoricë me studiot të cilat po hartonin planet përkatëse të Malit të Zi, të Rajonit të Bregdetit dhe të Alpeve. Në këtë takim u diskutua në nivel më konkret për projekte dhe politika të përbashkëta.

Gjithashtu, janë zhvilluar dhe takime konsultuese me ente të tjera publike si Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM). – Z. Julian Beqiraj, Drejtoria mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore, Z. Ridvan Bushati (Drejtoria e Basenit "Drin" e "Bune"), Z. Martin Pellumbi (Drejtoria e Bujqësisë Shkodër), Z.Fiqiret Xhabiaj. - Eduard Terthora (Drejtoria Rajonale e Mjedisit), Autoriteti Rrugor Shqiptar- Holta Dedaj dhe Simon Prendi. Përtej konsultimit me ente publike, janë zhvilluar dhe disa takime dhe konsultime edhe me persona të aktivizuar në Shkodër si Prof Ahme Osja, Mark Rupa, biznese dhe shoqëri civile.

Gjithashtu, janë shfrytëzuar dhe ndjekur konsultime të tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë për hartimin e buxhetit "Financat Vendore" (Keshill Bashkiak), aktivitete si “"Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" (Këshill Bashkiak), "Konferenca e Turizmit në Shkodër".

Përtej takimeve publike grupi ka qënë aktiv edhe në media për të shpërndarë informacionin mbi hartimin e planit të përgjithshëm vendor në Shkodër. Në këtë sens, të gjitha konsultimet publike janë ndjekur dhe transmetuar live nga mediat lokale. Gjithashtu, janë zhvilluar dhe dy emisione televezive në media lokale për të diskutuar mbi Planin e Përgjithshëm Vendor. **Për një informacion më të zgjeruar mbi procesin e konsultimeve dhe përfshirjes bashkangjitur këtij dokumenti është Shtojca II e cila detajon secilin prej hapave të sipërpërmendur.**

## Kapitulli 2- Implikimet nga PPK, PINS Bregdeti, Analiza Metabolike dhe SWOT, Skenarët

## 2.1 Përcaktime nga PPK

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030", është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë.



V*izioni i PPK Shqipëria 2030*

*"Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkuruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtje të trashëgimisë*

*natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion autentik."( nje imazh )*

Objektiva Strategjike dhe Parashikime për Lidhjen e Shqipërisë me Europën të cilat kanë një implikim edhe në Bashkinë Shkodër:
- **Korridori i Gjelbert** (Realizimi i lidhjes midis Malit të Zi dhe Greqise nga Hani I Hotit në Shkoder dhe Gjiokaster permes pikes kufitare Kakavija, me një gjatesi prej 405 km)
- **Korridori Blu** (rrugë bregdetare turistike me impakt të ulet mjedisor që lidh lokalitetet e bregdetit: Velipoje – Shengjin, Shengjin – Patok, Patok – Durrës , Durrës – Divjake, Divjake – Seman , Seman – Vlore , Vlore – Dhermi, Dhermi – Sarandë, Sarandë – Butrint
-**Ristrukturimin e sistemit hekurudhor** për linjat kombëtare që nalidhin me Maqedoninë e Malin e Zi, rrjetin BallkanEurope.
-**Ndërtimin e linjave hekurudhore** për të perkrahur lëvizjen ndërqytetase për distanca të largëta dhe lëvizjen ndërkufitare.
- **Krijimi i sistemeve multimodale**:
**- Korridoret energjitike të rëndësisë kombëtare e ndërkombëtare të cilat impaktojnë në bashkinë Shkodër:**

**IAP - Ionian Adriatik Pipeline**. Do të kalojë në pjesën perëndimore të Shqipërisë, nga Fieri në Shkodër për të furnizuar Malin e Zi (ulqin Podgoricë), Bosnjën e Kroacinë;

**IAP-KOSOVË**. IAP degëzohet në rajonin Shkodër - Lezhë, për të furnizuar Kosovën nëpërmjet Kukësit, duke realizuar Unazën Perëndimore të Ballkanit (Ëestern Ballkan Ring -ËBR);

PPK gjithashtu ofron disa drejtime dhe direktiva përsa i përket rajonit Bregdetar dhe zhvillimit të potencialit rural. Në këtë kontekst, përsa i përket impaktit në bashkinë Shkodër mund të deduktohet si më poshtë vijon:

Hapësira e **Rajonit Bregdetar** të vendit njihet nga PPK si rajoni kyç, me rëndësi Kombëtare për nga zhvillimi i qëndrueshëm që duhet të ofrojë, rolin parësor që ka në sektorin e turizmit, energjisë, bujqësise dhe infrastrukturës. ***Në këtë rajon ndërhyrjet duhen zhvilluar me karakter konseervues për zonat me rendesi të trashëgimisë historike kulturore dhe mjedisore, konsolidim për zonat e formuara nga morfologjia urbane dhe me mundësi rizhvillimi për zonat e urbanizuara rishtazi por pa cilësinë e duhur dhe densifikimin e zonave urbane ekzistuese brenda kapacitetit mbajtës së tyre pa cënuar tiparet karakterisitike të peisazhit natyror dhe historik***.

Ndërkohë PPK nënvizon mënyrat nën të cilat mund të **zhvillohet potenciali rural** ***duke përforcuar tiparet e turizmit sipas karakteristikave lokale të zones, duke zhvilluar bujqësine si fuqizim i sipërmarrjeve lokale, fuqizimi dhe diversifikimi i shërbimeve të tyre, zhvillimi i marinave, me synimin që qendrat lokale dhe lokalitetet brenda qyteteve terciare rrisin rëndësinë e tyre si fokus për investime lokale, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe strehimin***.
**PPK gjithashtu ofron disa konstatime dhe orientime të cilat impaktojnë edhe në Bashkinë Shkodër ndër të cilat më të rëndësishme janë:**

- Forcimi i masës kritike të **Qyteteve Porta** si **Shkodër**-Lezhe,Kukësi, Durrësi, Vlora, Gjirokastër-Sarandë është thelbesore në mbështëtje të zhvillimit policentrik të territorit por edhe në rolin mbështëtes që keto qytete do të ofrojne për zhvillimin ekonomik të balancuar të vendit.

Ndërkohë tiparet kryesore të qëndrave primare urbane në të cilat përfshihen Shkodër, Lezhë, Kukës, Peshkopi, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë. Në Qendrat Primare Urbane duhet të përqendrohen funksionet me rendesi primare të kujdesit, të shërbimit të përgjithshëm e të specializuar, me rëndësi në të gjithë territorin Kombëtar. Këto janë kryesisht:

- Funksione ekonomike dhe të qendrave të banimit,
- Funksione të nyjave të rëndësishme të qarkullimit.
- Funksione të tregtisë me shumicë dhe pakicë,

- Funksione kulturore dhe të rekreacionit,
- Funksione administrative,
- Funksione arsimore, shkencore, shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale.
- Në Qendrat Primare Urbane, ofertat ekzistuese për funksionet e mesipërme duhet të sigurohen në përputhje me potencialin e kërkesës, dhe në raste të veçanta duhet të sigurohet kualifikimi i nevojshëm për realizimin e tyre.
- *Vizionin PPK 2030, propozon nderhyrje konsoliduese, perforcuese, rigjeneruese, kooperuese dhe fuqizuese për qendrat urbane.*
    - Konsolidim dhe Rigjenerim- Metropoli, Qendrat Primare Urbane
    - Perforcim dhe Rigjenerim - Qendrat terciare Urbane Qendrore
    - **Fuqizim dhe Rigjenerim -** Qytetet Porta dhe Qendrat Urbane Lindore
    - Kooperim - në nivel Kombëtar

Përsa i përket sistemit natyror PPK synon të arrijë zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit natyror me anë të politikave të tilla si: ( nje harte )

- rritja e përgjegjësise kombëtare e ndërkombëtare për brezat e sotëm dhe të ardhshëm i cili kombinon konceptet e qëndrueshmërisë dhe administrim të mire,
- Mbrojtje dhe Rritje e zonave të mbrojtura natyrore,
- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm e komunikativ mjedisor
- rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit, Integrimi I sistemit natyror në vleren ekonomike të sektoreve të zhvillimit
- rritja e rolit të mjedisit në cilesine e jetes urbane permes promovimit dhe krijimit të aksesit të pershtatshem ndaj zonave natyrore

Vizioni për sistemin natyror dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në PPK përcaktohet si më poshtë vijon: ***"Zonat e Mbrojtura në Shqipëri kthehen në territore për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës e biodiversitetit, duke promovuar vlerat e tyre të shumëllojshme (turistike/rekreative, kulturore, gastronomike, estetike, pejsazhistike, shëndetësore, shpirtërore, etj.), në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm me ndikim pozitiv të komuniteteve lokale dhe rritjes së mirëqënies së tyre."***




Në kuadër të sistemit natyror, PPK ofron gjithashtu direktiva edhe përsa i përket mbetjeve, ujit, pyjeve dhe ajrit si më poshtë:

- **Mbetjet**
  - *Rritja e sasise së mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45% ;*

- *Riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane në masën 55 %*
- *Zbatimi i planeve të rehabilitimit për 9 hospotet prioritare dhe hartimi i planeve për hotspotet e mbetura.*

- **Uji**
  - *Te realizohet mbrojtja dhe permirësimi i cilësisë së ujërave nëpermjet zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda vitit 2020;*
  - *Monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujërave sipërfaqesore dhe nentokësore nga institucionet pergjegjese në bashkëpunim me MM.*
  - *Rehabilitimi i shtretërve të dëmtuar të lumenjeve me 25 % deri në vitin 2020;*
  - *Menaxhimi i ujërave sipërfaqesore dhe nentokësore me qëllim reduktimin 95 % kraHasuar me vitin 2011 të ndotjes se tyre,*
- **Pyjet**
  - *Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore;*
  - *Gjithëpërfshirja e aktorve lokal në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori*
  - *Vendosja e skemave për pagesa në ekosistem*
  - *Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve*
  - *te arrihet transpozimi i plote i plote (100 %) i legjislacionit europian, në fushën e pyjeve*
  - *Mbulimi 100% me plane mbarështrimi për të gjitha ekonomitë pyjore në nivel kombëtar*
  - *Ulja me 40% të prerjeve të paligjshmeve të fondit pyjor*
  - *Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzim të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimin e kullotave me mbjellje foragjerë e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020.*
  - *Parandalimit të gërryerjes se mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore në 25 % të sipërfaqes, deri në 2020*
- ***Ajri***
  - *Ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane;*
  - *Arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NOx - 40 $\mu/m^3$, për PM10 - 40 $\mu/m^3$, për PM2,5-25 µg/m3 dhe 20 µg/m3 dhe SO2-125 $\mu/m^3$ për 24 orë ose 20 $\mu/m^3$ në vit*

Përsa i përket Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Plani i Përgjithshëm Kombëtar ka tre objektiva kryesore të shoqëruara me politika dhe direktiva të cilat kanë një impakt edhe në politikat e aplikuara në Bashkinë Shkodër si rrjedhojë e territorit të madh me tokë bujqësore nën juridksionin e saj:




***Objektivi 1 - Eficience për një sektor bujqësor konkurues***

*Politikat që mbështet Plani Kombëtar në këtë drejtim janë:*

*- Ruajtje*

*- Konsolidim*

*- Modernizim*

Për arritjen e objektivit të mësipërm janë parashikuar:

- Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore _ me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban. Me miratimin e Planit Kombëtar 2030 nuk lejohen ndërtime të reja në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor.
- Vendosja e një rrjeti të sukseshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhimi- grumbullim- perpunim- eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.
- Ulja e kostos dhe rritje e cilësisë nëpërmjet investimeve në teknoligjinë e prodhimit për modernizimin e saj; investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale ujitëse, vaditëse, hidrovore.
- Bujqësi-Turizem- ku veçantia e sektorit turistik shqipëtar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
- Bujqësi- Transport— infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore.
- Bujqësi – Energji- ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.
- **Krijimi i qendrave/ poleve bujqësore** dhe Profilizimi i këtyre të fundit sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor
- **Krijimi i markave të produkteve karakteristike bujqësore** shqipëtare Made in Albania. Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqipëtare.
    - Bimë Mjekësore
    - Pemë frutore arrore
    - Ullinj dhe Vreshta
    - Perime karakteristike të vendit
    - Produkteve bujqësore të përpunuara

**Objektivi 2- Zhvillimi i Poleve Bujqësore / Agro-Përpunim**
(**Shkoder**, Tiranë, Sarandë, Korçe, Lushnje) "**Prodhim + Grumbullim + Përpunim + Tregtim**"
Këto qëndra bujqësore rekomandohen minimalisht të permbushin shërbimet e mëposhteme:

- Posedimin dhe ofrimin e hapesirave të mjaftueshme depozitimi për të përballuar sasine e prodhimit bujqësore në stinat perkatese
- Posedimin dhe ofrimin e kushteve dhe teknologjive perkatese për agro-perpunimin e produkteve bujqësore duke mundesuar njeherazi proçesin e kontrollimit të cilesise se ushqimit sipas standarteve të Bashkimit Europian
- Alokimin e dhomave laboratorike ku specifikisht për secilen kulture bujqësore të miren kampjone dhe të analizohet gjendja fizike e tyre
- Posedimin e teknologjive të avancuara në fushen e kërkimit dhe të zhvillimit të farave dhe fidaneve me qëllim zhvillimin e sektorit bujqësore në ritmet e Bashkimit Europian
- Posedimin e mundësive teknike dhe të personave të specializuar në fushën e marketingut të produktit bujqësore

**Objektiva 3 Bio-Bujqësia / Bujqësia Organike**
Bujqësia organike në vendin tonë, falë kushteve klimatike, gjeomorfologjisë së tokës bujqësore si dhe njohurive tradicionale të fermerëve vendas posedon avantazhe shumë të favorshme për tu zgjeruar dhe rritur akoma me shumë si nëndegë e sektorit të bujqësise. Tregu mesdhetare apo dhe ai Europian për shkak të zhvillimit të turizmit kulinare dhe elitare shfaq tendenca pozitive në konsumimin gjithmone e me teper të produkteve bio-organike.

Plani i përgjithshëm kombëtar gjithashtu jep disa direktiva në lidhje me sistemi ujor të cilat kanë implikime direkte edhe në Bashkinë Shkodër:

- **Rekomandime lidhur me problematikat e menazhimit**
    - Shfrytëzim racional i ujrave duke ruajtur balancën e abstragim/rimbushje të aquiferit
    - Kontrolli i Aktivitete ilegale

    - Hartimi i Politikave të qarta të zhvillimit sektorial që impaktojnë Sistemin Ujor
    - Koordinim midis institucioneve në nivel lokal, rajonal dhe qendror
    - Përmirësime në kuadrin ligjor përsa i përket monitorimit
- **Rekomandime lidhur me problematikat me sasinë e ujrave**
    - Investime në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive mbi burimet ujore dhe në veçanti të shtresave gjeologjike dhe kufijve të akuiferave
    - Shfrytëzim i qëndrueshëm i ujrave nëntokësore, duke përfshirë këtu edhe shpimet e pakontrolluara
    - Ruajtja e ujëmbledhësve nga precipitime të shirave për përdorim bujqësor
- **Rekomandime lidhur me problematikat e ndotjes**

Është konstatuar se aktivitetet njerëzore dhe burimet natyrore së bashku janë shkaku kryesor për ndotjen e ujërave nëntokësore të cilat shoqërohen me efekte negative afatgjatë në ujin nëntokësor. Sado të vogla qofshin këto burime ndotje fakt është që heqja e ndotësve nga uji nëntokësor është e vështirë, prandaj pastrimi i ujit ka kosto të lartë. Pavarësisht nga distanca, një burim potencial ndotje nuk duhet të vendoset mbi lartësin e pusit. Duhet patur parasysh që mënyra e ndërtimit të pusit dhe vendosjae tij mund të jenë premisëqëtë ndodhë ndotja me nitrate, por ato nuk janëshkaku ivetëm I ndotjes. Rekomandimet i referohen ndotjeve nga burime të ndryshme të cilat kane impakt shume të madh në cilesine e burimeve ujore. Shkaktaret kryesore ndotes janë identifikuar si: menaxhimi keq i infrastruktures se trajtimit të ujrave, zona të kufizuara sanitare, praktika të paqëndrueshme bujqësore dhe shpimine të paligjshme si shkaqet kryesore. Për këtë planet Sektoriale, Rajonale e Vendore duhet të reflektojne masa konkrete të mbrojtjes se Sistemit Ujor nga:

- Ndotja nga ujrat e zeza
- Ndotja nga aktivitetet bujqësore
- Ndotja nga minierat
- Ndotja nga sipërfaqet dhe ujrat nderkufitare me shtetet e tjera
- Ndotja nga grumbullimet e plehrave urbane
- Ndotja nga aktivitete ilegale
- Dëmtimi i shtreterve të lumenjve
- Shpimet ilegale
- Zonat industriale në shtetet nderkufitare
- Përdorimi i pesticideve dhe plehrat kimike
- Ndotja nga landfillet
- Sipërfaqe të kufizuara (te vogla) mbrojtjeje
- Trajtimi i keq ose aspak i ujrave të ndotur nga përdorimet; urbane, industriale, bujqësore
- Shfrytezim intensiv I inerteve të lumit,
- Venddepozitime të mbetjeve urbane
- Aktivitet bujqësor e industrial I konsiderueshem.

Gjithashtu PPK parashikon edhe dy rregulla kryesore përsa i përket mbrojtjes së burimeve ujore:

- 200m distance nga vija e bregut detar dhe njëkohësisht izoipsin 2m për bregdetin fushor dhe izoipsin 60m për bregetin shkembor.
- Për rrjedhat lumore 100m distance nga bregu i lumit ndalim i cdo aktiviteti, dhe 1km brezi i korridoreve natyrore që shoqerojne rrjedhen e tyre ruhet vetëm për përdorim me perparesi natyren.

Përsa i përket transportit rrugor dhe atij hekurudhore PPK parashikon si më poshtë korridoret strategjike të cilat prekin edhe bashkinë Shkodër:

- **Korridori Veri Jug** - [**Shkodër (Hani i Hotit**) – Gjirokastër] siguron përshkueshmërinë e shpejtë të territorit dhe lidhjen me vendet e Ballkanit perëndimor dhe të Europës Jug-Lindore. Ky korridor do të perforcohet nga rivitalizimi i linjes hekurudhore ekzistuese dhe permiresimi i saj.

- **Korridori Blu** –[Velipoje – Shengjin - Patok - Durrës - Divjake - Seman - Vlore -Dhermi - Sarandë - Butrint] një nga lidhjet me strategjike për sa i perket forcimit të ekonomise se turizmit bregdetar të vendit dhe agro turizmit. Rruga do të jete e tipit peisazhistik, me impakt të ulet në mjedis (jo e projektuar për trafik të rende) që pajiset me infrastrukturën e duhur në nyjet kryesore lidhese-stacionuese që perkojne me qendra lokale apo lakalitete të rendesishme pergjate ketij itinerari. Vlen të theksohet se për shkak të ndjeshmerises se larte mjedisore të zonave ku pritet të kalojne segmente të caktuara të ketij itinerari, duhet të tregohet kujdes i vecante në projektimin e brezave të gjelberimit pergjate tij.




**Përsa i përket transporti hekurudhor PPK** parashikon rëndësinë **e** rigjenerimit dhe në ngritjen e një sistemi hekurudhor të qëndrueshëm e gjejme tek objektivat kryesore të Dokumentave strategjike të BE në llidhje me transportin:

- Mbi 50% e mallrava që transportohen në rruge me të gjata se 300km të drejt hekurudhës ose tragetit (30% deri 2030)

- Kalimin e 50% të transportit qytetar nga nepermjet rrugeve në përdorimin e trenave.
- Trefishimi i gajtesise se linjave hekurudhore për trenat e shpejte deri në 2030 duke nderhyre edhe në ndryshimin e kudrit ligjor që do të mundesoje këtë fakt.
- Krijimi i një sistemi multimodal plotesisht funksional duke eliminuar barrierat.

Nga dokumenti MTI, Projektet Prioritare për Infratrukturen e Transportit 2014, për fushen e e transportit hekurudhor është parashikuar edhe rigjenerimi i korridorit **Durrës - Hani Hotit (Montenegro Border)**

**Plani i përgjithshëm kombëtar parashikon edhe disa direktiva përsa i përket rajonalizimit. Në këtë kontekst Bashkia Shkodër shihet si pjesë e zonës funksionale ekonomike Shkodër Lezhë.** *Përsa i përket këtij rajoni, PPK ka parashikimet e mëposhtme:*

- Referuar Sistemit Urban, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:
  - Hierarkinë e qendrave sipas bashkive duke marrë parasysh ndryshimet territoriale pas ndarjes administrative të vitit 2014, ku propozohen Bashkitë Shkodër dhe Lezhë si Qendra Parësore dhe bashkitë e tjera si Qendra Terciare.
  - Konsolidimin e qendrave dhe densifikimine zonave urbane/suburbane si Rrethina, Shëngjin, Zejmen, Shenkoll, Kolç, Mamurras, Milot etj për të frenuar shpërhapjen urbane dhe informalitetin.
- Referuar Sistemit Natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:
  - *Rritjen* e sipërfaqes së *Zonave të Mbrojtura*, duke i shtuar *Rrjetin Emerald* (Kune Vain, Patok-Ishëm, Bërzanë, Vermosh, Lëpushë, Bogë, Razëm, Tamarë, Nikc.
  - Marrjen në mbrojtje të *Lumit Bunë* dhe zonës përreth saj me statusin e *Parkut Kombëtar*.
  - Shpallja dhe Promovimi i *Parkut Kombëtar të Alpeve* edhe si *Park* me rëndësi *Rajonale dhe hartimin e politikave dhe instrumentave financiare per nxitjen e zhvillimit te turizmit malor elitar.*
  - Përgjatë luginave të lumenjve dhe ekosistemeve të tyre, të shtrihen *Korridoret Natyrore.*
- *Referuar Sistemit Ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:*
  - *Përcaktimin e Vijës Blu* dhe respektimin *strikt* të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe Rregullores se Planifikimit korrik 2015, në mënyrë që të mbrohen ujërat dhe ekosistemet e tyre.

- *Qendrat Parësore* dhe *Dytësore* duhet të pajisen me *impiant të trajtimit të ujërave të ndotur*, përpos 3 impianteve ekzistues/të planifikuar Shkodër, Lezhë-Shëngjin dhe Velipojë (Raportet Vjetore ERRU), në mënyrë që brenda vitit 2030 të mos derdhen më ujëra të zeza në lumenjë, det dhe të rritet cilësia e baseneve.
  - Mbulimi me shërbimin e *ujësjellësit dhe kanalizimeve* për *zonat turistike dhe suburbane*.
- *Itinerarin turistik vozitës lumor-liqenor*, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ: Vau i Dejës- Liqeni i Shkodrës- Pulaj- Ishulli i Bojanës.
- *Referuar Sistemit Bujqësor:*
  - *Krijimin e një tregu rajonal bujqësor*që do të plotësojë zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim).
- *Ne lidhje me Infrastrukturën e Transportit:*
  - Zhvillimin e Qendrës Parësore të *Shkodrës dhe Lezhës si dy QytetePorta*, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugeve Kombëtare që ofrojnë, si dhe zhvillimin e qendrave *Bajzë, Koplik, Lac* si *Hub-e logjistike*, për rolin kryesor, pozicionin kufitar që kanë si pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe stacione me rendesi për njerez dhemallra.
  - Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Shëngjinit si nyje shumë e rëndësishme për polin ekonomik Shkodër-Lezhë.

- *Integrimin* dhe *funksionimin me kapacitet të plotë sipas modalitetevet*ë stacioneve të rrjetit hekurudhor: *Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë, Milot* si stacione mallrash, *Shkodër, Lezhë* si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë: *Mjedë, Baqel, Lac, Gjorm, Mamurras.*

- *Itinerarin peisazhistik Blu* në këtë Zonë, përgjatë qendrave: Ulqin-Velipojë- Shëngjin- Lezhë-Kune Vain te paraprira nga projektet strategjike te MTI dhe MM.
- *Ndërtimin e tubacionit të gazit IAP,* i cili parashikohet të fillojë nga Fieri te pershkoje kete rajon per ne Malin e Zi në dy degezime; mbi dhe nen liqenin e Shkodres. Permes Malit të zi ka mundesine e lidhjes me Bosnjë– Hercegovinën dhe Kroacinë.
- Në përputhje me OST*, ndërtimin e nenstacioneve të reja në Koman dhë në Lezhë.* Në këtë të fundit janë parashikuar të kalojne edhe linjat 400 dhe 220kv që do të lidhin Shqipërine me Kosoven edhe Malin e Zi.
- Ndertimin e *Parkut Energjitik,* i cili do të përbëhet nga *2 parqe eolike* dhe *1 termocentral biomasë me* kapacitet vjetor prodhimi 1.1 Të h dhe 750 Gëh, perkatesisht*.*
- Vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e *diversifikimit të energjisë alternative*, duke sugjeruar këtu që rrezatimi prej 2700orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

**PPK parashikon edhe disa direktiva në lidhje me masat zbutese dhe adaptuese ndaj ndryshimeve klimatike të cilat duhet të ndërmerren në nivel vendor:**

- Gjate planifikimit te çdo ndertimi te ri apo zgjerimi te strukturave ekzistuese, duhet te kryhet nje analize ndjeshmerie e infrastruktures se parashikuar ne kushtet ekstreme te motit , dhe ne baze te rezultateve te saj, duhet te pergatitet nje plan masash per te reduktuar ne menyre te perhershme pasojat e ketyre fenomeneve;
- Zbatimi i masave per te reduktuar ndjeshmerine e infrastruktures ndaj kushteve ekstreme te motit duhet te behet nje detyre qendrore e menaxhimit te çdo lloj infrastrukture. Qellimi i zbatimit te ketyre masave duhet te bazohet sidomos ne reduktimin e demit te shkaktuar per perdoruesit e infrastruktures se ndjeshme ndaj motit, nese ata nuk mund ta perdorin ate; dhe
- Duhet te percaktohen qarte udhezimet per metodologjine, procedurat dhe realizimin e mbledhjes se informacionit mbi kushtet ekstreme te motit, si dhe per planifikimin dhe zbatimin e masave per te reduktuar ndjeshmerine e infrastruktures se parashikuar ndaj kushtet ekstreme te motit.

## 2.2 Përcaktime nga PINS BREGDETI

Plani i integruar ndërsektorial do të jetë kushtetuta e zhvillimit të rajonit të bregdetit, e cila do të garantojë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, integritet social, mbrojtje të ekologjisë dhe pasurive material e shpirtërore të shqiptarëve të të gjithë Shqipërisë e jo vetëm të rajonit bregdetar. Zona bregdetare është pasuri kombëtare dhe i përket të gjithëve dhe jo vetëm banorëve që jetojnë në atë territor. Kjo hapësirë bregdetare do të shihet si binom det-tokë aset i rëndësishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit mesdhetar. Hapësirë e mirëmenaxhuar ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokale me domosdoshmërinë e mbrojtjes së aseteve kulturore, natyrore dhe historike. Destinacion autentik, i shumëllojshëm dhe i pastër.

Më poshtë paraqiten objektivat e Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin sipas tematikave përkatëse të cilat shërbejnë si kuadër referues edhe për Bashkinë Shkdoër. Vlen të përmended se objektivat së bashku me politikat janë në terma të gjerë të cilat lejojnë për interpretim në bazë të kontekstit dhe analizës së detajuar të planit të përgjithshëm vendor.




**Tematika1- Urbanizimi**

**[OBJEKTIVI 1] -Orientimi drejt një zhvillimi të qëndrueshëm urban dhe mbrojtja e natyrës**

- Densifikimi i qendrave të banuara
- Policentrizmi (hierarkizimi i qëndrave)
- Mbulimi me infrastrukturë publike i qendrave urbane
- Zhvillim i kontrolluar

- Rigjenerim i ballinave ujore
- Ndalimi i informalitetit dhe integrimi/riinterpretimi i atij ekzistues

**[OBJEKTIVI 2] Rivitalizimi i lokaliteteve të vjetra në brendësi të territorit (objektiva)**

- Orientimi i zhvillimit në brendësi të territorit
- Integrimi i zhvillimeve turistike të reja (resortet) me potencialet në zhvillimet ekzistuese (fshatrat ekzistuese)

**[OBJEKTIVI 3] Ruajtja e arkitekturës tradicionale në zhvillimet e reja**

- Reabilitimi i ndërtesave tradicionale
- Subvencionimi i objekteve tradicionale
- Promovimi i vlerave kulturore në arkitekturë

## Tematika 2- Infrastruktura

**[OBJEKTIVI 1] Integrimi në rrjetin e infrastrukturës mesdhetare**

- Lidhja me koridorin blu (politike)
- Zhvillimi i projekteve ndërkufitare me Malin e Zi
- Integrimi i hekurudhës në rrjetin ndërkombëtar

**[OBJEKTIVI 2] Përmirësimi i aksesit dhe mbulimi me infrastrukturë publike nga bregdeti në qendrat e banuara në brendësi të territorit (përgjatë gjithë bregdetit)**

- Prioritarizimi i investimeve në infrastrukturë publike bazike sipas hierarkisë së qëndrave urbane (politike).

**[OBJEKTIVI 3] Aktivizimi i zonave potenciale natyrore, kulturore, mjedisore dhe sportive, përmes infrastrukturës së transportit publik të diversifikuar**

- Përdorimi i infrastrukturës soft (lehtë) në zonat e ndjeshme (natyrore/kulturore)
- Aplikimi i rrjetit unazor në infrastructure
- Nxitja dhe faciliteti i infrastrukturës për biçikleta dhe këmbësorë
- Ndërthurja e transportit detar me atë tokësor
- Krijimi i stacioneve multimodale
- Rivitalizimi i transportit hekurudhor

**[OBJEKTIVI 4] Rritja e transportit publik detar**

- Rivitalizimi i porteve dhe mole ekzistuese si stacione publike për transportin detar
- Nxitja e partneritetit publik dhe privat në zhvillimin e transportit detar

## Tematika 3- Energjia

**[OBJEKTIVI 1] Mbulimi vjetor dhe sezonal me energji elektrike i gjithë zonës bregdetare**

- Infrastruktura energjitike në bregdet, si një nga prioritetet e planit (politikë)

**[OBJEKTIVI 2] Përdorimi i energjisë së rinovueshme (objektiva)**

- Prioritet zhvillimit të parqeve fotovoltaike (politike)
- Mbështetja e iniciativave private dhe publike për këtë sektor (politikë)

**[OBJEKTIVI 3] Efiçencë energjitike në ndërtim**

- Përdorimi i teknikave të ndërtimit sipas kushteve klimatike të zones
- Promovimi i materialeve me efiçencë energjitike
- Rritja e efiçencës së energjisë elektrike

## Tematika 4- Ekonomia

**[OBJEKTIVI 1] Rritja ekonomike në brezin bregdetar (objektiva)**

- Përdorimi i qëndrueshëm i potencialeve të zonave bregdetare për të nxitur zhvillimin ekonomik
- Rritja e kapaciteteve lokale në sektorët ekonomik dominues
- Krijimi i grupimeve ekonomike që operojnë në të njëjtën fushë

**OBJEKTIVI 2] Rritja e avantazhit krahasues dhe konkurues (objektiva)**

- Promovimi i ekonomisë lokale
- Diversiteti i ekonomisë
- Rritje e efiçencës ekonomike përmes ekonomive të shkallës
- Zhvillimi i degëve inovative të ekonomisë

**[OBJEKTIVI 3] Zhvillimi i ekonomisë detare (akuakultura, kripore, peshkimi)**

- Krijimi i sistemit të grumbullimit, tregtimit dhe rrjetit shpërndarës të produkteve detare
- Çertifikimi i produkteve detare lokale
- Marketimi i produkteve detare

**[OBJEKTIVI 4] Përdorimi i potencialeve kulture/natyrë dhe i efekteve ndërlidhëse për rritjen ekonomike bregdetare dhe në brendësi të territorit.**

- Ndërlidhja e monumenteve përmes korridoreve natyrore
- Ngritja e infrastrukturave informuese, marketuese dhe orientuese për potencialet e bregdetit

## Tematika 5- Turizëm

**[OBJEKTIVI 1] Shndërrimi i bregdetit shqiptar në një destinacion unik (objektiva**

- Ruajtja e karaktereve të ndryshme të zonës bregdetare (politikë); ose Sigurimi i integritetit fizik territorial të bregdetit
- Promovimi i vlerave unike
- Mbrojtja dhe zhvillimi i turizmit në zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore (eco-turizëm/ turizëm kulturor)

**[OBJEKTIVI 2] Zgjatja e sezonit turistik (objektiva)**

- Diversiteti i paketës turistike (politikë)
- Nxitja e turizmit të alternuar (det, mal, lumë, kulturë)
- Zhvillimi i turizmit aventuresk dhe natyror në lokalitetet në brendësi të territorit (kalërim, lundrim, hiking)

**[OBJEKTIVI 3] Zhvillimi i llojeve të ndryshme të klasterave për turizmin (objektiva)**

- Zhvillimi i grupimeve ekonomike në sektorët me potencial më të lartë (Klaster në agroturizëm, eco-turizëm, dhe turizmin det-diell) (politikë)

## Tematika 6- Bujqësi

**[OBJEKTIVI 1] Forcimi i bujqësisë si një nga sektorët primar të ekonomisë së bregdetit**

- Mbrojtja e pesë shtresave bujqësore (tokë bujqësore /kullota /ullishte /vreshtari / tarraca frutore)
- Nxitja e ekonomisë së shkallës në bujqësi
- Çertifikimi dhe marketimi i produktit bujqësor
- Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemeve vaditëse për tokat bujqësore

**[OBJEKTIVI 2] Marketimi dhe shpërndarja e produkteve lokale**

- Subvencionimi i produkteve lokale (politikë)

## Tematika 7- Natyrë

**[OBJEKTIVI 1] Shtimi i zonave të mbrojtura natyrore (objektiva)**

- Kthimi i baseneve lumorë në korridore të gjelbërta natyrore (politikë)
- Percaktimi i zonës kufizuese të ndërtimit

**[OBJEKTIVI 2] Mbrojtja nga rreziqet natyrore (erozion/rrëshqitje/përmbytje, ndotje) (objektiva)**

- Pyllëzimi i zonave të rrezikuara
- Zhvillimi i infrastrukturave që minimizojnë rreziqet (hidrovore, impjante për trajtimin e ujrave të ndotura/mbetjeve)

**[OBJEKTIVI 3] Mbrojtja e peizazhit nga ndotja vizive, si rrjedhojë e infrastrukturës energjitike dhe telekomonikacionit**

- Përdorimi i teknikave dhe infrastrukturave pa/me impakt të ulët viziv ne peizazhin natyrorë

Përsa i përket zhvillimit rajonal, PINS Bregdeti e parashikon Shkodrën si pjesë e zonës së parë rajonale ku fokusi është në eko-turizëm dhe në natyrë. Në këtë kontekst, në zonën e parë rajonale përfshihet segmenti **Grukëderdhja e Bunës - Hamallaj (Durrës), në veri. Ky segment përfshin tre bashki, Shkodër, Lezhë dhe Kurbin.** Përsa i përket zhvillimit rajonal, paraqet këto direktiva të cilat duhet të merren në konsideratë nga planet te përgjithshme vendore:

-Vlerat, karakteri dhe sektorët e zhvilluar historikisht në këtë territor, që evidentohen si dominuese, më tepër se të tjerat, janë: **vlerat e shumta mjedisore**, me ekosisteme flore dhe faune shumë të pasura (katër zonat e mbrojtura mjedisore); aktivitetet ekonomike të zhvilluara lidhen me **sektorin e bujqësisë, peshkimit dhe blegtorisë.**

-Turizmi në këtë zonë është i alternuar, ditor në plazhet me gjatësi të shkurtër edhe p**ër të mbrojtur dhe ruajtur vlerat e zonave natyrore dhe mjedise me vlerë,** dhe sezonal, në plazhet me gjatësi më të madhe.

-Karakteri i zhvillimit të kësaj zone është **ekoturizmi.** Kjo nuk përjashton zhvillimin e tipologjive të tjera të turizmit, dhe aktiviteteve të tjera që janë të qëndrueshme dhe në respekt të mjedisit të kësaj zone lagunore; kontrobuti i të cilave do të sillte një zhvillim ekonomik vjetor të qëndrueshëm nga turizmi i kombinuar.

Ndërkohë, përsa i përket vetë Bashkisë Shkodër, më saktë për qëndrën e bashkisë, qytetin e Shkodrës përcaktohet si më poshtë:

*Funksione të rritjes urbane dhe ekonomike e orjentuar për qytetin e **Shkodrës,** në: turizmin eko si primare, për ta pasuruar më tejë me turizmin malor, kulturor, agroturizëm, peshkimin, bujqësinë, blegtorinë, turizmin sezonal det-diell, në mëyrë që si qendër kryesore të jetë dhe si katalizator për të incentivuar dhe gjeneruar aktivitetete të lidhura me të, te të gjitha qendrat inferiore dhe lokalitetet rreth e përqark sajë, në formën e një rrjeti aktivitetesh. Ky zhvillim duhet të vijë i alternuar, kombinuar dhe i shpërndarë në të gjitha lokalitetet e tjera, që do të përmendem më poshtë. Shkodra si qendër kryesore urbane duhet të ketë një akses shumë te mirë me transportin publik me lokalitetet bregdetare si Velipojë, dhe gjithashtu me lokalitetet rurale në brendësi të territorit, në drejtim të Alpeve, për të patur një shpërndarje të zhvillimit të qendrave urbane dhe lokalitetev të balancuar nga deti në drejtim të thellësisë së territorit dhe malit.*

Gjithashtu, PINS Bregdeti ofron edhe disa objektiva e politika orientuese përsa i përket zhvillimit të Bashkisë:

**-Objektivat**

- Njësi me zhvillim të orientuar urban, drejt qendrave ekzistuese, duke densifikuar e konsoliduar më parë këto qendra. E më pas duke përdorur territore të reja.
- Të zhvillojë sektorin e turismit –Eko dhe det-diell, përmes plazhit të Velipojës.
- Të mbrohet nga reziku i ndotjes, përmbytjes dhe reziqe të tjera natyrore dhe njerëzore.

**-Politikat**

- **Mbrojtje** e mjedisit dhe vlerave kulturore.
- **Promovim** i vlerave.
- **Masa konkrete** për mbrojtjen nga rreziqet natyrore. (impjant trajtimi i ujrave të ndotur, hidrovore, diga, etj)
- **Aksesim i vlerave** natyrore, kulturore përmes infrastrukturës me impakt të ulët në mjedisor.

Si konkluzion mund të thuhet se orientimet kryesore të PINS Bregdeti janë:

- Lidhjen me **Rruga Peisazhistik Bregdetar**; pra lidhja e infrastrukturave segmentare të transportit automobilistik përgjatë bregdetit shqipëtar, në një rrjet të vazhdueshëm me shërbime publike në fushën e turizmit, i cili lidh lokalitetet që janë më në afërsi me plazhet e territorit të Shqipërisë, dhe lehtëson aksesin nëpër asesetet, mjedisore, plazhe, asetet kulturore, agroturizmet, etj
- Lidhja e infrastrukturave lokale dhe vlerave natyrore, mes tyre, për të mundësuar aksesin që nga bregdeti (plazhin e Velipojes-lagunen Kune-Tale-Vajin monumente, mjedisi) në drejtim të brendësisë së territorit.
- Administrimi i transportit të kombinuar publik tokësor dhe detar, duke rivitalizuar të gjitha portet e vjetra të peshkimit, molet, ish portert militare, peshkimi dhe për ndërtimin e barkave, në stacione formale/zyrtare ( të legjitimuara), në shërbim të turizmit.
- Kufizimi i ndertimeve të reja 200m nga vija bregdetare ranore dhe në kuotën 60 m lartësi për relievin shkembor ( vija bregdetare matet cdo 2 vjet nga Institucioni pergjegjes SHGJSH)
- Të gjitha zhvillimet e reja do të orjentohen në qendrat urbane ekzistuese. Kjo, për arsye konsolidim të qendrave urbane ekzistuese.
- Kjo gjë, do të mbrojë token bujqësore që mos dëmtohet nga zhvillimet dhe betonizimet.
- Do të zhvillojë sektorin e peshkimit, bujqësise, e blegtorise me te gjitha hallkat e sajë të përpunimit të produkteve nga këta sektorë.
- Krijimi i tregjeve të vegjël lokal, ku të promovohen dhe marketohen produktet tipike të zonës. (ato më pas në sasi të mëdha, transportohen drejt tregjeve rajonale të lokalizuara në qendrat primare urbane)
- Ndërtimet e reja në brezin e parë bregdetarë, duhet të respektojnë arkitekturën tradicionale të zonës ku ato zhvillohen, dhe duke përdorur materialet lokale.
- Të gjitha qytetet dhe lokalitetet që janë të ndërtuara në bregdet, duhet të krijojnë ballinat ujore, si hapësira publike me vlerë jo vetëm për turizmin, por mbi të gjitha për cilësin e jetesës së vetë banorëve të zonës.
- Të hartohen projkte për menaxhimin/administrimin e zonës së mbrojtur mjedisore, lagunës Kune-Tale-Vajin, dhe plane menaxhimi i monumenteve të kulturës si Kalaja e Rozafës dhe një numër të madh monumentesh të tjera; për të zhvilluara ekonominë lokale falë këtyre aseteve plot vlera autentike të territorit dhe historisë së Shqipërisë.
- Këto plane menaxhimi/administrimi, duhet të kenë në vëmendje këto projekte:
    - Infrastruktura për t'i aksesuar këto vlera, në varësi të territorit
    - infrastruktura, ORJENTUESE
    - infrastruktura, INFORMUESE
    - projekte, PROMOVUESE

## 2.3 Direktivat Sektoriale

## Direktiva nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Bazuar në Programin e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave janë evidentuar programet kryesore të cilat impaktojnë mbi Bashkinë Shkodër dhe direktivat/politikat përkatëse të tyre:

- **Mbi Ujitjen, Kullimin dhe Mbrojtjen nga Permbytjet e tokave Bujqesore.**

Ne kete dokument Ministria e Bujqese shpalos potencialet e medha qe ka bujqesia Shqipetare krahas sasise të larta ujore të cilat ndodhen në territorin kombëtar. Disa nga synimet te cilat kjo Ministri parashtron, jane:

1. Plotësimin e qëndrueshëm të nevojave për ujë, nëpermjet rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve ujitës;
2. Menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes nëpërmjet ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësive për operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, midis pushtetit qëndror, komunave dhe organizatave të përdorimit të ujit;
3. Garantimin e kullimit, me përparësi në ultësirën perëndimore, nëpermjet rehabilitimit dhe përmirësimit të infrastrukturës egzistuese dhe rritjes së kapacitetitit të hidrovorëve;
4. Zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet lumore dhe detare, nëpermjet rikonceptimit të strukturave mbrojtëse, duke konsideruar zhvillimet e reja urbane pranë lumenjëve dhe grykëderdhjeve të tyre.

Menaxhimi i qëndrueshem dhe ndjekja e programeve te lartepermendura ndikon drejteperdrejte ne sistemin e kullimit dhe te menaxhimit te resurseve ujore, dhe si rrjedhoje pergjegjesine e mbrojtjes nga perbytjet dhe tokes bujqesore.

- **Bujqesia dhe Zhvillimi Rural**

Duke ju referuar objektivave politik te Ministrise se Bujqesise prodhimi bimore bën pjesë në Planin për Integrim Evropian dhe pjesë e Planit të Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian.

*Qëllimi i përgjithshëm është orientimi dhe sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të bimëve bujqësore me qëllim rritjen optimale të prodhimit për plotësimin sa më mirë të nevojave të vendit, minimizimin e importit dhe rritjen e mundësive për eksport si dhe mbështetjen e menaxhimin e këtij zhvillimi.*

Përsa i takon situates aktuale Ministria e Bujqesise shprehet se se fundi ky sektor po has nje shtim te dimensionit te kulturave te te mbjellave. Kjo per edhe vete faktin e mbeshtetjes se Ministrise ne mbulimin dhe ngritjen e serrave – ne menyre qe te garantohet jo vetem nje hark kohore i gjate i kultivimit por gjithashtu edhe nje diversitet ne bimesi. Orientimi i ketyre linjave te zhvillimi te politikave synon qe nepermjet ketij plani te zhvillimit te:

- Rritet aftesia konkurruese dhe promovimi te kulturave te vendit.
- Rrise vleren e produkteve dhe te ardhurave te fermereve.
- Konsolidoje aftesine perpunuese
- Te rrise lidhjet strategjike per investime ne futjen e teknologjive te reja.
- Te siguroje kontrata e prodhimit.

MBZHRAU prioritetet e veta i ka mbështetur edhe në politikat e saj në drejtim të **konsolidimit të bujqësi** duke synuar kështu në një organizim të prodhimit, mundësi më të mëdha për prodhime sipas standardeve të kërkuara nga tregu jo vetëm ai rajonal apo i BE-së por edhe nga ai lokal**.**

- **Prodhimi Organik Bio**

Sipas aktit te marreveshjes se Stabilizimit dhe Asociimit Shqiperi ka per detyre edhe modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare. Ky plan eshte i reflekuar gjithashtu edhe nga udhezimet dhe programet e MBZHRAU-se.
Aktualisht në Shqipëri, operojnë dhe 7 organizma të huaj certifikimi si janë dhe keto organizma certifikues të huaj janë të njohur dhe akredituar për certifikim të produkteve "bio" në vendet e tyre të origjinës. Organizmat certifikues të huaj kryejnë certifikim në bazë të Rregullores Nr. 834/2007 të BE, për prodhimin dhe etiketimin e produkteve organikë si dhe standardit amerikan për produktet organike (NOP). Afimi i ketyre organizmave me sistemin e prodhimeve bio ne Shqiperi eshte gjithashtu pjese e programit te Ministrise per rritjene e ekportit dhe si rrjedhim te ardhurave per fermeret.
Megjithëse aktualisht çmimet e produkteve 'BIO", me përjashtime te vogla, janë të njëjta me ato të prodhimeve konvencionale, fermeri që prodhon 'BIO" e ka të garantuar shitjen. Interesi i konsumatorit shqiptar për këto prodhime është në rritje, çka ka bërë të lindin edhe mikrotregjet e para të prodhimeve "BIO" të fruta/perimeve, veçanërisht të fruta/perimeve autoktone.

- **Mbi Peshkimin.**

Në kete dokument te Ministrise se Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave, rekomandohet ndalimi i peshkimit ne Liqenin e Shkodres te ndalohet deri ne nje periudhe te papercaktuar. Ndalohet peshkimi i cfaredolloj specie e gjallese ujore pervec Ngjales se Liqenit e cila nuk perben asnje rrezik ne zhdukje apo per ekosistemin ne fjale. Ne kete dokument shpjegohen edhe menyrat e peshkimit dhe gjithashtu zonat te cilat jane te dedikuara per kete lloj peshkimi. Nisja për në liqen specifikohet qe të bëhet vetëm nga zonat Zogaj, Shirokë, Grizhë, Kamicë dhe Shegan dhe aktiviteti të zhvillohet në distancë 500 metra nga bregu në zonën Zogaj, Shirokë, Fushë-Bunë, Pylli Dobraçit, Vrakë, Grizhë, Kalldrun Jubicë, 150 metra në zonën Kamicë, Flakë, Kosan e Shegan dhe Hot. Se fundi Ministria e Bujqesise nepermjet ketij dokumenti urdheron qe i gjithë prodhimi të zbarkohet në qendrën e OMP Shirokë – e cila do te kete edhe rol monitoruesi persa i takon ketij urdheri ministror.

## Direktiva nga Ministria e Mjedisit

Në planin ndërsektorial të mjedisit për periudhën 2015-2020 parashikohen disa direktiva dhe politika në lidhje me çështje të ndryshme mjedisore të cilat kanë një impakt edhe në bashkinë Shkodër:

- **Menaxhimin e Mbetjeve Urbane**

Hartimi i planeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve ështe kryehyrja e strategjive përsa i takojne menaxhimit të mbetjeve urbane. Ne kuader të ketij plani një seri venddepozitimesh të vjetra duhen mbyllur, ne baze të direktivave te Komunitetit Europian, **dhe te rinj duhen hapur. I tille eshte edhe venddepozitimi ekzistues i Shkodrës ku pritet nje asgjesimi ne menyre te kontrolluar te mbetjeve. Ky venddepozitim është mbyllur mbas hapjes së lendfillit të Bushatit, por nuk është trajtuar nga pikëpamja mjedisore duke u kthyer në një hotspot mjedisor.** Gjithashtu objektivat dhe produktet madhore ne fushen e mbetjeve ne menyre te detajuar jane te parashikuara ne Strategjine dhe Planin Kombetar te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve, si a) Riciklimi i mbetjeve urbane ne masen 10 %.b) Transpozimi i direktivave te Komunitetit Europian. c) Hartimi i studimit te fizibilitetit per percaktimin e nje venddepozitimi per mbetjet e rrezikshme.

- **Në fushën e ujërave.**

Referuar gjithne Strategjise Ndërsektoriale së Ministrisë së Mjedisit ne fushen e ujerave brenda vitit 2020 do te arrihet plotesisht mbrojtja e ekosistemeve lumore, për këtë do të realizohet mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se ujerave nepermjet Planeve te Menaxhimit te Burimeve Ujore. Gjithashtu, monitorimi i vazhdueshem i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet pergjegjese ne bashkepunim me MM mbetet prioritet tu realizuar brenda vitit ne fjale.

- **Pyjet dhe Kullotat**

Persa i takon menaxhimit te pyjeve dhe kullotave objektivat paraqiten te shtrira ne harqe te gjate kohor, duke filluar nga mekanizma per reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimin e lendes drusore. Forcimi i sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pyje dhe realizimi i data bazën pyjore (GIS) mbeten prioritet i ketij plani strategjik.

Ky Plan parashikon gjithashtu hartimin dhe miratimin e planeve të fondit pyjor dhe kullosor, dhe azhurnimin e të dhënave të tyre duke realizuar 100% të objektivit, si dhe përmbushjen e krijimit te njësive territoriale me funksion prodhues dhe menaxhimin e integruar te tyre nëpërmjet teknikave te avancuara.Vendosja e marrëdhënieve rajonale e me gjere, për shkëmbimin eksperiencave, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive mbete prioritet e ketij draft Plani.

- **Zbatimi i direktivave të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe peizazhit**

Ministria e Mjedisit nepermjet ketij PlaniStrategjik synon perfundimin e studimit për rrjetin Emerald të Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ZIVR) në kuadër të Konventës së Bernës "Për ruajtjen e jetës së egër dhe të habitateve natyrore evropiane". Disa nga objektivat e tjere te cilet kjo ministri ka shpallur jane;

- Zbatimi i masave mbrojtëse për llojet dhe habitatet e listuara në Anekset e Direktivës së Habitateve dhe të Shpendëve;
- Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për zonat e reja të shpallura dhe përditesimi/rishikimi i planeve ekezistuese; përfshirja e çështjeve të ndryshimeve klimatike;
- Studim kombëtar për riklasifikimin e Zonave të Mbrojtura, bazuar në kriteret e reja të publikuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN);
- Rehabilitimi i dunave dhe i ujëkëmbimit det - lagunë në zonat e mbrojtura bregdetare për të rritur aftesinë ripërtëritëse të ekosistemeve ndaj ndryshimeve klimatike;
- Zbatimi i masave konkrete të parashikuara në planet e menaxhimit për të siguruar statusin e favorshëm të ruajtjes për llojet dhe habitatet globalisht të kërcënuara;

## Direktiva nga Ministria e Zhvillimit Urban

### Strategjia e Strehimit Social 2016-2025

#### Vizioni

Përfshirja sociale dhe ekonomike nëpërmjet ofrimit të alternativave të strehimit të cilat janë të gatshme, të arritshme, të përballueshme dhe të përshtatshme, për më shumë se 60% të popullsisë 17 shqiptare e cila nuk ka mundësi financiare të përballojë strehimin në treg dhe në veçanti grupet të cilat janë në pozita të pafavorizuara.

#### Qëllimi

Qëllimi i strategjisë është përmirësimi i kushteve të jetesës së 25,000 familjeve shqiptare me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë, duke përfshirë familjetnë pozita të pafavorizuara që vuajnë nga përjashtimi social përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm

Strategjia përcakton 4 prioritete strategjike të cilat do të çojnë në ofrimin e alternativave të strehimit. Këto prioritete strategjike janë si më poshtë:

- Forcimi i kapaciteteve vendore në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave rreth strehimit social
- Përmirësimi i qasjes në strehim të grupeve të pafavorizuara përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe institucional
- Rritja e numrit të përfituesve në pozita të pafavorizuara përmes zgjerimit të instrumenteve financiare
- Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet zgjerimit dhe riorientimit të programe të strehimit social

**Strategjia e Strehimit Social përfshin objektivat strategjike si më më poshtë:**

- Zhvillimi i kapaciteteve të 61 njësive vendore për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për rritjen e qasjes në strehim të 50% të familjeve në pozita tëpafavorizuara;
- Bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qëndror dhe vendor për përmirësimin e procesit të shpërndarjes së strehimit në 61 njësitë vendore;
- Sigurimi i marreveshjeve te Partneritetit Publik-Privat (PPP) per permiresimin e alternativave te strehimit social dhe rritjen e numrit te familjeve perfituese me 20%;
- Zgjerimi i alternativave të strehimit përmes programeve të orientuara për familjet me të ardhura të ulëta e të mesme dhe kryesisht ato të pafavorizuara me 30%;

## Direktiva nga Ministria e Punëve të Brendshme

### Plani Kombetare per Emergjencat Civile

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është në fazë hartimi. Duke qënë se Shkodra është e cënuar nga disa lloje rreziqesh natyrore dhe veçanërisht nga përmbytjet, direktivat janë të bazuara në planin e vitit 2004:

Ky dokument edhe perse i hartuar ne vitin 2004 mbetet dokumenti zyrtare qe pushteti qendrore ka, dhe kjo fale Ministrise se ceshtjeve vendore dhe Decentralizimit. Pavaresishte se ky dokument paraqitet i hartuar nga Ministria ne fjale, ai jep sakte rekomandimet ne raste emergjencash per bashkite. Sipas ketij dokumenti Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe freskojnë periodikisht dhe çdo bashki krijojn dhe mbajn një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.

Gjithashtu, monitorimi sistematik i rreziqeve që vijnë si rezultat i fatkeqësive të ndryshme, kërkojnë përcaktimin e saktë të roleve dhe të përgjegjësive të strukturave të emergjencave. Gjithashtu, kërkohet vendosja e linjave të qarta të raportimit midis strukturave monitoruese të emergjencave civile, qendrore dhe lokale. Procedurat e monitorimit përforcohen nga kritere ose tregues të qartë për njoftimin e hershëm dhe aktivizimin e SSHKEC- së. Institucionet dhe strukturat përkatëse që kanë kapacitete ose struktura vartëse për monitorimin dhe dhënien e informacionit, kanë për detyrë të japin informacion periodik dhe specifik në DPPEC Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazes së përgjigjes duhet te jete I menjëherëshem dhe pas informimit rreth ndonjë situate emergjente ose ngjarjeje të mundshme të cilat mund të shkaktojnë një emergjencë në nivel rajonal (qark) ose lokal, prefektët, punonjësit e emergjencave civile ose autoritetet e zgjedhura në nivel vendor ndërmarrin veprime të njëjta në mbështetje dhe plotësim të SSHKEC-së.

## 2.4 Analiza Metabolike e Territorit

Në kuadër të hartimit të Strategjisë, Analiza Metabolike e Territorit është një nga metodologjitë e kërkuara me ligj, si dhe një mënyrë e re për të parë territorin si një trup i unifikuar. Në këtë kontekst është e rëndësishme si paraprijëse e përcaktimit të vizionit si dhe objektivave strategjike.

### 2.4.1 Fluksi i mbetjeve

Analizimi i fluksit të mbetjeve për bashkinë e Shkodrës mbështetet në gjenerimin e mbetjeve në nivel bashkie, llojn e mbetjeve dhe vëndet e depozitimit të tyre.Kjo më pas krijon pasqyrën për nivelin e ndotjes ku ndodhen këto vendepozitimeve dhe ndotjet në nivelin e ujërave.Në bashkinë Shkodër per vitin 2015-2016 janë prodhuar 38.786 ton mbetje totale për një popullsi prej 137.612 banore sipas ndarjes së re administrative. Nga këto mbetje 17.995 ton depozitohen në landfield-in e Bushatit i cili ka një sipërfaqe prej 12 ha dhe një kapacitet prej 1000000 $m^3$. Nga keto depozitime 45.4% pra 8.169 ton janë organike, 10.7% pra 1.925 ton janë plastike, 7.7% pra 1.3856 ton janë inerte dhe pjesa tjetër 6.5142 ton është e perzier.

Zakonisht mbetjet e gjeneruara janë në zonat urbane. Ato më pas transportohen me anë të mjeteve të ndryshme komunale dhe/ose private të nënkontraktuara drejt lendfillit të Bushatit. Për njësitë administrative kryesore, të cilat gjithashtu kanë një akses të mirë dhe distancë të vogël ndiqet kjo mënyrë për largimin e mbetjeve. Ndërkohë në zona më malore, për shkak edhe të distancave të mëdha dhe infrastrukturës jo të përshtatshme, gjithashtu edhe si rrjedhojë e sasive jo shumë të mëdha të mbetjeve, ato depozitohen në venddepozitime lokale ose asgjësohen me djegie.
Në bashkinë Shkodër, mungon aplikimi i koncepteve të riciklimit dhe të kompostimit për trajtimin e mbetjeve është ende në gjeneza. Vihet re një rritje e numrit të firmave private të cilat operojnë në fushën e ricklimit, por mungojnë të dhënat e sakta në lidhje me sasinë e mbetjeve të ricikluara. Nga diskutimet me stafin e bashkisë Shkodër si dhe bazuar në raportet e gjendjes së mjedisit nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, riciklimi në Shkodër është në nivele të papërfillshme. Vlen për tu përmendur që në periudhën e fundit bashkia Shkodër ka investuar në vendosjen e koshave të ndarë për mbetjet në qytet.
Përsa i përket iniciativave në lidhje me kompostimin këto janë kryesisht në baza individuale dhe mungojnë të dhëna të sakta. Ashtu sin ë rastin e riciklimit, edhe përsa i përket kompostimit është në nivele të papërfillshme. Gjithësesi, duke parë që një pjesë e madhe e mbetjeve të gjeneruara janë me karakter organik, atëherë kompostimi ka një potencial të madh për tu zhvilluar në të ardhmen.




## 2.4.2 Fluksi i Energjisë

Analizimi i fluksit të energjisë bëhet në bazë të sasise totale te energjise brenda bashkisë, duke ndarë energjinë për konsum familjesh dhe industrive/bizneseve. Këtu janë paraqitur edhe energjia nga

burimet alternative ato ekzistuese dhe të propozuarat.Ky llojë fluksi na lejon të kuptojmë eficiencen energjitike të bashkisë dhe ku mund të përmiresohet ky fluks në të ardhmen duke rritur eficentimin e ndertesave ose burimeve të energjisë.

Përsa i përket prodhimit të energjisë elektrike, Shkodra ndodhet pranë hidrocentraleve të Ashtës, Vaut të Dejës dhe Komanit. Hidrocentrali i Vaut të Dejës nisi të ndërtohej më 1967 dhe u vu në shfrytëzim më tetor 1971. Ka digën e Zadrejës dhe një në Qyrsaq të ndërtuara mbi kaskadën e lumit Drin. Këto diga krijojnë një rezervuar, (Liqenin e Vaut të Dejës) me vëllim 580 milionë metër kub ujë. Ashta, 10 kilometra larg qytetit të Shkodrës, porta e fundit e lumit Drin përpara se ai të bashkohet me Bunën e më pas për tu derdhur në Adriatik, konsiderohet ndër veprat më të rëndësishme energjitike me parametra moderne dhe bashkëkohore. Impianti është i ndarë në dy pjesë: “Ashta I” do të prodhojë rishtazi energji elektrike me anë të tubinave Hydro Matrix, aty ku përpara tre dekadash është ndërtuar rezervuari i Spatharës me digën kundër përmbytjeve dhe sistemet e vogla vaditëse për bujqësinë. Pas një kanali rreth pesë kilometër të gjatë, që shtrihet deri në thellësi në afërsi të fshatit Ashtë, Ashta II do të prodhojë energji elektrike për herë të dytë. Kapaciteti total i të dy centraleve elektrike (Ashta 1 dhe Ashta 2) është rreth 53 megavat (MË) dhe çdo vit do të prodhohen rreth 240 milion kilovat-orë energji elektrike. Hidrocentrali i Komanit nisi të ndërtohej më 1979. Më 1985 u vunë në shfrytëzim dy turbinat e para dhe më 1986 dy të tjerat. Diga është me gurë dhe ekran prej betoni të armuar. Krijon një rezervuar, liqen artificial, me sipërfaqe rreth 12 km katror dhe vëllim rreth 450 milionë metër kub ujë. Ky dirocentral është një ndër hidrocentralet më kryesore.

Bashkia Shkodër është në një ndër zonat më të rëndësishme përsa i përket prodhimit të energjisë elektrike. Prodhimi siç u përshkrua më sipër është nga uji, ndërkohë që burimet e tjera të energjisë si era, dielli etj nuk janë të aplikueshme. Përsa i përket diellit, kryesisht përdoret në ndërtesa individuale në zonën e velipojës për ngrohjen e ujit.

Shfrytëzimi i energjisë elektrike është kryesisht për qëllime banimi. Përqëndrimi më i madh i shfrytëzimit të energjisë është në qytetin e Shkodrës si rrjedhojë edhe e dendësisë më të madhe të popullsisë. Gjithashtu, gjatë periudhës së verës, zona e Velipojës ka një presion të madh në shfrytëzimin e energjisë si rrjedhojë e aktiviteteve turistike. Nga të dhënat e Bashkisë, në Velipojë operojnë rreth 250 njësi biznesi, 300 hotele dhe 1500 shtëpi pushimi. Ndërkohë përsa i përket njësive administrative të tjera shfrytëzimi i energjisë është kryesisht për qëllime banimi. Bazuar në të dhënat e instat dhe në analizën e cilësisë së strukturave në territor, standartet e efiçiencës energjitike në ndërtesa nuk aplikohen. Gjithashtu, një pjesë e madhe e stokut të ndërtesave janë përpara viteve 1990-të në të cilat nuk aplikoheshin material për kursimin e energjisë. Ndërkohë, një pjesë e madhe e ndërtimeve të reja janë në zhvilluar në mënyrë informale ku sërish nuk mund të thuhet se ka një efiçiencë të lartë energjitike.


FLUKSI I ENERGJISE
BASHKIA SHKODER
FLUKSI I ENERGJISE (Perdorimi i energjise,Burimet e energjise)
Sh. 1: 200,000
Pergatiti:
BASHKIA SHKODER
UNIVERSITETI POLIS, METROPOLIS
ARIZONA STATE UNIVERSITY
KUFIRI ADMINISTRATIV
INDUSTRI
NDERTESA
SIPERFAQJE UJORE
ZONAT E MBROJTURA
KATEGORIA II
KATEGORIA IV
KATEGORIA V
1 INDUSTRI PRODHIMI DHE PERPUNIMI
2 PASURI MINERALE
3 PIKA KUFITARE
4 BURIMET UJORE
5 PIKA PRODHIMI ENERGJIE
KONSUMI I ENERGJISE PËR FAMILJE NË VIT (MWH/FAMILJE/VIT)
120.0 - 276.0
276.1 - 480.0
480.1 - 768.0
768.1 - 1104.0
1104.1 - 1488.0
1488.1 - 1932.0
1932.1 - 2616.0
2616.1 - 3648.0
3648.1 - 5244.0
5244.1 - 7776.0
7776.1 - 11028.0
11028.1 - 21180.0
21180.1 - 35868.0
35868.1 - 56952.0
56952.1 - 149340.0
LIQENI I SHKODRES
DETI ADRIATIK

## 2.4.3 Fluksi i Ujit

Ky fluks bazohet në të dhënat përsa i përket furnizimit me ujë në bashkinë, konsumi në nivel familjesh dhe në nivel industrish.Ky fluks paraqet burimet më të rëndësishme ujore dhe rrjetin e furnizimit, për të krijuar një panorama përsa i përket rrugës së furnizimit me ujë, humbjeve për shkak të amortizimit të rrjetit dhe përqindjes së mbulimin të territorit nga ky rrjet. Kjo na lejon të përcaktojmë zonat e ndërhyrjes për të përmirësuar këtë shërbim dhe për të minimizuar humbjet.

Duke pasur një terren malor, dhe të pasur nga pikëpamja hidrike, Shkodra ka një numër të konsiderueshëm burimesh ujore të cilat mund të përdoren për furnizimin me ujë të zonave të banuara. Kryesisht, uji përdoret në dy fusha kryesore, atë të vaditjes për qëllime bujqësore dhe për furnizimin me ujë të pishëm.

Rrjeti i furnizimit të ujit të pishëm mbulon qytetin e Shkodrës, zonën urbane të Velipojës, si dhe të zonave të tjera urbane. Ndërkohë, përsa i përket vendbanimeve malore, kanë ende vështirësi në lidhje me sistemin e ujit të pishëm i cili në disa raste kryhet në baza individuale me anë të puseve të ujit.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza është prezent për qytetin e Shkodrës. Ndërkohë, për zonën turistike të Velipojës, rishtazi është hapur impianti i trajtimit të ujërave në Pulaj. Kjo gjë sjell një zbutje të presionit sidomos gjatë stinës së verës në të cilën numri i përdoruesve shumëfishohet për shkak të numrit të lartë të vizitorëve. Ndërkohë, në zonat urbane rurale dhe veçanërisht ato malore, trajtimi i ujërave të zeza bëhet në baza individuale me anë të gropave septike. Vlen për tu përmendur që rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha në disa raste është i amortizuar, ndërkohë që në disa zona informale nuk është ende i zgjeruar duke u krijuar dhe në burim të sëmundjeve dhe ndotjeve.

Përsa i përket përdorimit të ujit për qëllime bujqësore kryesisht është në zonat e ultësirës së Shkodrës dhe njësive administrative të Rrethinave, Postribës, Dajçit, Velipojës dhe Bërdicës. Si rrjedhojë e ndërtimeve informale dhe ndryshimeve në strukturën e tokës, por edhe të investimeve të munguara në rrjetin/sistemin e kullimit dhe të vaditjes, shpesh krijohen probleme në vaditjen e tokave si dhe në largimin e ujërave në rastet e përmbytjeve.


FLUKSI I UJIT
BASHKIA SHKODER
FLUKSI I UJIT (Konsumi i ujit,Burimet e ujit)
Sh. 1: 200,000
Pergatiti:
BASHKIA SHKODER
UNIVERSITETI POLIS, METROPOLIS
ARIZONA STATE UNIVERSITY
KUFIRI ADMINISTRATIV
INDUSTRI
NDERTESA
SIPERFAQJE UJORE
ZONAT E MBROJTURA
KATEGORIA II
KATEGORIA IV
KATEGORIA V
1 RRJETET E FURNIZIMIT ME UJE
2 RRJETET E DRENAZHIMIT
3 STACIONE HIDROLOGJIKE
4 BURIMET UJORE NENTOKSORE
5 HIDROCENTRALET
KONSUMI I UJIT PËR FAMILJE NË VIT
(L/FAMILJE/VIT)
80.0 - 184.0
184.1 - 320.0
320.1 - 512.0
512.1 - 736.0
736.1 - 992.0
992.1 - 1288.0
1288.1 - 1744.0
1744.1 - 2432.0
2432.1 - 3496.0
3496.1 - 5184.0
5184.1 - 7352.0
7352.1 - 14120.0
14120.1 - 23912.0
23912.1 - 37968.0
37968.1 - 99560.0
LIQENI I SHKODRES
DETI ADRIATIK

## 2.4.4 Fluksi i Ushqimit

Bashkia Shkodër ka një siperfaqje të konsiderueshme të tokave bujqësore më një cilësi boniteti të lartë.Ky fluks do të na shërbej për të kuptuar sasinë e prodhimit, llojin e prodhimit dhe sesa ky prodhim përputhet me cilësinë dhe karakteristikat e tokës. Tregun ku ky prodhim tregëtohet dhe rrjetin e funksionimit të tregëtisë.Të gjithë këtë elemente të fluksint të ushqimit tregojnë potencialet dhe ngërcet në zhvillimin bujqësorë.

Nga të dhënat e raportuara nga MBU ne nivel qarku, rezulton se pavarësisht se qarku zoteron kapacitete te burimeve ujore te mjaftueshme per perballuar ujitjen te pothuaj 100% te tokes bujqësore, aktualisht infrastruktura egzistuese, mbulon ujitjen e nje siperfaqeje si toke bujqësore prej rreth 16 mije ha ose rreth 32% te siperfaqes se pergjithshme te tokes bujqësore te qarkut.

Ndërkohë përsa i përket prodhimit, mund të thuhet se në Shkdoër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhohen në territorin e bashkisë në periudha të ndryshme kohore.




Në Shkodër mungon një treg rajonal i formalizuar për produktet bujqësore. Gjithashtu mungon dhe një qëndër grumbullimi e produkteve bujqësore çka redukton mundësitë e produkteve për të arritur tregje më të mëdha. Kryesisht, produktet tregtohen nga fermerët ose persona të tretë në tregje të vogla urbane. Një pjesë e këtyre produkteve tregtohen edhe në zona të tjera të Shqipërisë dhe tregje më të mëdha si ato të Tiranës. Përsa i përket eksportit produktet e prodhuara në Shkodër kanë mundësi shumë të vogla për të depërtuar në tregjet ndërkombëtare.



FLUKSI I USHQIMIT
BASHKIA SHKODER
FLUKSI I USHQIMIT (Sasia e prodhimit,Lloj i prodhimit)
Sh. 1: 200,000
Pergatiti:
BASHKIA SHKODER
UNIVERSITETI POLIS, METROPOLIS
ARIZONA STATE UNIVERSITY
KUFIRI ADMINISTRATIV
INDUSTRI
NDERTESA
SIPERFAQJE UJORE
ZONAT E MBROJTURA
KATEGORIA II
KATEGORIA V
KATEGORIA IV
BONITETI I TOKES
Kategoria II
Kategoria III
Kategoria III-IV
Kategoria V
Kategoria V-VI
Kategoria VI
1 SERA PRODHIMI
2 STALLA PRODHIMI
3 INDUSTRI USHQIMRE PERPUNIMI
4 LIVADHE DHE BIME MEDICINALE
5 HIDROCENTRALET
NDARJA SIPAS % SE BONITETIT
2.2 - 5.1
5.2 - 8.9
9.0 - 14.2
14.3 - 20.4
20.5 - 27.6
27.7 - 35.8
35.9 - 48.4
48.5 - 67.6
67.7 - 97.1
97.2 - 144.0
144.1 - 204.2
204.3 - 392.2
392.3 - 664.2
664.3 - 1054.7
1054.8 - 2765.6
LIQENI I SHKODRES
DETI ADRIATIK

## 2.4.5 Konkluzionet

Analiza e metabolizmit ka si qëllim të tregojë gjëndjen aktuale të menaxhimit të flukseve në një territor dhe në bazë të përfundimeve të analizës, nësë këto flukse duhen ndryshuar apo përmirësuar.Duke u mbështetur gjithmonë në faktin që kjo analizë duhet ti shërbej ekspertëve për të kuptuar dinamikat aktuale dhe hapat për të ardhmen mbështetur në parimet e qendrueshmërisë dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës. Si një analizë e mbështetur në të dhëna sasiore, kjo analizë duhet të shoqerohet me të dhëna të sakta dhe të argumentuara për territorin. Bazuar në analizat e flukseve të ujit, ushqimit, mbetjeve dhe energjisë mund të nxjerrim konkluzionet e mëposhtme:

- Përsa i përket energjisë Shkodra ka një mbulim të mirë si rrjedhojë e afërsisë me disa nga hidrocentralet kryesore si Ashta, Vau i Dejës dhe Komani. Gjithësesi, prodhimi i energjisë elektrike është i bazuar vetëm në ujë. Duke marrë në konsideratë rreziqet e ndryshimeve klimatike, dhe për të mbështetur një zhvillim sa më të qëndrueshëm nga pikëpamja klimatike është e rëndësishme që prodhimi i energjisë të diversifikohet si dhe të rritet efiçienca energjitike në përdorim.
- Bashkia Shkodër ka një sasi të konsiderueshme tokash bujqësore të një boniteti të lartë. Një pjesë e madhe e tyre kanë vështirësi në ujitje si rrjedhojë e mungesës së përshtatshmërisë në vaditjen e tyre. Mungojnë tregje dhe qëndra grumbullimi të cilat rrisin vështirësinë e produkteve për të arritur tregje më të mëdha.
- Përsa i përket fluksit të ujit, problemi më i madh është ai i përmbytjes në tokat bujqësore.
- Fluksi i mbetjeve tregon se riciklimi dhe kompostimi nuk aplikohen.

## 2.5 Analiza S.W.O.T

Bazuar në VKM 671 dt. 29/07/2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" analiza S.W.O.T është orientuar në bazë të 5 (pesë) sistemeve territoriale. Ndërkohë, grupi i punës, ka gjykuar të arsyeshme që të përfshijë si pjesë të analizës edhe kuadrin institucional. Kjo gjë është bërë me qëllimin që programet dhe politikat më pas të marrin në konsideratë dhe zbatueshmërinë apo masat për të arritur në zbatimin e tyre.

| **Pikat e Forta** |
|---|
| **1. Institucionale** |
| Përqëndrimi i institucioneve kryesore në qytetin e Shkodrës si zyrat e Qarkut, Prefekturës, Agjencive rajonale të mjedisit, bujqësisë etj |
| Krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Rajonal me qendër në Shkodër |
| Pozicioni strategjik i favorshëm për të përfituar fonde (ipa,cbc). Pozicionimi i zyrave qëndrore të disa prej programeve ndërkombëtare |
| Kulturë institucionale me punën me financimet e huaja |
| Qëndër historike për rajonin e veriut |
| Traditë e mirë bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm |
| Qëndër rajonale në ofrimin e shërbimeve |
| Është ruajtur bërthama kryesore institucionale, kapacitet i lartë njerëzor në Shkodër |
| Shoqëri civile  aktive |
| Prania e Universitetit të Shkodrës |
| **2. Sistemi Urban** |
| Qëndër historike me trashëgimi të pasur kulturore e historike |
| % e konsiderueshme e popullsise ne moshe te re |
| Popullsi me nivel të lartë edukimi në qytetin shkodër |
| Prania e ujit si liqeni, deti dhe lumi pranë zonave urbane është një pikë shumë e fortë |
| Marrveshja me landfillin e Bushatit për depozitimin e mbetjeve |
| Zona industrial është ruajtur |

| |
|---|
| Pozicioni strategjik eshte lidhes midis shqiperise,malit te zi dhe kosoves |
| Hapsira publike te shumta |
| Përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar si një qëndër urbane kryesore |
| Gjallëri e jetës urbane |
| Qytet Studentor |
| Qytet tregtar |
| 3. Sistemi Infrastrukturor |
| Afërsia me Portin e Shëngjinit dhe Portin e Barit (Mal i Zi) si dhe me aeroportin e Rinasit dhe atë të Podgoricës |
| Portë Hyrëse në Shqipëri nga Mali i Zi |
| Prania e hekurudhes |
| Pjesa me e madhe e territorit eshte e pershkueshme me infrastrukture rrugore |
| Perdorimi i bicikletes/qyteti i 12 ne rang europe per bicikletat |
| Ekzistenca e transportit publik/linjave interurbane |
| Shkodra është pranë hidrocentraleve kryesore si rrjedhojë ka mundësi për furnizim me energji elektrike |
| Qyteti ka mbulim të mirë me infrastrukturën bazë të ujësjellës kanalizime |
| Sistemi bujqësor ka ruajtur një pjesë të madhe të infrastukturës mbështetëse të vaditjes dhe kullimit |
| 4. Sistemi Ujor |
| Rrjet i pasur hidrografik |
| Prania e burimeve ujore në afërsi të zonave urbane |
| Lumi buna i vetmi lume i lundrueshem |
| Burimet ujore nentoksore(dobraci) |
| Liqeni pasuri/trashgimi natyrore/liqeni me i madh ne ballkan/zone ramsar |
| Prania e ujit ne afersi te tokave bujqesore |
| Turizmi liqenor/detar |
| Ekzistenca e pikave me atraksion kulturor dhe historik/natyror(ishuijt,vaskat e ujit,ujevarat etj) |
| 5. Sistemi Bujqësor |
| Perqendrimi i tokave bujqesore ne zonen jug-perendimore te bashkise |
| Boniteti i tokes 3-6 |
| Shumellojshmeria e produkteve |
| Prodhimi lokal |
| Tregu Rajonal |
| Iniciativa private per krijmin e fermave |
| Bujqesia perben 30% te gdp-se se bashkise |
| Tentativa të mira për zhvillimin e agroturizmit në zonë |
| Kërkesa  në rritje për produktet vendase |
| 16176 ha tokë bujqësore |
| 6. Sistemi Natyror |
| Shperndarja i zonave natyrore ne te gjithe bashkine |
| flora dhe fauna shumë e pasur |
| Shmellojeshmeria e relievit/malor/kodrinor/fushor/bregdetar |
| Rrjeti i zonave te mbrojtura |
| 7.2% nga sip natyrore jane pyje |
| PIKAT E DOBËTA |
| 1. Institucional |
| Bashkia ka një sipërfaqe 58-here me e madhe që përbën një sfidë për ofrimin e shërbimeve |
| Mungesa e kapaciteteve te specializuara/specialist në zonat periferike malore |

| |
|---|
| Mungesa e eksperiences institucionale në njësinë qëndrore për trajtimin e çështjeve të zhvillimit rural dhe malor |
| Mungesa e informacionit jo të plote për territorin e ri |
| Ndergjegjesimi i ulet per detyrimet qytetare/publike në pagimin e taksave |
| 2. Sistemi Urban |
| Promovimi i dobet i vlerave historike e kulturoe |
| Perqendrimi i sherbimeve ne qytet Shkoder |
| Shperhapja urbane/informaliteti/rritja e shpejte |
| % E konsiderueshme e popullsise rurale me arsim te mesem |
| Tendenca për ndërtimin e banesave të reja pranë zonave historike |
| Tendencat e modernizimit te papershtatshme per zonat historike |
| Mungesa e sektoreve te punes per studente ose mosha te reja/pune part-time/trajnime |
| Bypass si barrier |
| Mungesa e banesave sociale |
| Mosshfrytëzim i ballinave ujore pranë liqenit |
| Menaxhimi i mbetjeve në zonat rurale dhe në qytet |
| Ndotje mjedisore/pa kontroll |
| Zona industrial në nevojë për rigjenerim |
| Efiçienca energjitike e ndërtesave e dobët |
| 3. Sistemi Infrastrukturor |
| Veshtiresia e aksesueshmerise ne të gjithë territorin e bashkise |
| Rrjeti rrugor i amortizuar |
| By pass si barrierë fizike midis liqenit dhe qytetit |
| Mungesa e parkimeve publike |
| Rrjet i fragmentarizuar i korsive te bicikletave |
| Mbulimi jo i plote me transport publik |
| Mungesa e diversifikimit në prodhimin e energjisë |
| Kosto e larte e teknologjise |
| Zonat periferike me gropa septike/pa standarte |
| Ndertime pa leje larg rrjetit |
| 4. Sistemi Ujor |
| Demtimi i sistemit te vaditjes/lidhja e vendbanimeve me ura pergjate lumit/burimet e ndotjes jo piksore |
| Ndotja e liqenitlumit nga derdhja e ujerave te kanalizimeve |
| Sedimentimi i lumit/liqenit/derdhjes se bunes/mospastrimi/masat inxhinjerike |
| Zhvillimi informal prane burimeve |
| Ndotja nga metalet e renda dhe mungesa e stacioneve te monitorimit |
| Ndotja e bregut te liqenit nga mbetjet urbane |
| Faktoret ndotes urban |
| Demtimi i sistemit te vaditjes dhe kullimit/perdorimi i kimikateve dhe pesticideve ne bujqesi |
| Mungesa e promovimit dhe njohjes se potencialeve |
| 5. Sistemi Bujqësor |
| Fragmentarizimi i tokes per qellime banimi,transporti dhe shfrytezimi |
| Mungesa e vlersimit te pershtatshmerise se tokes per kultivimin e produkteve specifike |
| Prodhime te perqendruara ne nje hark kohor,sezonal |
| Kosto e larte e prodhimit |
| Mungesa e pikave te grumbullimit dhe tregtimit(rajonal) |
| Mungesa e aftesive promovuese |
| 20% te totalit te tokes nuk kultivohet |
| Mungesa e organizimit/tregtia individuale |

| |
|---|
| Mungesa e kontrollit shendetsore/praktika te varfera ne te ushqyer/teknologji te vjetra |
| Nuk ka diversifikim |
| Aftesia /kapacitetet e marketimit e ulet |
| Mungesa e kushteve te pershtatshme per magazinim |
| Cilesi e ulet ne krahasim me vendet e tjera/mungesa e certifikimit te produkteve |
| 6. Sistemi Natyror |
| Ndertime pa marre parasysht masat specifike per zonat e mbrojtura |
| Gjuetia dhe mbjedhja pa krite i bimeve medicinale etj |
| Mungesa e lidhjeve te rrjeteve me kontekstin/parqet rajonale/kombetare/nderkufitare |
| **Rreziqet** |
| 1. Institucional |
| Pabarazi ne ofrimin e sherbimeve/menaxhim i dobet larg qendres |
| Vështirësi në ngritjen e kapaciteteve lokale në zonat periferike |
| Veshtiresi ne menaxhim/zhvillim i ngadalte |
| Paaftesia per te ofruar sherbime cilesore/mbulimi vetem i kostove administrative |
| Pabarazi ne zhvillimin rajonal krahasuar me vendet fqijn |
| 2. Sistemi Urban |
| Humbja e vlerave kulturore-historike |
| Braktisja e zonave periferike |
| Ndryshimi i perdorimit te tokes |
| Migrimi dhe emigrimi |
| Perqendrimi i popullsise vetem ne qendrat urbane/ndryshim i perdorimeve te tokes |
| Niveli i larte i ndotjes/demtimi i mjedisit/imazhit te basjkise |
| Fuqizimi i ekonomive informale/ teknologji e ulet |
| Cilesia e ulet e jeteses ne periferi dhe pjeset e tjera |
| 3. Sistemi Infrastrukturor |
| Ndotja e ujerave bregdetare/ekosistemeve ujore |
| Qyteti si nje pike tranziti |
| Fragmentarizimi i territorit |
| Rritja e perdoruesve te makinave |
| Ndryshimet klimatike |
| Ndotja e ujit te pishem/humbjet ne rrjet |
| Ndotja e ujerave nentoksore/tokave bujqesore |
| Demtimi i infrastruktures rrugore nga mos largimi i ujit |
| 4. Sistemi Ujor |
| Permbytjet/izolimi vendbanimeve si rrjedhoje e permbytjes |
| Ndryshimet klimatike |
| Shfrytezimet pa kritere i zonave per marrjen e inerteve |
| Humbja e tokes/deti/lumi/liqeni |
| Ndotja nga zhvillimi urbane informal ne afersi te zonave me burime ujore |
| Humbja e specieve/statusi ramsar |
| Ndotja e pashmangshme nga kufiri ujor i perbashket |
| Ndotja ujore siperfaqesore dhe nentoksore |
| 5. Sistemi Bujqësor |
| Urbanizimi/kripëzim i tokes bujqesore |
| Kohezjatja e prodhimit,fragmentarizimi i prodhimit,ulja e aksesit ne treg dhe braktisja e tokes |
| Humbja e produkteve tradicionale sipas zonave |
| Zvogëlimi i nr te prodhimit/prodhim individual/impakt i vogel ne ekonomi |
| Mungesa e aksesit ne treg dhe braktisje e tokes bujqesore |
| Humbja e sasise se prodhimit(nuk ka akses ne treg)ulja e te ardhurave |

| |
|---|
| Ndryshimet klimatike |
| Rreziku i permbytjeve/100% humbje |
| Veshtiresi bashkpunimi/potencial i humbur |
| Standarte te ulta prodhimi/me pak prodhim |
| Ekonomi informale/pa kontroll sanitar/cilesore |
| 6. Sistemi Natyror |
| Demtimi i rrjetit te zonave te mbrojtura |
| Zhdukja /zvogëlimi i habitateve |
| Rreziqet gjeologjike,gjeo-inxhinjerike/rreshqitjet/errozioni/orteqet/zjarri |
| Zvogëlimi i kufijnve te ketyre zonave nga aktiviteti njerzore |
| Demtimi i sistemit/rrjetit natyror |
| **MUNDËSITË** |
| **1. Institucionale** |
| Menaxhim i integruar i territorit |
| Zhvillimi ne baze te prioriteteve nga momenti i hartimit te planit |
| Dixhitalizim i shërbimeve dhe shërbimet online |
| Qëndrat multifunksionale |
| **2. Sistemi Urban** |
| Qender rajonale/ forcimi i rolit rajonal |
| Arsim profesional dhe specializime |
| Afersia me malin e zi,nxit konkurrencen dhe ndihmon ne shkembimin e proktikave te mira |
| Forcimi i identitetit arkitektonik |
| Menaxhim i zhvillimit per te ruajtur sistemet bujqesore-natyrore |
| Krijmi i ppp te reja me kompani te riciklimit/diferencimit te mbetjeve/cikli i plote |
| Lidhja e hapsirave publike me sistemin natyror(e aksesueshme per te gjithe) |
| **3. Sistemi Infrastrukturor** |
| Rritja e aksesueshmerise te bashkise me rajonet |
| Nxitja e konkurueshmerise rajonale |
| Pjese e rrjeteve multimodale brenda/jashte vendit |
| Perfshirja ne rrjetet nderkombetare te bicikletave |
| Diversifikimi energjitik/rritja ekonomike/rendesi rajonale si motor energjitik i vetemjaftueshem |
| Rikonstruksioni dhe shtrirja e rrjetit/sherbim cilesor per te gjithe |
| Permiresimi i teknologjise se gropave septike/shtrirja e rrjetit/teknologji eco per perpunimin e ujerave |
| Sistemet ekolgjike te trajtimit te ujerave/infrastruktura e gjelber |
| **4. Sistemi Ujor** |
| Turizmi elitare në zonat bregdetare |
| Shfrytezimi per vaditje dhe kullim/permiresimi i aksesit me ura alternative |
| Shkodra port detar/liqenor |
| Ekonomia blu |
| Rivitalizimi/rikonstruksioni/rizhvillimi/zgjerimi i kanaleve vaditese/kulluese |
| **5. Sistemi Bujqësor** |
| Ngritja e taktikave bujqesore ne kontekstin(bujqesi-urbane) |
| Pershtatja e cilesise me llojin e prodhimit,krijmi i brand-it |
| Partneritetet publike-private |
| Krijmi i pikave të grumbullimit/tregjeve rajonal |
| Krijmi i ekofermave/mikroqendra ekonomike |
| Riperteritja e tokes dierre(taksave dhe subvecione) |
| Krimi i (fermave) meaxhimit te perbashket |
| Aksesi ne tregje te reja/ferma te menaxhimit te perbashket |

| |
|---|
| Krijmi i produkteve cilesore te certifikuara per te konkuruar ne tregun europian |
| **6. Sistemi Natyror** |
| Zona atraktive per turizem natyror/ecoturizmi/fashat turistike |
| Zona me biodiversitet te larte/kthimi ne zona me interes studimi per kerkime shkencore |
| Turizmi multidimensional/gjatë gjithë vitit |
| Rritja e vlerave të atraktivitetit rajonal/kombëtar/ndërkombëtare |

## 2.6 Skenarët Territoriale

Në kuadër të hartimit të vizionit territorial dhe objektivave strategjike janë përgatitur tre alternativa të ndryshme (skenarë) të mundshëm për zhvillimit territorial të Bashkisë Shkodër. Qëllimi i hartimit të skenarëve ka qënë kryesisht edhe **për nxitjen e diskursit publik** mbi mundësitë e ndryshme të zhvillimit. Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër është parë në tre skenarë ekstreme të zhvillimit dhe shumë të kundërt me njëri tjetrin. **Qëllimi nuk është që të zbatohet njëri prej skenarëve**, por që duke analizuar alternativa ekstreme të nxitet diskutimi për arritjen e një vizioni i cili gjeneron konsensus të gjerë. **Gjithashtu, alternativat e zhvillimit të cilat janë ngritur nga grupi i punës janë në nivel konceptual, ato synojnë edhe ballafaqimin e mundësive të zhvillimit territorial me politikat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit.** Si të tillë, krahasimi i këtyre alternativave në fund ofron një konkluzion të rëndësishëm përsa i përket vizionit dhe objektivave të zhvillimit. Vizioni i Bashkisë Shkodër, nis nga ballafaqimi i tre skenarëve por jo detyrimisht përfaqëson njërin prej tyre. Skenari i tretë, edhe pse është ai që ka pasur konsens më të gjerë publik, nuk detajohet nga niveli konceptual në këtë fazë direkt në vizion, objektiva, programe dhe projekte. Ai është përshtatur që të përputhet më mirë edhe me kërkesat dhe komentet nga grupet e interesit.

**Skenari I: Shkodra e Shpërhapur**
***Zona Urbane:***
Ky skenar është ndërtuar duke ndjekur tendencat e zhvillimit aktual në territorin e Bashkisë. Në këtë rast planifikimi i territorit dhe zbatimi i planeve territoriale ka një rol shumë të vogël. Zhvillimi lihet në dorë të ekonomisë së lirë të tregut dhe është i pakontrolluar e orientuar. Qendrat kryesore urbane do të vazhdonin të zgjeroheshin me një densitet të ulët duke filluar nga qendrat ekzistuese drejt periferisë. Mungesa e investimeve dhe ofrimit të shërbimeve në zonat rurale e ato malore do të shtynte largimin e popullsisë nga zonat e thella rurale. Kjo qasje do të ruante tipologjitë historike brenda qytetit por do të përkeqësohet zënien e tokave bujqësore dhe burimet natyrore. Gjithashtu, zhvillimi informal dhe shpërhapja urbane do të predominonin. Zhvillimi urban do të kryhej pa një tipologji të caktuar urbane e cila më pas do të rezultonte në një situatë kaotike e cila do të vështirësontë ofrimin e infrastrukturës. Ky lloj zhvillimi i shpërhapur në dëm të tokave bujqësore dhe të gjelbra do të dëmtonte jo vetëm prodhimtarinë e tyre por edhe peizazhin rural.
***Shërbimet dhe Aktivitetet:***
Në skenarin e shpërhapur, shërbimet ofrohen në qëndrat kryesore urbane të bashkisë në qytetin e Shkodrës dhe në qytezën e Velipojës gjatë verës. Shërbimet do të kishin një kosto më të lartë për ofrim duke qënë se është e vështirë të krijohet ekonomia e shkallës për ofrimin e një shërbimi si rrjedhojë e dendësisë së ulët të zhvillimit në zonat periferike. Aktivitetet kryesore do të zhvilloheshin në qëndrën e Shkodrës, si dhe në Velipojë gjatë verës, ndërkohë që periferia do të kthehej në një “fjetore”. Gjithashtu, kjo tipologji zhvillimi do të rriste kostot edhe për ofrimin e shërbimit të transportit publik. Në fund ekonomia do të transformohej kryesisht në urbane, në funksion të shërbimeve, ndërkohë që do të humbte potenciali për zhvillimin rural apo turistik.
***Infrastruktura:***

Në këtë rast infrastruktura do të duhej të zgjerohej dhe të degëzohej në periferitë e qendrave kryesore urbane. Gjithashtu, zgjerimi në tokë bujqësore apo dhe në zona me rreziqe natyrore në periferi do të rriste kostot publike për mbrojtjen e tyre. Pajisja me infrastrukturë të shërbimeve të ujit të pishëm dhe kanalizimeve të ujërave të zeza do të kishte një kosto të lartë për shkak të dendësisë së ulët të zhvillimit e cila nuk arrin ekonominë e shkallës. Gjithashtu, ky lloj zhvillimi do të kishte një kosto të lartë përsa i përket ofrimit të infrastrukturës rrugore urbane duke qënë se do të krijoheshin shumë degëzime e zgjatime. Ndërkohë, infrastruktura rrugore në zonat malore e rurale do të humbte prioritetin e investimit duke qënë se popullsia do të zhvendosej drejt periferisë së qëndrave urbane. Në këtë kontekst, shumë akse rrugore të rëndësishme përsa i përket aksesueshmërisë së zonave me potenciale natyrore, rurale, turistike e kulturore nuk do të kishin të njëjtin prioritet zhvillimi.




***Përputhshmëria me PPK dhe PINS Bregdeti:***

Ky skenar nuk është në përputhje me vizionin, objektivat dhe politikat e PPK dhe PINS Bregdeti. Të dy këto plane promovojnë kompaktësimin dhe densifikimin e qëndrave ekzistuese. Gjithashtu, planet kombëtare propozojnë edhe zhvillimin e qëndrave të vogla lokale në bazë të karakteristikave dhe pikat të tyre të forta çka nuk mund të arrihet nga përdorimi i alternativës së zhvillimit të shpërhapur. Njëkohësisht, ky lloj zhvillimi bie ndesh me propozimet e PPK dhe PINS përsa i përket përdorimit të mjeteve të qëndrueshme të transportit duke qënë se është një lloj zhvillimi i bazuar tek automobili. Ky lloj zhvillimi cënon tokën bujqësore si dhe tokat natyrore ndërkohë që në PPK dhe

PINS Bregdeti janë dy prioritete kryesore për mbrojtje. Presioni mbi burimet ujore dhe ndotjat e tyre si rrjedhojë e zhvillimit në bazë të konceptit të shpërhapur do të shkaktonte impakte negative në sistemin ujor duke kontradiktuar objektivat dhe politikat e PPK.

**Skenari II: Shkodra Monocentrike**

***Zona Urbane:***

Qendra kryesore urbane e Bashkisë Shkodër (qyteti Shkodër) rritet brenda kufijve aktual duke rritur densitetin. Dendësia më e lartë do të sjellë zgjedhjen tipologjive të larta të ndërtesave dhe përdorimin e shumicës së parcelave ekzistuese boshe për ndërtimin, dhe ose mbushjen e konsolidimin e zonave të cilat nuk kanë mbushur kapacitetin mbajtës. Fshatrat më të largëta janë të destinuar në këtë rast të tkurren. Ky skenar mund të jetë i dobishme për ruajtjen e tokës bujqësore dhe burimeve natyrore. Dëmet nga përmbytjet e mundëshme në këtë rast do të ishin më të ulëta për shkak se ndërtimi do të ishte i përqendruar dhe masat për parandalimin e përmbytjeve mund të përdoret në zonat më të kufizuara.

***Shërbimet dhe Aktivitetet:***

Në skenarin monocentrik, shumica e shërbimeve ofrohen në qendrat urbane më të mëdha të bashkisë (Shkodër, Velipojë). Ky fakt do të bënte që autoritetet të ofronin shërbime në mënyrë më efikase në qendrat urbane, por do të rrisë pabarazitë mes zonave urbane dhe zonave rurale. Gjithashtu, ky lloj skenari do të kompaktësojë edhe zonat periferike të zhvilluara në mënyrë informale duke promovuar densifikimin dhe ristrukturimin e tyre. Aktivitetet kryesore sociale dhe ekonomike do të përqëndrohen në Shkodër, dhe në Velipojë gjatë verës. Ndërkohë zonat e tjera do të kenë një mangësi në çështje të mbulimit me shërbime. Densifikimi shumë i madh i qëndrës është një mundësi e humbur përsa i përket zhvillimit ekonomik edhe në zonat rural e malore. Skenari monocentrik, promovon zhvillimin e aktiviteteve vetëm në qëndrën e qytetit.

***Infrastruktura:***

Duke patur parasysh përqendrimin e zhvillimit urban dhe të shërbimeve, infrastruktura kryesore e re do të duhej të projektohej në brendësi të zonave urbane ekzistuese duke e bërë më të lehtë për autoritetet lokale sigurimit e aksesit në të. Në zonat e largëta rurale do të ofrohej në këtë rast një infrastrukture shumë e kufizuar. Presioni në infrastrukturën e kanalizimeve, ujit të pishëm dhe elektricitetit do të ishte më i lartë dhe i përqëndruar vetëm në zonën e qytetit të Shkodrës. Rreziku tjetër i këtij skenari, alternative zhvillimi është trafiku dhe nevoja për parkime të zgjeruara.

***Përputhshmëria me PPK dhe PINS Bregdeti:***

Ky skenar i mbështetur në konceptin e zhvillimit monocentric është pjesërisht në përputhje me planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin e integruar ndërsektorial për bregdetin. Ai promovon mbrojtjen e tokës bujqësore dhe asaj natyrore, por njëkohësisht promovon dhe migrimin nga zonat rural drejt qëndrës urbane. Zhvillimi monocentric gjithashtu do të ndikonte në mënyrë indirekte në rritjen e segregimit social dhe të pabarazive midis qëndrës dhe zonave rurale në kundërshtim me objektivat e PPK dhe PINS Bregdeti për kohezion territorial. Gjithashtu, zhvillimi shumëdimensional i turizmit do të kishte vështirësi për tu realizuar si rrjedhojë e migrimit të popullsisë drejt zonës urbane. Në fund, ky skenar promovon ekonominë urbane dhe atë të shërbimeve duke krijuar një varësi të madhe në shërbime.




**Skenari III: Shkodra Policentrike**

***Zona urbane***

Skenari policentrik kërkon një qasje të kombinuar në zonat urbane dhe rurale. Sistemi policentrik paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qëndër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Skenari policentrik nuk është domosdoshmërisht i lidhur me ndërtimin, por më shumë me kohezionin dhe shpërndarjen e disa shërbimeve bazë për komunitetin. Zona urbane e Shkodrës do të

kishte nevojë të krijonte qendërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qendërsi të reja urbane do të konsolidonin strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale do të kishin nevojë për të përmirësuar qendate ekzistuese. Kjo qasje do të ruante tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Rreziqet e përmbytjeve në këtë rast do të ishin më të ulëta për shkak se zonat e ndërtuar rurale është do të ishte e përqendruar dhe në këtë mënyrë, masat që duhen marrë për parandalimin e përmbytjeve mund të përdoret në zona më të kufizuara. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarkie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohe që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërhapur në territor.

***Shërbimet dhe Aktivitetet:***

Shërbimet publike janë të shpërndara në të gjithë shtrirjen e bashkisë së re duke u përqendruar në qendrat e reja të njësive (ish komunat) duke patur në Shkodër dhe një përqendrim të madh dhe duke u përpjekur për të specializuar çdo njësi në bazë të prirjeve të tyre historike. Shërbimet orientohen sipas hierarkisë së qëndrave ku sa më e vogël hierarkia aq dhe më bazë është kombinimi i shërbimeve, ndërkohë që për qytetin Shkodër i cili konsiderohet si qëndër primare edhe në PPK shërbimet që ofrohen janë të një cilësie dhe madhësie më të lartë. Aktiviteti ekonomik do të ketë mundësi që të zhvillohet në mënyrë më të diversifikuar si rrjedhojë e politikave incentivuese të cilat mbajnë popullsinë në zonat rurale. Gjithashtu, ky skenar, në dallim me dy të tjerët lejon kohezionin territorial.

***Infrastruktura:***

Prania e një infrastrukture lidhësë veri-jug është jetike për zbatimin e këtij skenari. Kjo strukturë do të lejonte një akses të përshtatshëm në shërbime për zonat e thella të Bashkisë Shkodër. Do të kërkonte një investim më serioz edhe në infrastrukturën rrugore në zonat rurale e malore duke garantuar aksesin. Infrastruktura duhet përmirësuar edhe nga fshatrat drejt qëndrave lokale të cilat janë lokuset e shërbimit.




***Përputhshmëria me PPK dhe PINS Bregdeti:***

Skenari i tretë përputhet më shumë me vizionin, objektivat dhe politikat e PPK. Ky skenar promovon një zhvillim shumë-dimensional të ekonomisë dhe arritjen e qëllimit për zhvillimin rajonal. Gjithashtu, krijohet një hierarki qëndrash nga primare urbane (qyteti Shkodër) deri tek qëndra lokale të cilat ofrojnë shërbime bazë për komunitetin. Ky skenar promovon mbrojtjen e burimeve natyrore e ujore. Gjithashtu, garanton mundësi për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor sipas parashikimeve të PPK dhe PINS.

## Kapitulli 3- Vizioni dhe Objektivat dhe Sistemet

Përpara se të kalohet tek deklarata e vizionit është e rëndësishme që të përmenden disa nga **direktivat kryesore të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit** të cilat impaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë vizionin e bashkisë Shkodër:

- **Konsolidimi dhe Hierarkizimi i Qëndrave**
- **Qytet "Portë" e rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare**
- **Pjesë e Rajonit të Eko-turizmit**
- **Pol Bujqësor**
- **Pjesë e Rajonit Ekonomik Lezhë-Shkodër**
- **Pjesë e Rajonit Natyror**
- **Pjesë e Rajonit Ndërkufitar Shkodër-Podgoricë**
- **Nyje e rëndësishme Energjitike**
- **Nyje e rëndësishme Transporti rrugor dhe Hekurudhor**



Përtej direktivave të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit, janë përcaktuar tre parime kryesore të cilat fuqizojnë më tej direktivat si dhe shërbejnë si drejtuese të vizionit, objektivave dhe ndërhyrjeve në territorin e Shkodrës:

- Parimi **Shkodra e Gjelbër (Green and Resilience)**-përtej kuptimit konvencional të shtimit të hapësirave të gjelbra dhe mbrojtjes së zonave natyrore, ndërhyrjet në territorin e bashkisë Shkodër duhet të jenë sa më miqësore ndaj mjedisit me qëllim për të arritur standarte sa më të larta ekologjike;
- Parimi **Shkodra Inteligjente (Smart)** -fokus tek ndërhyrjet dhe propozimet duhet të ketë tek rritja e kapaciteteve në sistemet e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, me konceptin Shkodra inteligjente, lidhet dhe "përdorimi i tokës" në mënyrë sa më efikase dhe efiçiente pa shkaktuar dëme në mjedis;
- Parimi **Shkodra e Jetueshme (Liveable)** -fokus tek rritja e cilësisë së jetesës, përmirësimit të hapësirave të ndërtuara dhe publike me qëllim rritjen e cilësisë së tyre për të krijuar një mjedis komod dhe atraktiv për të jetuar, punuar e vizituar.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në konsultat me palë të interesuara e qytetarë është hartuar deklarata e vizionit për Bashkinë Shkodër:

***"Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qëndër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.***
***Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qëndër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.***
***Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.***
***Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballet me sukses me rrezikun e përmbytjeve"***




## 3.2 Objetivat Strategjike

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjikë, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

**Objektivi Strategjik 1- Përmirësimi Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale**

Bazuar në **(draft) PPK dhe PINS Bregdeti** Shkodra shihet si "qytet portë". Në këtë kontekst është e rëndësishme ndërlidhja më e mirë e bashkisë në nivel rajonal duke shfrytëzuar transportin rrugor,

hekurudhor dhe ujor. Për të mbështetur ndërlidhjen dhe lehtësuar lëvizshmërinë, kujdes i veçantë do të tregohet tek zgjidhja e "pikave të zeza" të trafikut (MTI) si dhe tek hapja e terminaleve multimodale.

Objektivi është që Shkodra të ketë 1 Terminal të rëndësishëm multimodal ndërkombëtar i cili ndërthur transportin automobilistik me atë hekurudhor tek ish-Stacioni i Trenit. Gjithashtu do të zhvillohet dhe një terminal i integruar ndërkombëtar (sezonal) në Velipojë i cili do të shërbejë për rregullimin e trafikut gjatë verës me Malin e Zi, Kosovën dhe me qëndra të tjera në Shqipëri. Ky terminal do të jetë i kombinuar me transportin publik rrethqytetas. Ndërkohë do të zhvillohet dhe një terminal i vogël ujor në Liqenin e Shkodrës, pranë Bexhistenit, i cili do të garantojë lëvizjen për qëllime turistike në liqen.

Përsa i përket përmirësimit të aksesit, ky objektiv synon përmirësimin e lidhjeve të Bashkisë Shkodër me akse të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare.

**Bazuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe PINS Bregdeti janë tre korridore të rëndësishme të cilat kalojnë në Shkodër**:

- **Korridori/Autostrada Veri Jug** - [Podgoricë - Hani i Hotit - Shkodër - Gjirokastër] siguron përshkueshmërinë e shpejtë të territorit dhe lidhjen me vendet e Ballkanit perëndimor dhe të Europës Jug - Lindore. Ky korridor do të perforcohet nga rivitalizimi i linjes hekurudhore ekzistuese dhe permiresimi i saj.

- **Korridori/Autostrada Adriatiko-Joniane** – [Ulqin - Muriqan – Shkodër – Lezhë – Milot – Thumanë – Durrës - Levan – Kakavijë]

- **Rruga Peisazhistike Bregdetare** – [Ulqin - Velipojë – Shëngjin - Patok - Durrës - Divjakë - Seman - Vlorë -Dhërmi - Sarandë - Butrint] një nga lidhjet me strategjike për sa i perket forcimit të ekonomisë së turizmit bregdetar të vendit dhe agro turizmit. Rruga do të jetë e tipit peisazhistik, me impakt të ulet në mjedis dhe do të shtrihet përgjatë segmenteve egzistuese me qëllim që të minimizojë ndikimin në zonat e mbrojtura. Kjo rrugë do të pajiset me sinjalistikën e nevojshme në lidhje me sigurinë dhe informacionin turistik. Duke respektuar direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti gjurma e kësaj rruge ndjek gjurmët egzistuese duke shmangur ndërhyrjet e forta në terrenet me morfologji të vështirë ku ndërhyrja do të kishte impakt të madh mjedisor.

Në kuadër të përmirësimit të aksesit, do të rregullohen dhe riasfaltohen edhe akset kryesore lidhëse me qëndra të tjera në rajon të tilla si:

- Zogaj- Pika e kalimit kufitar, doganë
- Theth- Valbonë (shteg pejsazhistik për ecje, i pajisur me masat e duhura të sigurisë dhe sinjalistikës)
- Shkodër- Vau Dejës
- Shkodër- Prekal
- Shkodër- Theth
- Shkodër- Pukë
- Shkodër- Koman
- Vau Dejës- Velipojë
- Shkodër-Lezhë

Gjithashtu, në kuadër të përmirësimit të aksesit synimi është që të ofrohen zgjidhje përfundimtare për disa nga nyjet më të rëndësishme të trafikut si:

- Bahçallët-Ura Bunës
- Harku i Bërdicës
- Shtoj
- Mes

- Ura e Kirit

**Bazuar në PPK dhe PINS Bregdeti**, Shkodra është pjesë e rajonit ndërkufitar ku promovohen marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Në kuadër të Programit për Bashkëpunimin Ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri IPA 2 (2014-2020) do të bashkëpunojë me aktorët e tjerë kombëtare si Ministri të linjës dhe Qarkun Shkodër si dhe me aktorë të palës malazeze për hartimin e strategjive rajonale dhe projekteve specifike. Fusha e veprimit në këtë bashkëpunim do të bazohet në hartimin dhe harmonizimin e strategjive sektoriale për mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit dhe të paketave turistike të harmonizuara, zhvillimin rural dhe transport. Bashkia Shkodër kërkon të luajë një rol të rëndësishëm edhe në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe krijimin e marrëdhënieve me aktorë të ndryshëm si OJQ për aplikimin me projekte në fushat e përcaktuara nga programi i Bashkimit Europian për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi.

**Për arritjen e Objektivit Strategjik 1 janë përcaktuar Programet Strategjike si më poshtë:**

- **Programi Strategjik OS1PS1:** Terminalet Multimodale
- **Programi Strategjik OS1PS2**: Rregullimi i Portave hyrëse në Shkodër
- **Programi Strategjik OS1PS3:** Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare
- **Programi Strategjik OS1PS4:** Bashkëpunimi Ndërkufitar

**Objektivi Strategjik 2- Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses**

Objektivi i integrimit territorial dhe barazisë në shërbime e akses lidhet fillimisht me kapërcimin e disa prej sfidave me të cilat Bashkia Shkodër përballet si rrjedhojë e reformës territoriale administrative. Synohet ngritja e kapaciteteve lokale në ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë Bashkinë dhe përshtatja e tyre me popullsinë dhe me kushtet lokale. Disa nga fushat në të cilat do të ngrihen kapacitetet lokale lidhen me:

- Planifikimin/menaxhimin dhe zhvillimin e territorit
- Zhvillimin rural
- Menaxhimin e pyjeve dhe kullotave
- Trajtimin e çështjeve sociale të tilla si pabarazitë gjinore, dhuna në familje, dhuna ndaj gruas e fëmijëve etj

Shërbimet sociale do të përmirësohen në mënyrë që të arrihet një efiçientim i burimeve dhe resurseve për të ofruar një cilësi sa më të mirë jetese tek qytetarët. Në fuksion të policentrizmit shërbimet sociale do të ofrohen të përqëndruara duke përshtatur strukturat. Qëndra multifunksionale të specializuara do të ngrihen në qëndrat njësive administrative. Prioritet janë:

- Përmirësimi i shërbimit të arsimit
- Përmirësimin e kushteve të qëndrave shëndetësore

Do të përmirësohet aksesi në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe mbështetjen e efiçientimit të ofrimit të shërbimeve. Gjithashtu, akset rrugore do të përmirësohen edhe nga pikëpamja e sigurisë dhe mbështetjes me sinjalistikën e përshtatshme.

Në funksion të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, Bashkia shkodër synon të rrisë aksesin e publikut ndaj tyre me anë të ofrimit të disa shërbimeve elektronike dhe me anë të krijimit të qëndrave me një ndalesë. Do të ngrihet një databazë e integruar e informacionit e cila do të lejojë në mirëmenaxhimin e burimeve lokale. Për realizmin e objektivit strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike:

- **Programi Strategjik OS2PS1:** Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)
- **Programi Strategjik OS2PS2:** Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane
- **Programi Strategjik OS2PS3:** Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale
- **Programi Strategjik OS2PS4:** Qeverisja Elektronike
- **Programi Strategjik OS2PS5:** Qëndrat Multifunksionale dhe shërbimet Sociale

### Objektivi Strategjik 3- Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik

Për të rritur rolin e Shkodrës në rajon, e rëndësishme është që edhe sektorët ekonomikë të cilët kontribuojnë në Bashki të rrisin konkurencën e tyre në tregjet rajonale e kombëtare. Sektorët ekonomikë do të jenë një vlerë e shtuar për njëri tjetrin në mënyrë që të mos shkaktojnë dëme. Kjo gjë do të garantojë dhe zgjatjen e zinxhirit të vlerave të ekonomisë sipas direktivave të paracaktuar edhe në Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit. Zhvillimi ekonomik do të ketë një **përqasje ndaj mejdisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të Shkodrës** duke u përputhur me vizionin e **PPK dhe PINS Bregdeti** si pjesë e rajonit natyror.

Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër. Kujdes i veçantë do të tregohet për integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Punësimi do të mbështetet me mundësitë për shkollim dhe trajnim profesional. Një tjetër sektor i rëndësishëm i cili do të promovohet dhe mbështetet si një ndër sektorët prioritare është edhe artizanati.

Zona industriale do të kthehet në një zonë të rëndësishme ekonomike ku do të aplikohen politika të cilat promovojnë rigjenerimin e ish-zonave industriale si dhe do të ndërlidhin më mirë këtë zonë me dy akse prioritare ekonomike **Shkodër-Lezhë dhe Shkodër-Koplik, duke krijuar një vazhdimësi dhe forcuar rolin e zonës ekonomike si pjesë e rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë dhe rajonit ndërkufitar Podgoricë-Shkodër nga direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti.**

Do të rritet **aksesueshmëria e produkteve vendase në tregjet rajonale** si dhe do të sigurohet që ato të arrijnë të promovohen. Shkodra shihet si një pol i rëndësishëm bujqësor ku produktet vendase dhe veçanërisht produktet bio do të stimulohen.

Turizmi shihet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik dhe si një vlerë e shtuar e sektorëve të tjerë. Pra koncepti i turizmit nuk duhet të jetë sektorial, por i integruar dhe bashkërenduar me sektorët e tjerë ekonomik **bazuar edhe në direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti**. Në këtë mënyrë, futja e konceptit të turizmit edhe në sektorë të tjerë si shërbimet, zhvillimi rural, shërbimet etj bën që edhe zinxhiri ekonomik i tyre të zgjatet duke garantuar komplementaritetin dhe të ardhurat shtesë. Akset prioritare të turizmit në Bashkinë Shkodër do të jenë **Ekoturizmi**, **agroturizmi**, turizmi kulturor dhe historik, turizmi malor, turizmi det dhe rërë. Secili prej sektorëve do të mbështetet me anë të politikave të ndryshme dhe projekteve.

Së fundmi, suksesi për tek rritja e rolit të Shkodrës në Rajon do të plotësohet me anë të përmirësimit të imazhit dhe promovimit të Shkodrës. Bashkia do të krijojë një strategji të sajën për "brandimin" (vendosjen e një marke) për Shkodrën. Në kuadër të realizimit të Objektivit Strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike si më poshtë:

- **Programi Strategjik OS3PS1:** Zhvillimi Rural
- **Programi Strategjik OS3PS2:** Zhvillimi Akuakulturës
- **Programi Strategjik OS3PS3:** Zhvillimi Turizmit
- **Programi Strategjik OS3PS4:** Mbështetja e Sipërmarrjeve të reja
- **Programi Strategjik OS3PS5:** Zhvillimi i Zonave Ekonomike
- **Programi Strategjik OS3PS6:** Branding i Bashkisë Shkodër

### Objektivi Strategjik 4- Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban

Ky objektiv lidhet drejtpërdrejtë me zonat e urbanizuara dhe me impaktin që këto zona kanë në cilësinë e jetesës së banorëve. Ky objektiv, synon konsolidimin dhe mos lejimin e konceptit të shpërhapjes urbane duke përmirësuar cilësinë e ndërtuar dhe zhvillimin në zonat urbane ekzistuese (**direktiva të PPK dhe PINS Bregdeti**). Qëllimi është që zhvillimi urban të orientohet me anë të politikave e projekteve drejt ofrimit të një mjedisi të ndërtuar i cili ofron kushte të mirë për qytetarët dhe zhvillimin e aktiviteteve të tyre social kulturore.

Në këtë kuadër, bazuar edhe në **PINS Bregdeti** do të rikualifikohen ballinat ujore të Bashkisë Shkodër sipas konceptit:

- Buzë Liqeni (Park rekreativ për Shkodrën)
- Breg Liqeni (Nga ura e Bunës deri në Zogaj si hapësirë për zhvillimin e turizmit liqenor)
- Velipoja (Ballina ujore e një qyteze bregdetare duke përfshirë aktivitete e hapësira sociale)
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore të Lumit Kir
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore të Lumit Drin
- Rehabilitimi i Ballinës Ujore Lumi Bunë (Park Kombëtar/ ekologjik)

**Bazuar në PINS Bregdeti, duhet valorizuar dhe mbrojtur arkitektura tradicionale e zonave urbane e rurale.** Në këtë sens do të konservohen zonat historike dhe do të zgjerohen rrugët pedonale në këto zona në mënyrë që të mbrohet trashëgimia kultuore, historike, urbanistike e arkitektonike e qytetit të Shkodrës dhe qëndrave të tjera të urbanizuara. Do të ndihmohen pronarët për restaurimin e ndërtesave historike. Për të mbrojtur këto zona do të aplikohet instrumenti i transferimit të të drejtave për zhvillim.

Do të integrohen zonat informale përreth Shkodrës duke i dhënë jo vetëm infrastrukturën e posaçme por edhe shërbimet socio-kulturore. **Bazuar në direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti**, në varësi të pozicionimit të tyre në territor dhe afërsisë me elementë të fortë territorial zonat informale do të integrohen sipas koncepteve:

- Lagjia Kiras (buzë liqeni) me konceptin e qytetit kopësht (duke qënë se ndodhet pranë hapësirës rekreative/parkut rekreacional)
- Rrethinat me konceptin "urban agriculture/agricultural garden duke qënë se ndodhen pranë tregut rajonal të bujqësisë
- Lagjia Mark Lula (integrim duke përdorur rikualifikimin e stacionit të trenit apo dhe prania me zonën industriale/ekonomike e cila do të gjenerojë punësim)
- Do të përmirësohet cilësia e jetesës dhe do të integrohen lagjet e komuniteteve rome

Do të rigjenerohen/rikualifikohen lagjet e tjera duke përmirësuar cilësinë e ndërtesave, cilësinë infrastrukturore të rrugëve dhe cilësinë e hapësirave publike e të gjelbra. Gjithashtu qëndrat e fshtrave do të rikualifikohen në mënyrë që të mbështetet rivitalizimi i tyre bazuar edhe në **politikat e PINS Bregdeti.**

Deri në vitin 2030 do të rritet koefiçienti i gjelbërimit për banorë. Do të përmirësohen hapësirat publike dhe do të kthehen në ambjente të këndshme e funksionale për qytetarët e Shkodrës. Do të shtohen parqet e lodrave dhe hapësirat sportive e rekreacionale për të garantuar një stil jetese sa më aktiv. Gjithashtu, do të promovohen funksione të reja në zonat pranë liqenit si hapësira për sportet e ujit, hapësira për festivale e koncerte, hapësira për jetën e natës. Cilësia e mjedisit do të vazhdojë të përmirësohet duke rritur aksesin në hapësira të gjelbëra dhe gjelbërim brenda venbanimeve.

Do të përcaktohet kufiri i brezit të gjelbër, si politikë për të parandaluar shpërhapjen urbane e cila është direktivë **nga PPK dhe PINS Bregdeti**. Ky brez do të mbrohet dhe pasurohet me bimësi të ndryshme për të rritur cilësinë e mjedisit dhe frymëmarrjen e vendbanimeve. Zonat të rëndësisë së veçantë natyrore do të mbrohen në mënyrë që të mos cënohet integriteti i tyre dhe të jenë një vlerë e shtuar në Bashki. Një rrjet i qënësishëm i gjelbër do të krijohet në mënyrë që të ofrohen alternativa për rekreacion dhe shlodhje.

Deri në vitin 2030 zonat urbane të Bashkisë Shkodër do të jenë të mbuluara me shërbimin e ujit të pishëm dhe me kanalizime të ujërave të zeza bazuar **edhe në objektivat e PPK dhe PINS Bregdeti**. Do të zhvillohet impianti i trajtimit të ujërave. Do të përmirësohet menaxhimi i ujërave të rreshjeve të shiut në mënyrë që të riciklohet dhe ripërdoret për qëllime të ndryshme urbane. Menaxhimi i ujërave të rreshjeve do të kryhet duke aplikuar konceptin e "infrastrukturës së gjelbër".

**Bazaur në Strategjinë Kombëtare të Strehimit Social** do të rritet numri i banesave sociale dhe atyre me kosto të pranueshme. Kjo gjë do të arrihet me anë të instrumentave të ndryshëm si zhvillimi me kushte apo transferimi i të drejtave për zhvillim. Banesat sociale gjithashtu do të ofrohen edhe me

anë të projekteve të drejtpërdrejta nga bashkia. Ndërkohë do të përdoren edhe instrumenta financiare dhe mbështetje financiare për të garantuar rritjen e numrit të banesave me kosto të përballueshme në zonat urbane për familjet në nevojë dhe për çiftet e reja.
Bazuar në politikat e **PPK dhe PINS Bregdeti** do të përmirësohet efiçienca energjitike e ndërtesave ekzistuese duke krijuar partneritete me banorët dhe me operatorët privatë. Do të aplikohen standarte të larta për të garantuar efiçiencë energjitike tek banesat e reja. Ndërkohë, do të promovohet edhe përdorimi i energjisë diellore veçanërisht për qëllime turizmi dhe bujqësore bazuar edhe në politiakt e **PPK dhe PINS Bregdeti për energjinë e rinovueshme.**
Infrastruktura do të përshtatet në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse. Hapësirat publike dhe institucionet do të jenë të parat të cilat do të përshtaten për të garantuar akses nga të gjithë. Mobiliteti në Shkodër synon që deri në vitin 2030 Shkodra të ketë një ndarje të ambicioze midis modaliteteve të ndryshme të transportit 30% biçikleta, 25% transport publik, 25% këmbësorë dhe 20 % makina individuale duke u përputhur edhe me **direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti**. Për këtë do të zgjatohet rrjeti i rrugëve pedonale.
Gjithashtu do të zgjerohet rrjeti i transportit publik në mënyrë që të përfshijë jo vetëm qytetin por edhe njësitë administrative. Do të zgjatohen më tej rrugëkalimet për biçikletat në zonat urbane me parimin e hapësirës së përbashkët (për të mbrojtur dhe kulturën e pedalimit në Shkodër) dhe me korsi të ndara në zonat ku shpejtësia e makinave është me e madhe. Gjithashtu, do të shtohen hapësirat e parkimeve publike. Do të zhvillohen tre parkingje të mëdha me konceptin "park & ride", në të cilat do të ofrohet edhe transporti publik dhe marrja me qera e biçikletave.
Për realizimin e objektivit strategjik janë përcaktuar një sërë programesh strategjike të cilat më pas do të detajohen në projekte dhe politika:

- **Programi Strategjik OS4PS1:** Rikualifikimi i Ballinave Ujore
- **Programi Strategjik OS4PS2:** Restaurimi i Ndertesave Historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore
- **Programi Strategjik OS4PS3:** Rikualifikimi i Hapësirave Industriale dhe Përdorimi i 'Brownfield'
- **Programi Strategjik OS4PS4:** Urbanizimi i Zonave Informale
- **Programi Strategjik OS4PS5:** Rigjenerimi Urban
- **Programi Strategjik OS4PS6:** Përmirësimi dhe Integrimi i Komuniteteve Rome dhe Egjyptiane
- **Program Strategjik OS4PS7:** Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban
- **Programi Strategjik OS4PS8:** Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive
- **Program Strategjik OS4PS9:** Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ
- **Programi Strategjik OS4PS10:** Strehimi Social dhe i Përballueshëm
- **Programi Strategjik OS4PS11**: Efiçienca Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme
- **Programi Strategjik OS4PS12**: Transporti Publik
- **Programi Strategjik OS4PS13**: Biçikletat
- **Programi Strategjik OS4PS14**: Gjallëria Urbane
- **Programi Strategjik OS4PS15**: Parkimet

### Objektivi Strategjik 5- Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore

**Bazuar në PPK dhe në PINS Bregdeti ka dy implikime kryesore përsa i përket Bashkisë Shkodër në lidhje me mjedisin:**

- Zgjerimi i Parkut të Thethit
- Shpallja e Lumit Buna në Park Kombëtar.

Bashkia Shkodër, me territorin e saj të zgjeruar tashmë, është e kërcënuar nga disa rreziqe natyrore si përmbytjet, erozione dhe rrëshqitjet e tokës. Me anë të krijimit të programeve të veçanta do të

synohet mirëmbajtja e përmirësimi i metodave ekzistuese të mbrojtjes ndaj rreziqeve natyrore. **Bazuar edhe në PPK** zhvillimi në zonat me rreziqe natyrore është kategorikisht i ndaluar dhe ato zona të cilat janë subjekt kërcënimi do të menaxhohe dhe mbrohen me projekte të veçanta, si fortifikimi i digave mbrojtëse dhe argjinaturave, pyllëzime apo dhe masave inxhinierike për mbrojtjen nga erozioni dhe rrëshqitjet e tokës.

Ndryshimet Klimatike janë sfida më e madhe afat-gjatë me të cilën përballet bota në ditët e sotme. Marrja e masave për adaptimin ndaj ndryshimeve klimaterike duhet të kthehet në një prioritet për planifikimin e territorit dhe qeverisjet vendore. Ato mund të ndihmojnë duke vepruar për përmirësimin e kushteve të komuniteteve në mënyrë të tillë që të jenë sa më të qëndrueshme dhe të adaptueshme ndaj ndryshimeve klimaterike. Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor, do të parashikohet një rregullore e veçantë, për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike në territorin e bashkisë Shkodër. Ky dokument synohet të kthehet më pas në një rregullore.

**Bazuar në direktivat e PPK**, duhet të rritet sasia e mbetjeve të cilat shkojnë në lendfillin e Bushatit si dhe të aplikohet riciklimi dhe kompostimi. Bashkia synon menaxhimin sa më të mirë të mbetjeve dhe për këtë do të hartohet edhe strategjia vendore e menaxhimit të tyre bazuar në strategjitë dhe politikat kombëtare. Bashkia Shkodër do të promovojë riciklimin e mbetjeve urbane ku si fillim do të trajtohen letra dhe metalet. Bashkia do të krijojë mundësinë për ndarjen e mbetjeve që në burim, duke krijuar kosha të diferencuar. Programe të veçanta do të aplikohen për riciklimin, jo vetëm në aspektin e menaxhimit të mbetjeve por edhe në edukimin e qytetarëve dhe ndërgjegjësimin e tyre.

Për realizimin e këtij objektivi janë përcaktuar një sërë programesh strategjike:

- **Programi Strategjik OS5PS1:** Mbrojtja e Mjedisit
- **Programi Strategjik OS5PS2:** Mbrojtja nga përmbytjet
- **Programi Strategjik OS5PS3:** Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane
- **Programi Strategjik OS5PS4:** Mbrojtja e akuifereve nga ndotja
- **Programi Strategjik OS5PS5:** Qëndra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve
- **Programi Strategjik OS5PS6:** Menaxhimi i Rreziqeve Natyrore
- **Programi Strategjik OS5 PS7:** Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave
- **Programi Strategjik OS5 PS8:** Ndryshimet Klimatike

## 3.3 Sistemet Territoriale

Një nga ndikimet kryesore që strategjia e territorit, plani dhe projektet strategjike sjellin në territor, është ndryshimi i mundshëm i sistemeve të territorit. Nëse në nivel planesh territoriale përgjithësisht sigurohemi që të krijojmë përdorime toke të përputhshme me njëra-tjerën, në nivel strategjik duhet të kuptohet edhe mundësia e ndryshimit të sistemeve territoriale (bujqësore, natyrore, ujërat, urbane dhe infrastrukturore), për dy arësye: 1) për të kuptuar efektet afatgjata të strategjisë dhe planit në çdo aspekt (territorial, mjedisor, social dhe ekonomik); 2) për të kuptuar, parashikuar dhe rregulluar efektet e sektorëve të ndryshëm mbi njëri-tjetrin dhe si rezultat për të marrë masa ligjore e proceduriale për zbutjen e efekteve, ose për realizimin e tyre.

Si rezultat i zbatimit të vizionit të zhvillimit dhe projekteve strategjike në territor, pritet që të ndodhin edhe ndryshime të mundshme të sistemeve territoriale, pra konvertime të tokës nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime/transformime mund të ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave si dhe përmes disa procedurave ligjore të vendosura në legjislacionin sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat, etj.). Një ide paraprake të transformimeve të mundshme mund ta marrim që me hartëzimin e vizionit territorial të zhvillimit, duke e krahasuar atë me shtrirjen e sistemeve aktuale të territorit.

Sigurisht, kjo është një ide paraprake dhe orientuese, por ende asnjë vendim transformimi nuk është marrë, sepse për këtë nevojitet të përgatitet më parë plani i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave.

Transformimet e sistemeve në Shkodër bazohen tek objektivat strategjike të propozuara në kapitullin e tretë. Bazuar në VKM nr. 671/2015, sistemet në thelb do të ngelin po ato pra: sistemi natyror, urban, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor, por disa territore të bashkisë së madhe Shkodër mund të pësojnë ndryshime bazuar në tendencat e zhvillimit që propozohen në këtë strategji e më pas në plan. Sikurse u përmend më lartë, ndryshimet në këtë fazë janë orientuese dhe jo domosdoshmërisht do të ndodhin, apo do të ndodhin praktikisht në këtë formë. Pra, konvertimet e mundshme do të rishikohen në mënyrë më të detajuar në fazën e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Ekziston mundësia e konvertimit të tokave bujqësore përgjatë rrugës së Shkodër Hani Hotit në zonën e njësisë administrative Rrethinat, përgjatë propozimit për by-pass të ri në Shkodër dhe në zonën e Velipojës përgjatë aksit kryesor rrugor. Ky transformim mund të ndodhë për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik lokal dhe për të akomoduar shërbime të tilla tregtare dhe agazinimi/përpunimi, të cilat do të jenë në shërbim të zhvillimit të bujqësisë dhe të turizmit. Në fakt, transformime të tilla kanë ndodhur disi aktualisht për shkak të zhvillimit në mënyrë të shpërhapur dhe informal, që ka ndodhur në këto territore. Kjo do të thotë se konvertimet e mundshme që diktohen në këtë zonë nga strategjia e territorit, do të funksiojnë mbi parimin e kompaktësimit në zona me karakter ndërtimor të shpërhapur dhe të ruajtjes së zonave të tjera bujqësore nga urbanizimi i mëtejshëm.

Gjithashtu, referuar propozimeve që vijnë nga projekti i linjës së 'Korridorit Adriatik Jonian' edhe pse nuk ka ende një gjurmë të qartë, mendohet që të ndodhë një transformim i mundshëm i tokës bujqësore në tokë urbane/infrastrukturore. **Ky transformim është i justifikuar përmes Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të ndodhë.**

Nisur nga programet strategjike, ekziston mundësia e transformimit të sistemit urban/ infrastrukturor që ndodhet në aksin e bypass ekzistues në qytetin e Shkodrës. Kjo sipërfaqe e cila shtrihet në mënyrë gjatësore përgjatë gjithë shtrijes së bregut të liqenit, ka tendencën të transformohet në zonë natyrore me qëllim rehabilitimin e by-pass (argjinaturës) dhe pyllezimin e zhvillimin e zonës në një park dhe hapësirë rekreative përgjatë liqenit.

Në vijim tregohet një hartë indikative, e cila shpreh në mënyrë të përafërt konvertimet e pritshme të sistemeve në territorin e bashkisë Shkodër. Vlen të theksohet fakti se në këtë seksion janë treguar tendencat e mundshme të transformimeve, ndërkohë që gjatë hartimit të Planit të Propozuar të tokës ato do të detajohen më tepër dhe sipas rastit do të përgatiten për procedurat ligjore për konvertim


HARTA E SHTIMIT TE SISTEMEVE
TE TERRITORIT
PODGORICE
HANI I HOTIT
SHALE
PULT
SHOSH
KOPLIK
POSTRIBE
RRETHINAT
SHIROKE–ZOGAJ
SHKODER
GURI I ZI
MURIQAN
ANA E MALIT
BERDICE
KUKES
DAJÇ
VELIPOJE
ULQIN
LEZHE
TIRANA
LEGJENDA
KUFI BASHKIA SHKODER
HEKURUDHE
NYJE LEVIZJE
KORRIDORI PEISAZHISTIK BLU
Konvertimi ne sistem Infrastrukturor
Konvertimi ne sistem Urban
Konvertim ne sistem Natyror
Shtimi i siperfaqjes pyjore
Siperfaqja Natyrore e mbrojtur
Shtimi i siperfaqjes Natyrore te mbrojtur

| Sistemi | Tregues Sistemi Ekzistues | Parashikime | Komente |
|---|---|---|---|
| Sistemi Urban | Sipërfaqja e territorit urban (Stu. të përgjithshme)= 1.06% | → | Zhvillimi urban kryesishte do te konsolidohet Brenda qendrave ekzistuese,nuk do te kete zgjerim drejt tokave bujqesore.Ne disa raste mund te orientohet drejte tokave pa frut. |
| | Sipërfaqja e infrastrukturës/banore | ↗ | Permiresim te situates ekzistuese,zgjerim te rjetit infrastrukturor per te permbushur nevojat e banoreve ne zonat informale. |
| | Popullsia (ekzistuese)=137 612 Banorë; | ↗ | Sipas te dhenave te INSTAT treguesit e popullsise do te jene ne rrenje,por parashikimi jone eshte qe permiresimi I cilesise se jetes do te sjell dhe nje rritje te vogel te popullsise. |
| | Strehimi privat=<br><br>Strehim social= | ↗<br><br>↗ | Strehimi social eshte nje nevoje ne bashkine e Shkodres,ka patur rreth 5000 kerkesa per strehim social dhe kjo nevoje duhet adresuar. |
| | Shërbime administrative | ↗ | Permiresimi I sherbimeve administrative do te kryhet nepermjet disa instrumentave si:One stop shop,Qeverisjes elektronike dhe Agjensise per zhvillimin rural. |
| | Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë | ↗ | Qendra shendetesore 1 per 250-1500 banore,Ambulance-konsultore 1 per 1500-2000 banore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Transporti publik dhe privat (nr. makina/ familje) | ↗ → | Transporti public ne rritje,transporti privat ne renie |
| | Sipërfaqet e gjelbra/ banorë dhe sportive/ banorë | ↗ | Siperfaqja e gjelber te pakten $9m^2$ per banore,siperfaqjet e sportivete pakten $1.6m^2$ per banore |
| | Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banore; monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore | ↗ | |
| | Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare | → | |
| | Parkime/banore | → | Te pakten $6m^2$ per banore |
| Sistemi Bujqësor | Territor bujqësor | → | Do te kete pak konvertime te tokes bujqesore ne toke urbane,por keto konvcertime do te orientohen drejte tokave pa frut. |
| | Sip. Primar (Boniteti I-IV) | → | |
| | Sip. Territor Bujqësor Dytësor (Boniteti V-X) | → | |
| | Sip. T Bujqësor me sistem ujitjeje | ↗ | Ky system do te permiresohet sistemi i drenazhimit dhe uijtjes. |
| | Sip. T. Pafryt | ↘ | Zhvillimet e reja dhe ato infrastrukturore do te orientohen drejt tokave pa frut. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ujor | Ujëra tokësore | → | |
| | Ujëra Bregdetare | → | Do merren masa per mbrojtjen e tokave nga erozioni detar. |
| Infrastrukture | Sip. rrugë kombëtare=1.63% | ↗ | Ri rrjedhoje e kalimit te korridorit veri-jug,parashikohet te rritet % e rrugeve kombetare ne territorin e bashkise. |
| | Sip. rrugë interurbane=21.03% | ↗ | Si rrjedhoje e zhvillimit te rrjetit te infrastruktures,parashikohet te rritet % e rrugeve interurbane. |
| | Sip. rrugë urbane parësore=3.51% | ↗ | |
| | Hekurudha=1.93% | ↗ | Ne varsi te politikave dhe investimeve te MTI |
| | Porte Aeroporte | | |
| | Gazdote | ↗ | Kalimi IAP |
| | Elektrodote | ↗ | Linjat e interkoneksionit me Malin e zi |
| | Ujësjellës-Kanalizime | ↗ | Do te permiresohet rrjeti ekzistues I kanalizimeve dhe ujesjellsit,gjithashtu do te nderhyet per ti siguruar kete sherbim per te gjithe. |
| Natyror | Sip. e përgjithshme = 75.22% | → | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Sip. Pyjore= 7.2% | ↗ | Ripyllezim I zonave si mali I taraboshit |
| | Sip. Kullota=2.38% | ↗ | |
| | Sip. të gjelbra (jo urbane) | ↗ | |
| | Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm | ↗ | Lumi Buna do te behet park kombetare sipas PPk-se<br>Parku I Thethit zgjrerohet ne parkun e Alpeve |

# Kapitulli 4- Programet dhe Politikat dhe Konsiderata Financiare

Për realizimin e objektivave Strategjike dhe programeve në funksion të tyre, për secilin program janë përcaktuar një sërë politikash ose projektesh. Të fundit, janë ndarë në projekte strategjike dhe pilote.

***Objektivi Strategjik 1- Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale***

***Programi Strategjik OS1PS1: Terminalet Multimodale***

Janë identifikuar dy terminale multimodale të cilat zhvillohen në:

- Shkodër (Terminal Ndërkombëtar -Stacioni i Trenit)
- Velipojë (Terminal Sezonal- Stacioni Ekzistues i Autobuzave)
- Shkodër/Bexhisteni Terminal Ujor

Terminalet duhet të përfshijnë:

- Hapësirë për parkimin dhe ndalimin e autobuzave interurbanë
- Hapësirë për parkim të përkohshëm për udhëtarët
- Hapësirë për parkim afatgjatë
- Biletari dhe Tabela Elektronike Informuese për udhëtarët
- Hapësirë dhe Vendndalim (Stacion) për ndërlidhjen me autobuza dhe sistemin e transportit publik urban dhe rreth qytetas.
- Hapësirë për parkimin e biçikletave
- Hapësirë për marrjen me qera të biçikletave
- Hapësirë tregtare për shitjen dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për lehtësimin e udhëtimit të udhëtarëve

Aplikacionet online për lehtësimin e udhëtimit:

- Aplikacion për "telefonat smart" i cili tregon vendodhjen e stacionit, informacion mbi linjat e transportit dhe oraret e tyre, informacion për çmimet e biletave, informacion për linjat e transportit publik urban dhe rrethqytetas, mundësi për blerjen e biletave elektronike.
- Faqe online për informacion mbi lëvizjen dhe udhëtimin me të njëjtat karakteristika si aplikacioni për telefonat smart.

**Projektet**

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Terminali Ndërkombëtar Shkodër (Stacioni i Trenit) | Strategjik | Prioritet i Lartë |
| Terminali Sezonal Velipojë | Strategjik | Prioritet Shumë i Lartë |
| Terminali Ujor Turistik | Pilot | I mesëm |
| Aplikacioni online "Shkodra Transport" | Pilot | I ulët |




**Programi Strategjik OS1PS2: Rregullimi i Portave hyrëse në Shkodër**

Ky program ka si synim rregullimin estetik të portave hyrëse në Bashkinë Shkodër me anë të asfaltimit të rrugëve, vendosjes së dritave apo gjelbërimit. Qëllimi është përmirësimi i imazhit dhe rritja e atraktivitetit. Gjithashtu, ky program ka si qëllim edhe përmirësimin e qarkullimit të trafikut.

Për realizimin e këtij programi janë përcaktuar projektet:

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Rregullimi Estetik/Peizazhistik i rrugës Muriqan- Ura e Bunës | Strategjik | Prioritet i mesëm |
| Rregullimi i Hyrjes Bërdicë-Bahçallëk | Strategjik | Prioritet i mesëm |
| Rregullimi Estetik/Peizazhistik i rrugës Vau i Dejës-Shkodër | Strategjik | Prioritet i mesëm |

**Programi Strategjik OS1PS3: Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare**

Nëse Shkodra do të jetë e aksesueshme dhe të përmirësojë marrëdhëniet në rajon është e rëndësishme që të përmirësohet dhe cilësia e disa akseve rrugore apo të hapen disa akse të reja. Gjithashtu, përtej ofrimit të aksesit është e rëndësishme që të përmirësohet edhe **siguria rrugore bazuar në direktivat e PPK** në disa prej këtyre akseve të cilat janë burim aksidentesh.

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Aksi Rrugor Shirokë- Zogaj-Pika e kalimit kufitar, doganë (drejtim Virpazar) | Strategjik | Prioritet i mesëm (kërkuar edhe nga pala malazeze) |
| Kompletimi i Unazës Shkodër-Shalë-Theth-Bogë-Koplik<br>Aksi Shkodër-Theth | Strategjik | Prioritet i Shumë i Lartë |
| Velipojë- Pika e kalimit kufitar, doganë (drejtim Ulqin) | Strategjik | Prioritet i mesëm (kërkuar edhe nga pala malazeze) |
| By-Pass Lindor Qyteti Shkodër | Strategjik | Prioritet i Lartë |
| Aksi turistik Prekal- Koman | Strategjik | Prioritet i mesëm |
| Shkodër- Vau Dejës-Pukë | Strategjik | Prioritet i mesëm |
| Përmirësimi i sinjalistikës rrugore dhe elementëve të sigurisë në akset kryesore | | Prioritet i Lartë |
| Lidhja Ujore Bexhisten-Shirokë-Virpazar | Pilot | I Lartë (kërkuar edhe nga pala malazeze) |

**Programi Strategjik OS1PS4: Bashkëpunimi Ndërkufitar**

Ky program synon mbështetjen dhe ngritjen e strukturave për bashkëpunimin ndërkufitar midis bashkisë Shkodër dhe bashkive kufitare në Mal të Zi. Në këtë kontekst është e rëndësishme ngritja e një grupi pune për koordinimin e projekteve dhe të politikave dy palësh. Ngritjen e strukturave për shkëmbime eksperiencash. Ky program është më tepër i karakterit të marrëdhënieve institucionale. Gjithashtu shërben në ngritjen e kapaciteteve për harimin e planeve të përbashkëta si dhe në aplikimin për projekte në thirrje të IPA Cross Border Montenegro-Albania 2014-2020.

**Projekte**

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Hartimi i një plani veprimi për zhvillimin rajonal midis Bashkisë Shkodër-Bashkisë | Pilot | I mesëm |

| | | |
|---|---|---|
| Malësi e Madh dhe bashkive homologe në Malin e Zi. | | |
| Pikave kufitare Zogaj | Strategjik (jo kompetence e bashkise por bashkia duhet te kete rol nxitës ndaj autoriteteve të dy vendeve) | I lartë |
| Pika kufitare Pulaj | Pilot (jo kompetence e bashkise por bashkia duhet te kete rol nxitës ndaj autoriteteve të dy vendeve) | I mesëm |

Ky program mbështetet gjithashtu mbështetet edhe nga projekte të tjera të programeve të mësipërme ndër të cilat mund të përmenden akset e reja rrugore Zogaj-Virpazar, Velipojë-Ulqin. Gjithashtu, masat që duhen marrë për mbështetjen e projektit mbi lëvizjen ujore turistike në liqenin e Shkodrës koordinohen me anë të këtij programi.

**Objektivi Strategjik 2- Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses**

**Programi Strategjik OS2PS1:** Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)

Ky program, bazuar në metodologjinë e hierarkisë së qëndrave urbane të parashtruar në **PPK dhe PINS Bregdeti**, si dhe në parashikimet e këtyre dy planeve për qëndrat urbane të cilat janë pjesë e Bashkisë Shkodër parashikon krijimin dhe specializimin e qëndrave lokale. Qëllimi i këtij programi është arritja e kohezionit social si dhe përmirësimi i shërbimeve sociale.

***Parashikimet Demografike dhe Ekonomike për 2030***



| Njësia Administrative | Funksionet |
|---|---|
| Njësia Shkodër (Qytet) | Qëndër Urbane Primare:<br>- Qëndër Institucionale e drejtorive rajonale<br>- Universitet<br>- Terminal Ndërkombëtar<br>- Gjykatë<br>- Prokurori/ Polici<br>- Qëndër Ekonomike<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Bibliotekë<br>- Spital Rajonal<br>- Shkolla profesionale<br>- Qëndër Panairesh<br>- Zyra qëndrore e postës |
| Njësia Velipojë (Qyteza Velipojë) | - Qëndër Urbane Lokale e Specializuar në Turizmin det-rërë (Qyteza Velipojë)<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Shëndetësore<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Nyje Shërbimesh Bujqësore (Gomsiqe dhe Sektor Velipojë)<br>- Pol Natyror (Viluni)<br>- Pikë Informacioni Turistike<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Dajç | - Qëndër Rurale e Specializuar në Bujqësi<br>- Nyje Shërbimi Bujqësore<br>- Nyje Agro-turizmi<br>- Kamping<br>- Eko-turizmi<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Qëndër Grumbullimi për emergjencat natyrore<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Pikë Informacioni<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Bërdicë | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje Shërbimi Bujqësore<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Ana e Malit | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje shërbimi bujqësore<br>- Nyje Eko-turizmit (mali taraboshit)<br>- Pikë Kufitare<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore |

| | |
|---|---|
| | - Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Gur i Zi | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje shërbimi bujqësore<br>- Nyje Eko-turizmit (Drin)<br>- Nyje Agro-turizmi<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Rrethinat | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje shërbimi bujqësore<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Postribë | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje Eko-turizmi<br>- Nyje shërbimi bujqësore<br>- Treg i produkteve bio<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Qëndër Multifunksionale<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Pult | - Qëndër rurale e specializuar në bujqësi<br>- Nyje Eko-turizmi<br>- Nyje shërbimi bujqësore<br>- Zyrë lokale poste<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Shosh | - Qëndër rurale e specializuar në ekoturizëm<br>- Nyje ekoturizmi<br>- Zyrë lokale poste<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore<br>- Qëndër me një ndalesë<br>- Zyrë lokale poste |
| Njësia Shalë | - Qëndër rurale e specializuar në ekoturizëm dhe turizëm malor (qendra e njësisë Shalë)<br>- Qëndër rurale e specializuar në ekoturizëm dhe turizëm malor (Theth)<br>- Nyje ekoturizmi (Theth)<br>- Zyrë lokale poste (qendra e njësisë Shalë +Theth)<br>- Qëndër Arsimore e mesme dhe fillore (qendra e njësisë Shalë +Theth)<br>- Qëndër me një ndalesë (qendra e njësisë Shalë +Theth) |

| | |
|---|---|
| | - Zyrë lokale poste (qendra e njësisë Shalë +Theth)<br>- Pikë informacioni turistike (qendra e njësisë Shalë +Theth) |




**Programi Strategjik OS2PS2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane**

Ky program strategjik synon lidhjen e qëndrave kryesore urbane me infrastrukturat kombëtare dhe përmirësimi i aksesit të qendrave të njësive administrative në qytetin e Shkodrës, si dhe lidhjen së këtyre qendrave me njëra tjetrën. Përtej investimeve në infrastrukturë ky program synon dhe

krijimin e mundësive për transport publik ose "gjysëm-publik" duke shfrytëzuar forma të ndryshme partneriteti për të ofruar akses në zona periferike.

**Programi Strategjik OS2PS3: Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale**

Ky program synon ngritjen e kapaciteteve lokale dhe formimin e qëndrave me një ndalesë në mënyrë që të përmirësohen sa më shumë shërbimet administrative në ndihmë të komuniteteve. Kjo gjë do të arrihet nëpërmjet politikave të mëposhtme:

- Zgjerimit të shërbimit të Internetit në të gjithë zyrat e qëndrave administrative
- Ofrimi i Shërbimit me një ndalesë
- Trajnimeve

*Ngritja e kapaciteteve lokale*

Në mënyrë që të garantohet një zhvillim sa më i qëndrueshëm i Bashkisë si dhe të ofrohet një shërbim sa më cilësor ndaj qytetarit është tejet e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e punonjësve të qeverisë vendore dhe të vetë komuniteteve dhe anëtarëve të komunitetit. Në këtë aspekt janë identifikuar pesë fusha si më prioritaret:

- Planifikim dhe Menaxhim Territori
- Trajtimi i çështjeve sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore)
- Zhvillim Rural dhe Menaxhim Pyjesh
- Turizëm dhe guida turistike
- Menaxhim i rreziqeve natyrore

Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të territorit, trajnimet mund të konsistojnë në:

- Hartim politikash zhvillimi
- Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit
- Përdorim i GIS dhe Regjistrit të Territorit
- Menaxhim Projektesh
- Rregulla të përdorimit të tokës

Ndërkohë përsa i përket çështjeve sociale trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve mund të konsistojë në:

- Trajnime për trajtimin e rasteve të dhunës në familje
- Trajnime për trajtimin e grave të dhunuara
- Trajnime për këshillimin e të rinjve
- Trajnime për strehimin social

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve lokale do të kryhet me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetin e Shkodrës, Agjenci dhe Organizata të cilat operojnë në Shkodër sipas tematikave të mësipërme.

*Shërbimi me një ndalesë*

Ky shërbim mund të ofrohet më vete, pra në zyrat e njësisë administrative, dhe/ose në bashkëpunim me zyra të tjera si posta/policia/shkolla etj në varësi të kapaciteteve dhe institucioneve ekzistuese lokale. Në këtë kontekst zyrat me një ndalesë mund të luajnë edhe role këshillimore ndaj qytetarëve të tilla si:

- Informacion/Guida turistike
- 'Arkitekti Im'

Ofron këshillim për restaurimi/rikonstruksionin dhe ndërtimin e objekteve në mënyrë që të bëhen konform rregullave ligjore dhe në mbrojtje të trashëgimisë arkitektonike apo karakteristikave lokale. Programi "Arkitekti Im" synon gjithashtu lidhjen me procesin e legalizimit të zonave informale. Ai synon zbutjen dhe informimin e këtij procesi por gjithashtu u vjen në ndihmë atyre të cileve nuk e kaneë një planimetri dixhitale të shtëpisë së tyre - hap parësor për procesin e legalizimeve. "Arkitekti Im" ndryshe nga shërbimet e tjera të cilat ofron Bashkia dhe zyra rajonale e Legalizmeve (aluizni, Shkodër) synon të shtrihet sa më afër ketyre konteksteve territoriale në periferinë e Shkodrës.

Gjithëpërfshirja, Komunikimi dhe pjesëmarrja në proceset planifikuese dhe të zhvillimit
Gjithëpërfshirja e qytetarëve të Shkodrës në hartimin e planit të përgjithshëm vendor do të jetë një provë e rëndësishme për të vendosur bazat e një komunikimi konstruktiv qytetar-bashki me synim përmirësimin e zhvillimit të territorit të Bashkisë. Qytetarët do të jenë të informuar për zhvilimet territoriale dhe do të krijohen metodologji pune të cilat vendosin qytetarin si aktor të rëndësishëm në vendim-marrje dhe vendim-bërjen mbi zhvillimet territoriale. Gjithashtu do të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare.
Do të krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë. Praktika të planifikimit në nivel "lagjeje" dhe "komuniteti" do të testohen dhe aplikohen si një mënyrë novatore për zhvillimin e qëndrueshëm territorial.
Në planin afatgjatë, në vizionin e bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve qëndrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përsa i përket planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësitë komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qëndrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurojnë me njëra tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia. Në këtë sens rritet bashkëveprimi komunitar dhe pronësia e projektit duke garantuar edhe kohezion social.

**Projekte**

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Hapja e zyrave me një ndalesë në të gjitha njësitë administrative | Strategjik | I lartë |
| Projekt 'arkitekti im', njësia Rrethina | Pilot | I mesëm |
| Projekt 'plan veprimi' komunitar | Pilot | I mesëm |
| Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV në qytetin Shkodër | Strategjik | Shumë i Lartë |
| Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV në Velipojë/ Rrjoll | Strategjik | Shumë i Lartë |
| Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV Shirokë/Zogaj | Strategjik | Shumë i Lartë |
| Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV në fshatra me presion zhvillimi | Strategjik | Lartë |

00




**Programi Strategjik OS2PS4: Qeverisja Elektronike**

Bashkia Shkodër synon të rrisë transparencës ndaj publik dhe të përmirësojë shërbimet duke modernizuar dhe dixhitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me Bashkinë. Në këtë kontekst do të ofrohen shërbime dixhitale për bizneset me anë të të cilave mund të kryhen veprimet për pagimet e taksave.

Gjithashtu, me të njëjtën logjikë më pas do të dixhitalizohet edhe shërbimi për qytetarin duke u bazuar në një Portal unik në të cilin mund të merren informacion si dhe të merren shërbime e kryhen veprime të ndryshme. Portali do të jetë i përdorshëm për "telefonat inteligjent" si dhe në versionin e një faqeje interneti.

**Projekte**

| **Emertimi i Prioritetit** | **Lloji i Projektit** | **Prioriteti** |
|---|---|---|
| Projekti "taksat online" | Strategjik | I lartë |
| Projekt "këshillim për zhvillimin online" | Pilot | I mesëm |




**Programi Strategjik OS2PS5: Qëndrat Multifunksionale dhe shërbimet Sociale**

Programi synon që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike si në aspektin e përmirësimit të ambjenteve të tyre ashtu edhe në aspektin e cilësisë së shërbimit. Do të mbështetet veçanërisht krijimi i shkollave me bazë komunitare si një element integral i përmirësimit të cilësisë së jetesës në zonat informale ku ndihet dhe mungesa e shërbimeve. Ndikimi i kësaj politike do të jetë si në aspektin e cilësisë së shërbimt ashtu dhe në atë social, ku do të përmirësojë bashkëjetesën komunitare dhe frymën e komunitetit në këto zona.

Zhvillimi i Burimeve Njerezore duke u bazuar tek Arsimi dhe Trajnimet profesionale në përgjigje të nevojave të ndryshme të banorëve të Shkodrës.

- Shkolla të integruara si qendra për komunitetin.
- Eficiencë e shkollimit në distancë (shkollim part-time, online, etj.)
- Kualifikime profesionale për të gjithë komunitetin.
- Qëndra Multifunksionale dhe Qëndra Sociale në funksion për komunitetin

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Projekti “Shkolla si Qëndër Multifunksionale” Postribë Zhvillimi i Qëndrës Multifunksionale Adem Haxhija | Strategjik | I lartë |
| Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” (lagjia mark lula) | Pilot | I Lartë |
| Projekti “Qëndër Multi funksioanle Kiras”- rikualifikim i ish-shkollës së veterinarisë | Strategjik | I lartë |
| Projekti “Qëndër Multifunksionale Dajç” | Pilot | I lartë |
| Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” Bërdicë | Pilot | I mesëm |
| Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” Gur i Zi | Pilot | I mesëm |

| | | |
|---|---|---|
| Projekti "Shkolla si qëndër komunitare" Ana e Malit | Pilot | I mesëm |
| Rehabilitimi i Shkollave të mesme | Strategjik | I Lartë |
| Rehabilitimi i Shkollave 9-vjeçare | Strategjik | I lartë |
| Kopështe-Çerdhe | Strategjik | I lartë |
| Përmirësimi i cilësisë së ambjeteve të qëndrave shëndetësore në njësitë administrative | Strategjik | I lartë |

**Objektivi Strategjik 3- Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik**

**Programi Strategjik OS3PS1: Zhvillimi i Rural**

*Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër*

Synon rehabilitimin e rrjetit kullues dhe vaditës për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër duke përfshirë njësitë administrative. Në këtë kontekst do të kryhen:

- Evidentimi dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të kanaleve
- Evidentim dhe Vlerësim i gjendjes ekzistuese të hidrovoreve dhe stacioneve të pompimit
- Plani i Detajuar i Veprimit për zgjerimin, pastrimin dhe rikonstruksionin e rrjetit
- Mirëmbajtjen e Rrjetit

*Hartimi i instrumenteve të manaxhimit të tokës për bujqësinë*

Instrumentat e menaxhimit do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me Kategori Bazë të përdorimit të tokës të propozuar B.Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore. Nxitja e krijimit të kooperativave të fermerëve dhe konsolidimit të tokës bujqësore me madhësi të fermave nga 0.8ha/fermë në 4-5 ha/fermë. Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazinë, stalla, pika grumbullimi, kooperativa bujqësore) përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të partneritetit publik-privat (PPP). Pjesë e këtij procesi do të jetë dhe ngritja e kapaciteteve vendore në menaxhimim e produkteve bujqësore si dhe në kërkimin shkencor mbi këtë aspekt.

*Tregjet Rajonale*

Në Bashkinë Shkodër janë parashikuar 4 (tre) tregje rajonale për produktet bujqësore dhe blegtorale:

- Tregu Rajonal në Shkodër/Rrethina
- Tregu Rajonal në Bërdicë
- Tregu Rajonal i Produkteve Bio (Mes)
- Tregu Rajonal i Peshkut

Tregjet rajonale duhet të kenë dhe hapësira për çertifikimin dhe kontrollin e produkteve. Duhet të kenë hapësira të mjaftueshme edhe për parkimin e automjeteve dhe të jenë në një largësi jo më shumë se 1km nga akset kombëtare dhe/ose rajonale.

*Pazari Javor (treg i përkohshëm 1 herë në javë gjatë verës dhe një herë në dy javë gjatë dimrit)*

Në mënyrë që të zhvillohen dhe promovohen edhe njësitë e tjera administrative, 1 herë në dy javë gjatë periudhës së dimrit dhe 1 herë në javë gjatë periudhës së verës do të aplikohet koncepti i tregut ditor ose ditës së pazarit. Pazari do të zhvillohet me rotacion në njërën prej njësive administrative Rrethina, Gur i Zi, Bërdicë, Ana e Malit, Dajç, Postribë. Pazari/Tregu do të zhvillohet në një hapësirë publike. Bashkia do të ofrojë struktura të përkohshme për tregtare/fermerë të vegjël

për shitjen e produkteve të tyre. Në të do të lejohen dhe tregtarë ambulant të cilët shesin ushqime të ngrohta/ftohta tradicionale të zonave përkatëse.

*Agroturizmi*

Agroturizmi shihet si një vlerë e shtuar për bujqësinë. Ai promovohet në njësitë administrative si Ana e Malit, Dajç dhe Gur i Zi. Sipërmarrësit e agri-turizmit do të mbështeten nga Bashkia në zhvillimin e biznesit të tyre gjatë 3 viteve të para. Mbështetja do të jetë e formës teknike duke ofruar këshillim dhe ekspertizë në zhvillimin e agriturizmit si dhe në formë materiale dhe financiare, duke hequr detyrimin për taksë për bizneset e agro-turizmit gjatë 4-mujorit të parë të funksionit të firmave të reja.

*Hartimi i Planeve të Peizazhit për trajtimin e tokave bujqësore*

Për të përmirësuar dhe rritur atraktivitetin dhe imazhin e Shkodrës peizazhi luan një rol të rëndësishëm dhe shihet si një vlerë e shtuar. Tokat bujqësore zënë mbi 20% sipërfaqes së bashkisë së re. Si rrjedhojë duhet të tregohet një kujdes i veçantë që ato të zhvillohen e shfrytëzohen jo vetëm nga pikëpamja ekonomike por edhe nga ajo e peizazhit.

Kjo mënyrë e alternuar/bashkërenduar kultivimi mund të nxisë vlerat e prodhimit dhe të forcojë identitetin lokal. Kultura e peisazhit mbështet në konceptin se toka bujqësore e cila kultivohet në mënyrë të tillë për të shërbyer si atraksion peisazhistike dhe gjithashtu si tokë prodhuese pa cënuar cilësine ose llojn e prodhimit, por duke kultivuar sipas llojeve të ndryshme që alternohen midis tyre për të fituar sa më shumë tokë të përbashket dhe për të menaxhuar sa më mirë,si edhe për të rrijur sasinë e prodhimit. Kultura e pejsazhin është një proces i cili kërkon koordinim midis kultivimeve të tokave bujqesore me njëra-tjetren, nuk kufizon prodhimin, ndërkohë që në fasha të caktuara vendos përdorime të prodhimit duke efiçientuar kultivimin e tokës bujqësore.


SHALË
PULT
SHOSH
POSTRIBË
RRETHINA
SHKODËR
ANA E MALIT
GURI I ZI
BËRDICË
VELIPOJË

**Projekte**

| Emertimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Pastrimi i Kanaleve të Kullimit dhe Ujitjes.<br>Studim i gjëndjes dhe Pastrimi i kanaleve vaditjes dhe kullimit në Bashkinë Shkodër | Strategjik | Shumë i lartë |
| Zgjerimi i Rrjetit të Ujësjellësit Velipojë | Strategjik | I lartë |
| Zgjerimi dhe rikonstruksioni i rrjetit të kanaleve të kullimit të ujitjes | Strategjik | I lartë |
| Hartimi i Planit të Menaxhimit të Tokës Bujqësore në njësinë administrative | Pilot | I mesëm |
| Hartimi i Planit të Peizazhit Bujqësor | Pilot | I ulët |
| Kompostimi në bazë ferme/ familje për Nj. Administrative Postribë/ Pult/ Shosh/ Shalë | Pilot | I mesëm |
| Nxitja e marredhënieve formale (kontraktim, bashkëpunim) ndërmjet prodhuesve, grumbulluesve dhe tregtareve | Strategjik | I mesëm |
| Zgjerimi i tregut rajonal ekzistues në Shkodër<br>Tregu rajonal dhe thertore Shkodër | Strategjik | Shumë i Lartë |
| Ndertim i tregut te ri (ish Parku i Mallrave)<br><br>Rikonstruksion i tregut Rus | Strategjik | I Lartë |
| Krijimi i qendrave të grumbullimit dhe ruajtjes së produkteve bujqësore, qëndrave frigoriferike. | Strategjik | I Lartë |
| Hapja e tregut BIO në Postribë | Pilot | I lartë |
| Hapja e tregut rajonal Bërdicë | Strategjik | I mesëm |
| Thertore Berdicë | Strategjik | I mesëm |
| Ndërtimi i Nyje shërbimi Bujqësore në Bërdicë | Strategjik | I mesëm |
| Nyje Bujqësore në Postribe | Strategjik | I mesëm |
| Rikualifikimi i Tregut lokal Zdrale | Strategjik | I mesëm |
| PPP nyje bujqësore Ana e Malit<br>Nyje Shërbimi Bujqësore në Njësinë Administrative Ana e Malit | Pilot | I lartë |
| PPP nyje bujqësore Gur i Zi | Pilot | I Lartë |

| | | |
|---|---|---|
| PPP nyje bujqësore Velipojë | Pilot | I lartë |
| PPPi Nyje Bujqësore në Dajç | Pilot | I lartë |
| Organizimi i pazarit javor | Pilot | I mesëm |
| Tregu rajonal i Peshkut | Strategjik | I ulët |




**Programi Strategjik OS3PS2: Zhvillimi i Akuakulturës**

Do të mbështetet zhvillimi dhe kultivimi i akuakulturës në Liqenin e Shkodrës, në zonën e Velipojës dhe të Vilunit. Kjo gjë do të shoqërohet me mbështetjen e peshkatarëve për grupimin dhe hapjen e nyjeve të shërbimit të akuakulturës. PPP do të zhvillohen për të mbështetur zhvillimin e akuakulturës. Gjithashtu, pjesë e këtij programi do të jetë dhe hartimi i planeve të menaxhimit të akuakulturës, për të lejuar një shfrytëzim optimal të sipërfaqeve ujore dhe për të mos dëmtim të ekosistemit.

**Programi Strategjik OS3PS3: Zhvillimi i Turizmit**

*<u>Zhvillimi i itinerareve turistike</u>*

Bashkia Shkodër do të zhvillojë një sërë itineraresh turistike dhe promovojë si paketa turistike në bashkëpunim me aktorët aktivë të këtij sektori. Itinerarët do të jenë të tematikave të ndryshme të cilat më pas mund të ndërthuren për të ofruar paketa turistike gjithëpërfshirëse:

- Itinerarët Ujorë:
    - Përgjatë Liqenit
    - Përgjatë Lumit Buna

- Përgjatë Bregdetit
- Itinerarët natyrore
  - Njësitë Administrative Postribë, Shosh, Pult, Shalë, Ana e Malit dhe në Malin e Taraboshit
- Itinerarët Historiko Kulturorë
  - Ndërlidhja e Kalasë së Shkodrës-Zona Historike në Qytetin e Shkodrës-Kalaja e Drishtit- Kalaja e Prekalit- Kalaja e Danjës
- Itinerarët e Muzeve të qytetit të Shkodrës

Në kuadër të zhvillimit të itinerarëve ato do të mbështeten më tej duke përgatitur të rinj të njësive administrative për të shërbyer si guida turistike. Guidat do të trajnohen dhe licensohen.

*Zhvillimi i Turizmit Malor dhe ekoturizmit*

Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësitë administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve vendore për hapjen e bujtinave. Krijimi i guidave dhe manualeve për bujtinat.

*Nxitja e Turizmit të Det dhe Rërë*

Velipoja dhe Rrjolli janë dy hapësirat kryesore për zhvillimin e turizmit të detar. Rrjolli do të zhvillohet në mënyrë shumë të kujdesshme për të ruajtur karakteristikat e tij si një plazh i "virgjër". Në këtë kontekst në Rrjoll do të synohet turizmi Elitar.

Përsa i përket Velipojës do të vazhdojë të jetë një qëndër e rëndësishme e turizmit bregdetar në Shqipëri. Qëllimi është që të përmirësohet kushtet e mjedisit të ndërtuar dhe të zhvillohet pa dëmtuar kapacitetin mbajtës të zonës. Prioritet për Velipojën do të jetë përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve për të ofruar një hapësirë sa më mikpritëse për turistët. Plazhet në të dyja rastet do të menaxhohen sipas përcaktimeve ligjore ku minimalisht 30% duhe të jetë plazh publik.

*Turizmi i eventeve dhe konferencave*

Shkodra ka një sërë asetesh për të zhvilluar turizmin e eventeve dhe të konferencave. Zhvillimi i stadiumit Loro Boriçi lejon për zhvillimin e aktiviteteve të mëdha sportive të cilat grumbullojnë një numër të konsiderueshëm vizitorësh.

Gjithashtu, duke pasur një universitet me traditë ekziston mundësia për të zhvilluar dhe evente të tilla si konferenca Shkencore, tubime e takime të tjera të cilat sjellin vizitorë në zonë.

*"Wayfinding"*

Bashkia është e vendosur që të përmirësojë karakterin e rrugëve të cilat duhet të zhvillohen me cilësi sa më të lartë. Bashkia do të prodhojë një manual për dizajnin e rrugëve, ku të vendosen standartet për përmirësimin e tyre në të gjithë territorin e bashkisë. Në mënyrë që të përmirësohet lëvizja në këmbë, dhe lexueshmëria e qytetit një program specific do të hartohet për planifikimin e shenjave drejtuese në të gjithë bashkinë. Duke qënë një Bashki me fokus në turizëm, është shumë e rëndësishme që si pjesë e planfiikimit të përdoren dhe zhvillohen shenja dhe harta për të krijuar një lëvizje sa më të lehtë në qytet. Këto duhen zhvilluar në mënyrë sa më kreative për të përfaqësuar karakterin turistik të bashkisë dhe krijuar atraksione për vizitorët e shumtë. Bashkia me anë të konkurseve do të mundohet të promovojë kreativitetin e të rinjve duke krijuar programe për përmirësimin e shenjave dhe hartave treguese rrugore.

*Aplikacionet Elektronike*

Do të zhvillohet një aplikacion për "telefonat inteligjent" dhe ëebsite online i cili ofron informacion për turistët dhe vizitorët mbi të gjitha aspektet e turizmit të sipërpërmendura. Në të do të pasqyrohen edhe informacione mbi evente të cilat zhvillohen në Shkodër në periudha të ndryshme.

Aplikacioni mund të jetë falas për shërbimet bazë të informacionit. Gjithashtu mund të përdoret edhe për të blerë bileta në mënyrë elektronike për muzetë dhe guida turistike.
Ndërkohë, në një periudhë të dytë aplikacioni mund të zhvillohet me pagesë (simbolike) duke ofruar edhe shërbimin e cicëronit.

*Plazhet*
Pajisja me infrastrukturën e posaçme dhe të nevojshme të plazheve (rasave) përgjatë aksit Shirokë-Velipojë. Plazhet nuk duhet të shkaktojnë dëme në liqen, pra hapja e plazheve të reja do të kryhet në vende të përshtashme ku impakti në mjedis është minimal. Ato do të pajisen edhe me hapësira të vogla shërbimi si dhoma për zhveshjen, parkim për biçikleta, vend për huamarrje të çadrave etj.

**Projekte**

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Inventarizimi i resurseve dhe aktorëve turistike në territorin e Bashkisë Shkodër | Strategjik | I lartë |
| Konsolidimi i forumit/bordit të turizmit për planifikimin strategjik lokal | Strategjik | I lartë |
| Nxitja e bashkëpunimit ndërkufitar | Strategjik | I lartë |
| Rehabilitimi i zonave dhe vendeve arkeologjike | Strategjik | I lartë |
| Zhvillimi i “Kuartierit të Muzeve” në qytetin Shkodër | Strategjik | I lartë |
| Zhvillimi i Itinerareve Turistike<br>a. Rrjeti i kalave<br>b. Muzeu i bicikletave | Pilot | I lartë |
| Muzeu  i Flores dhe Faunes | Strategjik | I mesëm |
| Zhvillimi i Itinerarit Ujor përgjatë lumit Bunë | Strategjik | I mesëm |
| Evidentimi dhe rehabilitimi i plazheve lumore dhe liqenore | Strategjik | I mesëm |
| Zhvillimi i itinerarëve për Lëvizjen me biçikletë për qëllime turistike  përgjatë Liqenit të Shkodrës, Lumit Buna, Liqenit të Vau Dejes dhe Velipojës | Strategjik | I lartë |
| Inegrimi i produkteve tipike në paketat turistike. Akses i ekonomisë rurale në | Strategjik | I mesëm |

| | | |
|---|---|---|
| produktin turistik. | | |
| Integrimi i vizitave në ferma dhe pikave të soditjes | Strategjik | I mesëm |
| Zhvillimi i një qëndre për panaire, konferenca dhe evente madhore<br>a. Krijimi i paketave dhe ofertave të vecanta për organizimin e panaireve dhe konferencave | Strategjik | I mesëm |
| Nxitja e Ekoturizmit: Vëzhgimi i zogjve | Strategjik | I mesëm |
| Trajnimi i kapaciteteve njerëzore<br>a. Trajnimi i Guidave<br>b. Trajnimi i kapaciteteve njerëzore për përmiresimin e shërbimeve turistike<br>c. Trajnime për gratë për menaxhimin e bujtinave | Strategjik | I mesëm |
| "Kopështari – Kuzhinë – Bujtinë" – Tradita e Familjes | Strategjik | I mesëm |
| Permiresimi i aksesit ne zonat turistike<br>a. Përmirësim i Plazheve në aksin Shirokë-Zogaj<br>b. Pastrimi i plazheve<br>c.Permiresimi i aksesit në plazhet publike Velipoje<br>d. Aksesi në zonën Prekal-Theth | Strategjik | I mesëm |
| Ndërtimi i Pontileve për lëvizje detare | Strategjik | I mesëm |
| Certifikimi i produkteve | Strategjik | I mesëm |
| Perdorimi i teknologjive inovative ne promovimin e turizmit<br>a. Aplikacioni Shkodra Turizëm | Strategjik | I mesëm |
| Mbështetja e zinxhirit të produkteve lokale (pijet, | Strategjik | I mesëm |

| | | |
|---|---|---|
| bulmeti dhe kulturat e tjera bujqësore)<br><br>**a**.Promovimi i itinerarit gastronomik pergjatë Liqenit të Shkodrës<br>**b**.Mbështetja dhe perpunimi i bimëve medicinale | | |
| Mbeshtetja e artizanatit | Strategjik | I mesëm |
| Hartimi dhe publikimi i materialeve promocionale | Strategjik | I mesëm |
| Hartimi i planit të tabelave orientuese turistike për Bashkinë Shkodër<br>a. Përmirësim i sistemit të tabelave orientuese dhe informuese për turizmin | Strategjik | I mesëm |


LEGJENDA
Kufi Bashkia Shkoder
Kufi Njesite Administrative
Kategoria
Kala
Ndertese e projektuar
Ndërtime të arkitekturës vernakulare
Objekt Kulti
VEND VARRIMI
VEPRA ARTI
Vepra inxhinierike
Kategoria
KATEGORIA I
KATEGORIA II
KATEGORIA IV
Kategoria II
Kategoria IV
ekoturizem
agroturizem
turizmi ujor
turizmi kulturor
turizmi malor
turizmi kurativ
SHALE
PULT
SHOSH
POSTRIBE
RRETHINAT
SHKODER
GURI I ZI
ANA E MALIT
BERDICE
DAJÇ
VELIPOJE
Liqeni i Shkodres
0 2 4 8 12 16 Km

**Programi Strategjik OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja**

Do të krijohet një fond i përcaktuar për të mbështetur nismat e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Bashkia, do të mbështesë veçanërisht sipërmarrjet e vogla që hapen për herë të parë, të cilat janë në fushat parësore dhe lidhen me vizionin e zhvillimit të bashkisë. Ndërmarrje të cilat fokusohen në fushat e ofrimit të shërbimeve turistike (jo-hoteleri), në fushën e bujqësisë dhe në shërbime të tjera të lidhura veçanërisht me sistemet IT, të krijuara nga persona midis 18-30 vjeç do të mbështeten. Çdo vit do të zhvillohet një konkurs i hapur për krijimin e sipërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme, ku çdo individ ose grup individësh kanë mundësi të konkurojmë për të marrë financim. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të kreativitetit të idesë, aplikueshmërisë në realitet, studimit të fizibilitetit dhe tregut. Në këtë kuadër do të krijohen dhe inkubatorët e biznesit të cilat do të ndërlidhen me qëndrat multifunksionale. Do të krijohen struktura për të mbështetur të rinjtë në zhvillimin e tyre profesional dhe të karrierës. Do të hapen zyra të këshillimit të karrierës dhe të trajnimit të të rinjve në prosione të ndryshme. Këto zyra trajnimi dhe këshillimi jo vetëm që do të bëjnë trajnim të të rinjve por edhe të ofrojnë praktikë profesionale në institucione të ndryshme. Fushat kryesore në të cilat do të aplikohen trajnimet do të jenë në turizëm, bujqësi, akomodim, shërbime, kuzhinë, peshkim dhe përpunim. Biznese të hapura për herë të parë nga persona në moshën 18-30 vjeç në fushat e sipërpërmendura do të ndihmohen duke u përjashtuar nga taksat vendore për një periudhë 4 mujore.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Zhvillimi i inkubatorit të biznesit Shkodër | Strategjik | I lartë |
| Zgjerimi i Rrjetit të Internetit me shpejtësi të lartë në të gjithë qytetin Shkodër | Pilot | I mesëm |
| Shërbime të e-qeverisjes | Plot | I mesëm |
| Studim strukturor i ekonomisë dhe prespektivave të zhvillimit. | Strategjik | I lartë |
| Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qellim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekszistuese. | Strategjik | I lartë |
| Hartimi dhe zhvillimi i programeve te trajnimit. | Strategjik | I mesëm |
| Organizimi i panaireve me bizneset dhe fermerët në nivel rajonal çdo vit për promovimin dhe zhvillimin e biznesit dhe tregun e punës. | Strategjik | I mesëm |
| Forcimi i rrjetit të bashkëpunimit (vleresim i përbashkët i nevojave dhe | Strategjik | I mesëm |

| | | |
|---|---|---|
| ofertës së tregut të punës) | | |
| Nxitja dhe promovimi i bizneseve krijuese | Strategjik | I lartë |
| Mbështetja dhe lehtesimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare | Strategjik | I lartë |

**Programi Strategjik OS3PS5: Zhvillimi i Zonave Ekonomike**
Synimi i kësaj politike është të nxisë arritjen e qëllimeve të përbashkëta, rritjes ekonomike dhe të rizhvilloje zonën e vjetër industriale duke e adaptuar për kërkesat e reja dhe zhillim të ri, me qëllim rritjen ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe zhvilimin e produkteve lokale nga prodhimi në treg.

Për të arritur këtë politikë kërkon një bashkpunim shumë të mirë me agjensitë e mjedisit, NGO-të e ndryshme dhe aktorët e interesuar për zhvillimin e zonës. Një nga parime kryesore që duhet të përmendim për këtë politikë është zonë me përdorime të përziera, pasi zonat ekonomike mund të funksionojnë në menyrë të sukseshme, kur aktiviteti i tyre mbështet nga shërbime dhe zhvillime komplomentare.Kjo pasi zona është në një pozicion shumë të afërt me zonat e banuara dhe mund të shërbej edhe si rivitalizues lokal për zonën.

Një pikë e rëndësishme është seleksionimi i industrive dhe funksioneve ekonomike të zonës, duke zgjedhur industri të lehtë që është jo demtuese për mjedisin dhe duke i bashkuar me industri të tjera plotësuese ose që ndajnë karakteristika të përbashkëta dhe mund të funksionojnë sëbashku.

- Rikualifikimin e hapsirës për të akomoduar industri dhe ekonomi të ardhshme
- Organizimi i konkurseve për brandi-im e zonës së re ekonomike si cluster
- Rivitalizimin e industrive të humbura(duhani,sherebeli etj)

*Ofrimi I shebimeve teknologjike*

Teknologjia është një asset i domosdodhëm për zhvillimin e bizneseve,kjo mund të jetë edhe një vlerë e shtuar për të zhvilluar këto zona.Ofrimi I shërbimit (high speed internet) në zonën ekonomike mund të ofrojë mundësi të shumta për zhvillimin ekonomikë të shpejtë për zonën,duke rritur atraktivitetin dhe aksesin e zonës,për ta kthyer atë në një “hub” gjenerues ekonomik.

Fashat Ekonomike
**Bazuar në PPK Shkodra është pjesë e Rajonit Ndërkufitar Podgoricë-Shkodër si dhe e rajonit ekonomik Shkodër- Lezhë,** ku aksi kryesor lidhës midis tre qyteteve është dhe një aks i fortë ekonomik. Në këtë kontekst në Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik dhe Aksi Ura e Bahçallëkut--Bërdicë shihen si dy akse të rëndësishme ekonomike. Për të përmirësuar dhe strukturar këto dy akse ekonomike, në bashkëpunim me bizneset dhe komunitetin do të hartohen edhe projektet për rikualifikimin urban të tyre duke krijuar një ambjent sa më tërheqës për biznesin.

# HARTA E ZONAVE EKONOMIKE



| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Zona e ish-fushës së aviacionit-zonë e lirë ekonomike | Strategjik | I mesëm |
| Rikualifiki Mjedisor i ish-zonës industriale Shkodër | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim i i Aksit Ura e Bahçallëkut -Bërdicë si aks ekonomik<br><br>Zhvillimi i nyjes lidhese Harku Berdice<br><br>Rikonstruksion Ura e Bahcallekut | Strategjik | I mesëm |
| Fashat ekonomike: Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim i aksit rrugor Shkoder - Ana e Malit - Muriqan | Strategjik | I lartë |
| Fashat ekonomike-Shkodër - Vau i Dejës | Strategjik | I lartë |
| Rruga Shirokë- Zogaj | Strategjik | I mesëm |
| Zona e Qëndrës Shkodër | Strategjik | I lartë |
| Zona pranë By-Pass Perëndimor | Strategjik | I lartë |
| Terminali ujor | Strategjik | I mesëm |
| Zona Velipojë-Rrjoll | Strategjik | I mesëm |
| Krijimi i Zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër | Strategjik | I mesëm |

**Programi Strategjik OS3PS6: Branding i Bashkisë Shkodër**

Në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm vendas nga shoqëria civile, akademia, instancat shtetërore dhe subjektet private synohet krijimi i një PPP (partneriteti publik privat) me qëllim krijimin e një "marke" e cila përfaqëson produktet më të mira vendase. Ky partneritet do të ketë një fond të veçantë dhe kryesisht do të merret me promovimin dhe marketimin e produkteve vendase në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Krijimi i një logoje e cila garanton sigurinë e cilësisë së produkteve është një hap shumë i rëndësishëm për të rritur aksesueshmërinë e produkteve në tregje të ndryshme. Kjo logo do të përfaqësojë jo vetëm produktet bujqësore, por edhe ato të akuakulturës, peshkimit, blegtorale,

artizanale, turistike etj. Në të do të përshkruhen në detaj prejardhja e produkteve dhe mënyra e prodhimit të tij.

| **Emërtimi i Prioritetit** | **Lloji i Projektit** | **Prioriteti** |
|---|---|---|
| Hartimi i Strategjisë së Brandimit për Shkodrën | Pilot | I lartë |
| Brand-im i zonës ekonomike/industriale | Pilot | I lartë |
| Krjimi i një logo të unifikuar për produktet bujqësore BIO dhe Ekoturizmin | Pilot | I lartë |










## Objektivi Strategjik 4- Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban

### Programi Strategjik OS4PS1: Rikualifikimi i Ballinave Ujore

Do të hartohen masterplanet për ballinat ujore të:

- Buzë liqenit (parku i Shkodrës, hapësirë rekreative)
- Breg Liqeni (Zgjatimi Shirokë-Zogaj)
- Velipojë
- Lumi Kir
- Lumi Drin
- Lumi Bunë

Në të treja rastet masterplanet/planet e detajuara vendore do të shërbejnë për të kryer ndarjen funksionale dhe të hapësirave. Qëllimi është mbrojtja e këtyre aseteve dhe përdorimi i tyre për të tërhequr vizitorë si dhë për të rritur cilësinë e jetës për vendasit.

| **Emërtimi i Prioritetit** | **Lloji i Projektit** | **Prioriteti** |
|---|---|---|
| Rikualifikim i i Ballinës Ujore Shirokë Zogaj | Strategjik | Shumë I lartë |
| Rikualifikim i i Ballinës Ujore | Strategjik | I lartë |

| | | |
|---|---|---|
| Buzë Liqeni (ByPass Perëndimor) | | |
| Rikulifikimi i Ballinës Ujore të Lumit Kir (nga Prekal tek Kalaja Shkodër) | Strategjik | I lartë |
| Rehabilitim i fashës ripariane të lumenjve Kir, Buna dhe Drin | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim i i Ballinës Ujore buzë lumit Drin | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim i Mjedisor i Ballinës Ujore Lumi Bunë | Strategjik | I lartë |

**Programi Strategjik OS4PS2: Restaurimi i Ndërtesave Historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore**

Do të mbështetet me anë të instrumentit të transferimit të të drejtës për zhvillim dhe formimit të PPP restaurimi dhe mbrojtja e ndërtesave historike e me vlera të veçanta arkitektonike. Këto zona do të shoqërohen me zgjatimin e rrugëve pedonale, përmirësimin e mobilimit urban të rrugëve dhe përmirësimin e hapësirave publike. Kujdes të veçantë do të ketë edhe për ruajtjen e "interierit" të ndërtesave tradicionale në mënyrë që ato të rrisin vlerat e tyre. Në disa raste do të aplikohet dhe koncepti i "shtëpisë së hapur", ku një ditë në vit, shtëpitë tradicionale Shkodrane të ofrojnë mundësi vizitorëve të shijojnë traditën. Kjo gjë sërish do të kryhet në formën e një bashkëpunimi PPP me qëllimin për rritjen e vizibilitetit dhe ndjeshmërisë ndaj trashëgimisë historike, kulturore dhe arkitektonike të Shkodrës. Gjithashtu, ky event shërben edhe për të gjeneruar të ardhura për mirëmbajtjen dhe përmirësimin.

**Programi Strategjik OS4PS3: Rikualifikimi i Hapësirave Industriale dhe Përdorimi i 'Brownfield'**

Qëllimi i këtij programi është mbrotja e tokave të papërdorura dhe përdorimi i aseteve ekzistuese industriale në funksion të zhvillimit ekonomik të Shkodrës. Duke u bazuar në PPP dhe bashkëpunime të ndryshme me palë të interesuara do të zhvillohen ndërhyrje të cilat synojnë rikualifikimin urban dhe funksional të hapësirave të degraduara industriale. Një ndër parimet bazë është edhe rikonstruksioni i ndërtesave, rregullimi i rrugëve dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbra në zonën industrial. Një ndër kriteret kryesore do të jetë që 40% e hapësirës industriale të jetë hapësirë e lirë dhe e mbuluar me pemë në mënyrë që të rrisë si cilësinë vizuale ashtu dhe atë të ajrit. Në zonën industriale do të promovohen dhe tërhiqen sektorët e agro-përpunimit, përpunimit të tekstileve si dhe sektorë të lidhur me teknologjitë më të avancuara. Për të rritur ndërlidhjen midis "kreativitetit" dhe punëmarrësve do të hapen dhe qëndra trajnimi, inkubatorë dhe një shkollë profesionale në këtë zonë. Në këtë mënyrë reduktohen distancat punëdhënës-punëmarrës dhe rriten mundësitë për punësim.

- Hartimi I studimeve mjedisore për gjëndjen e zonave industrial
- Hartimi I Projekteve për rikualifikimin e hapsirave ish-industriale
- Hartimi I projekteve për rihabilitimin e tokave të kafta (brownfield)

*Përdorimet Mix të tokës*

Një nga mënyrat më të mira për rivitalizimin e zonave me karakter të fortë industrial është vendosja e përdorimeve mix rreth tyre,për të diversifikuar mënyrën e përdorimit të tokës dhe për të zbutur përdorimin e tyre,kjo edhe për shkak të zhvillimit të dendur të vendbanimeve rreth tyre.

Duke marrë në konsideratë që zonat industrial nuk gëzojnë më atë hapsirë vecuar midis tyre dhe vendbanimeve dhe duke kuptuar se industria e rënde nuk është një tipologji e pranueshme për zhvillimin actual të zonës,përzgjedhja e industrive të lehta me karakter "miqësor ndaj ambjentit" janë një domosdoshmëri për të zhvilluar këto zona ne menyrë të qëndrueshme.

**Programi Strategjik OS4PS4: Urbanizimi i Zonave Informale**

Në Shkodër, ky fenomen është mëse prezent dhe si rrjedhojë programi synon të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së hapësirave urbane informale. Politika synon të trajtojë problemin në dy drejtime kryesore, aspekti ligjor, si mbyllja e procesit të legalizimeve, dhe në aspektin infrastrukturor si përmirësimi i infrastrukturës. Përfshirja e komuniteteve në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës do të jetë një aspekt kyç ku incentivimi i projekteve pilot dhe krijimi i platformave të ndryshme të komunikimit ku qytetarët mund të kontribuojnë me ide apo parime të zhvillimit.

Zonat e ndryshme të qyetit do të zhvillohen dhe integrohen duke u bazuar në konceptet si: Lagjia Kiras (buzë liqeni) me konceptin e qytetit kopësht (duke qënë se ndodhet pranë hapësirës rekreative/parkut rekreacional). Rrethinat me konceptin "urban agriculture/agricultural garden) duke qënë se ndodhen pranë tregut rajonal të bujqësisë. Lagjia Mark Lula (integrim duke përdorur rikualifikimin e stacionit të trenit apo dhe prania me zonën industriale/ekonomike e cila do të gjenerojë punësim).

Shfrytëzimi i Hapësirave të cilat nuk kanë përfunduar ndërtimin është një tjetër prioritet për zonat informale. Në këtë kontekst nxitja e partneriteteve midis qytetarëve, bashkisë dhe organizatave të ndryshme për të ofruar shërbime në këto ngrehina është një mundësi e mirë për të konsoliduar territorin dhe ofruar njëkohësisht shërbimet e munguara.

Në rastet kur legalizimi është i pamundur për shkakt të legjislacionit në fuqi, të direktivave sektoriale apo të rrezikut të lart për përmbytje, rialokimi i banorëve do të përdoret si instrumenti i zgjidhjes së problemeve të mundëshme sociale. Në këtë kuadër, programi i strehimit social dhe zhvillimi me kusht i zonave të caktuara në njësitë pritëse do të përdoren si instrument për tu përballur me këto problematika. Në planin e përdorimit të tokës si dhe në rregullore do të përcaktohen zonat pritëse dhe kushtet e zhvillimit.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Urbanizimi i Zonës Informale Mark Lula | Pilot | I lartë |
| Urbanizimi i Zonës Informale Kiras | Pilot | I lartë |
| Urbanizimi i Zonës Informale Rrethina | Pilot | I lartë |

**Programi Strategjik OS4PS5: Rigjenerimi Urban**

Rigjenerimi Urban lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e mjedisit të ndërtuar në lagjet urbane. Në këtë kontekst do të aplikohet parimi që zhvillimi i ri të ketë karakter mbushje dhe përmirësim të situatës ekzistuese. Do të aplikohet instrumenti i zhvillimit me kushte, ku kryesisht kërkesat ndaj

zhvilluesve dhe pronarëve të cilët zhvillojnë prona të jenë me kushte për përmirësimin e komunitetit. Rigjenerimi urban do të lidhet me përmirësimin e cilësisë së strukturave fizike, përmirësimin e hapësirave publike, vendosjen e hapësirave rekreative dhe hapjen e shërbimeve sociale. Në këtë kontekst do të përdoren dhe ndërhyrje të tipit "akupunturë" të cilat synojnë të shërbejnë si katalizator për zhvillimin dhe rigjenerimin e zonës.

- Rikualifikimi I bypass në një itinerarë natyrorë
- Rikualifikimi i aseteve publike

Projekte pilot për rikualifikimin e lagjeve të degraduara "0 emissions-smart neightborhood". Ky projekt pilot ka si qëllim të kthehet në një lagje model për zhvillimin urban në Shqipëri dhe të krijojë bazat për tu aplikuar në zona të tjera dhe kthimin e saj në një model për tu ndjekur.

Rigjenerimi Urban lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e mjedisit të ndërtuar në lagjet urbane. Do të aplikohet instrumenti i zhvillimit me kushte, ku kryesisht kërkesat ndaj zhvilluesve dhe pronarëve të cilët zhvillojnë prona të jenë me kushte për përmirësimin e komunitetit. Rigjenerimi urban do të lidhet me përmirësimin e cilësisë së strukturave fizike, përmirësimin e hapësirave publike, vendosjen e hapësirave rekreative dhe hapjen e shërbimeve sociale. Në këtë kontekst do të përdoren dhe ndërhyrje që do të shërbejnë si katalizator për zhvillimin dhe rigjenerimin e zonës.
Kjo për të arritur përshtatja e ndërtesave ekzistuese sipas rregullave të eficencës energjitike,implementimi i infrastrukturave të gjelbërta sipas standarteve të depërtueshmërisë të hapsirave publike,përdorimi I infrastrukturës së gjelbër si drenazhim natyror për rreshjet,shtrirja e rrugeve pedonale krijmi i një rrjeti të vazhdueshëm,përdorimi i burimeve të rinovueshme për hapsirat publike dhe hapsirat e përbashkëta,vendosja e standarteve më 30% të ndërtimevë të reja për strehim social dhe Nxitja e zhvillimit të përdorimit të përzier të tokës e përdorimit të infrastrukturës së zgjuar,e cila mund të jetë e vetmjaftueshme dhe e adaptueshme në kohë. Rezultatet e pritshme janë:

- Përmirësim të cilësisë së shërbimeve
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës për banorët
- Përmirësim i imazhit të lagjes
- Përmirësim i mjedisit
- Reduktim i ndotjes në mjedis
- Zhvillimi ekonomikë afatgjatë
- Rritja e interest për investim
- Adresimi i problematikave sociale nëpërmjet PPP-ve

**Programi Strategjik OS4PS6: Përmirësimi dhe Integrimi i Komuniteteve Rome**

Komunitetet Rome do të trajtohen me konceptin e integrimit dhe përmirësimit të cilësisë së kushteve të jetesës. Përtej përmirësimit të cilësisë së ndërtesave do të ofrohet dhe ngritja e kapaciteteve në mënyrë që këto komunitete të ruajnë identitetin e tyre por të kenë një jetesë sa më cilësore. Përmirësimi i kushteve të jetesës lidhet me përmirësimin e banesave, përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve, futjen e ujit, përmirësimin e kushteve sanitare.

Ndërkohë integrimi lidhet me hapjen e hapësirave për integrim social, krijimin e kushteve për punësim, zhvillimin e aktiviteteve të bazuara në komunitetet rome të cilat përfshijnë edhe qytetarët e tjerë.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Përmirësim i Cilësisë së jetesës së komunitetit Rom Ura e Bunës | Strategjik | Shumë i Lartë |

| | | |
|---|---|---|
| Përmirësim i Cilësisë së jetesës së komunitetit Rom tek Kalaja | Strategjik | I lartë |
| Përmirësim i kushteve të jetesës të Komunitetit Rom tek Bexhisteni | Pilot | Shumë i Lartë |
| Integrimi i Komunitetit Rom në Ekonominë Lokale | Pilot | I lartë |

**Program Strategjik OS4 PS7: Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban**

Qëndrat e njësive administrative dhe fshatrat do të rikualifikohen duke përdor ndërhyrje të tipit akupunturë. Synohet rregullimi fillimisht i shesheve kryesore të cilat janë dhe "lokusi" i grumbullimeve sociale dhe komunitare. Gjithashtu, rikualifikimi i këtyre shesheve qëndrore krijon mundësi për zhvillimin edhe të aktiviteteve tregtare. Këto ndërhyrje ndihmojnë edhe në përmirësimin e imazhit dhe impaktit më të mirë që kanë me vizitorët. Qëndrat do të lidhen gjithashtu me itinerarët turistike në mënyrë që të kenë mundësi edhe të vizitohen dhe rrisin të ardhurat. Duke krijuar bashkëpunime me komunitetin dhe përfshirë ata në projektet përkatëse do të garantohet cilësia e projekteve dhe mirëmbajtja e tyre.

**Projekte**

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Hartimi i Planeve të Detajuara Vendore | Strategjik | Shumë i Lartë |
| Rikualifikim Urban i Qëndrës së Fshatrave Nicaj-Shalë, Theth, Vuksanaj, Nicaj Shosh, Mëgullë, Pog dhe Prekal | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim Urban i Qëndrës së Fshatrave Boks, Mes, Grudë, Shtoj, Gur i Zi, Juban | Strategjik | I lartë |
| Rikualifikim Urban i Qëndrës së Fshatrave Bërdicë e Sipërme, Trush, Shirq, Obot, Muriqan, Rreç, Pulaj | Strategjik | I Lartë |
| Rikualifikimi Urban i Qëndrës së Fshatit Gomsiqe | Pilot | I lartë |

***Programi Strategjik OS4PS8: Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive***

*Krijimi i parqeve vendore*

Synimi i politikës është që të rritet sipërfaqja e gjelbër në territorin e bashkisë Shkodër. Kjo gjë do të arrihet me anë të krijimit të një rrjeti të fortë parqesh, duke nisur nga "lulishte" në nivel komuniteti ose lagjeje, parqe në nivel qyteti, parqe vendore, parqe rajonale dhe më pas ato kombëtare. Krijimi i sistemit të parqeve do të fuqizohet edhe me dhënien e roleve parqeve në nivele të ndryshme, ku disa mund të përdoren për rekreacion, disa të tjerë në formë fidanishtetesh të hapura për publikun etj. Një nga politikat që do të ndiqet është edhe ulja e gardheve rrethues të banesave, sidomos në zonat periferike.

*Terrenet Sportive*

Do të shtohen terrenet sportive në Bashkinë Shkodër ku synimi është që çdo rajon i qytetit Shkodër dhe çdo njësi administrative të ketë të paktën një hapësirë për zhvillimin e sporteve. Kjo gjë do të kryhen në kombinim me hapësirat sportive të shkollave apo duke rikualifikuar terrene dhe hapësira sportive ekzistuese.
Do të shtohen mundësitë për zhvillimin e sporteve ujore si kanotazh, not, surf me vela në liqenin e Shkodrës dhe në Lumin Buna. Këto do të jenë të hapura për publikun por edhe në funksion të ngrtijes së klubeve sportive të sporteve ujore.

*Tregjet si hapësirë Publike dhe Sociale*
Ndërkohë do të promovohet edhe zhvillimi i tregjeve lokale veçanërisht në zonat urbane të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për Rajon) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Si rrjedhojë në PPV duhet të shoqërohen edhe me hapësira të nevojshme rekreative si bar/kafene/ristorante apo dhe ambulantë ushqimi. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km.

"Universal Design" (Dizajn për të gjithë)

Bashkia Shkodër do të synon që të përshtasë infrastrukturat ekzistuese dhe të rrisë kushtet e zhvillimit për infrastrukturat në të ardhmen në mënyrë të tillë që të rrisin aksesueshmërinë e tyre dhe të zvogëlojnë barrierat arkitektonike. Një sërë projektesh do të aplikohen në fillim për përshtatjen e hapësirave publike dhe rrugëve kryesore këmbësore.

**Projekte**

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Rigjenerimi i Tregut Kiras | Pilot | I lartë |
| Përshtatja e Institucioneve me infrastrukturë për PAK | Pilot | Shumë i Lartë |
| Rikualifikim i Hapësirave Publike | Strategjik | Shumë i Lartë |

***Program Strategjik OS4PS9: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ***
Deri në 2030 parashikohet që i gjithë qyteti i Shkodrës të jetë i mbuluar me shërbimin e KUB dhe KUZ. Në këtë kontekst do të aplikohet teknologji sa më miqësore ndaj mjedisit, kryesisht me qëllim ndarjen e ujërave të bardha nga ato të zezat dhe ripërdorimin e ujërave të rreshjeve. Gjithashtu, në vizionin tonë, përtej filtrimit teknologjik ujërat e zeza do të kenë dhe një filtrim natyror me anë Sistemeve të Qëndrueshme të Drenazhimit përpara se të derdhen në lumenj. Në njësitë administrative do të ndalohet derdhja e ujërave të zeza në lumenj dhe liqene.
Impianti i trajtimit të Ujërave të zeza për qytetin Shkodër është në këtë kuadër një investim strategjik me prioritet shumë të lartë i cili do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e ujërave në liqen dhe në Lumin Buna.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Qëndra e Trajtimit të Ujërave të Zeza Shkodër | Strategjik | Shumë i lartë |

**Programi Strategjik OS4PS10: Strehimi Social dhe i Përballueshëm**

Bashkia Shkodër synon rritjen e numrit të banesave sociale me rreth 5 000 banesa në 15 vitet e ardhshme. Kjo gjë do të arrihet me anë të projekteve të drejtpërdrejta për banesat sociale të iniciuara nga bashkia me partnerë të ndryshëm si MZHU apo EKB. Do të përdoren instrumentat e zhvillimit me kushte për të garantuar që ndërtimi i ri të ketë dhe një komponent për banesat sociale.

Përsa i përket banesave me çmime të përballueshme do të mbështeten me kredi familjet e reja dhe të pastrehët. Gjithashtu me anë të instrumentave si transferim i të drejtave për zhvillim dhe zhvillimit me kushte do të arrihen marrëveshje me zhvillues për të plotësuar mundësinë që një sërë banesash të shiten nën koston e tregut (75% e vlerës së tregut). Pjesë e këtij programi do të jetë edhe përfshirja në skemat e strehimit social dhe të përballueshëm i banorëve të cilëve nuk mund tu legalizohen banesat e ndërtuara në mënyrë informale.

Përsa i përket banesave me qera për studentët. Duke qënë se bashkia Shkodër ka synimin të promovojë Shkodrën si qytet studentor në bashkëpunim dhe me anë të PPP do të krijohen mundësi për qera më të lira për studentë. Të tilla do të jenë ulja e taksës së qerasë etj.

- Ndërtimi I Banesave Sociale
- Vlersimi I aseteve aktuale të Bashkisë

| **Emërtimi i Prioritetit** | **Lloji i Projektit** | **Prioriteti** |
|---|---|---|
| Ndërtimi i Banesave Sociale për 300 familje | Strategjik | Shumë i lartë |

***Programi Strategjik OS3PS11: Efiçienca Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme***

**Shkodra cilësohet nga PPK si** një **nyje e rëndësishme Energjitike** ku kalojnë disa linja të tilla si IAP, apo dhe linja të rëndësishme internkonjeksioni me Malin e Zi. Politika e Bashkisë Shkodër është që të shfrytëzojë lidhjet te mira energjitike dhe të përshtat me to. Gjithashtu, Shkodra ka një potencial të madh për shfrytëzimin e energjive të rinovueshme si dhe efiçiencës energjitike.




*Vlerësimi dhe Çertifikimi i ndërtesave nga pikëpamja energjitike*

Bazuar në ligjin e ri të efiçiencës energjitike, tashmë ndërtesat duhen çertifikuar nga pikëpamja energjitike. Në këtë kontekst Bashkia Shkodër kërkon të kthehet në një lider ku duke bashkëpunuar me aktorë të ndryshëm privatë e shtetërorë të krijojë inventarin e ndërtesave në bazë të efiçiencës energjitike. Kjo gjë do të lejojë më pas krijimin e zyrës së ndihmës dhe këshillimit të qytetarëve për përmirësimin e efiçiencës energjitike të banorëve të saj. Vlerësimi dhe çertifikimi do të menaxhohen dhe bëhen me anë të një portali GIS online dhe me akses të hapur për të gjithë të interesuarit. Në portal përtej vlerësimit të ndërtesave individuale do të ketë edhe instruksione për përmirësimin e efiçiencës energjitike.

*Zhvillimi i skemave për efiçiencën energjitike*

Në planifikim dhe në ndërtim është një komponent i rëndësishëm i politikave të cilat do të ndiqen nga bashkia. Do të promovohet përdorimi i energjisë së rinovueshme, veçanërisht diellit, të cilat do të mbështeten në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve klimaterike.

Bashkia synon rritjen e efiçiencës energjitike dhe promovimin e saj jo vetëm për ndërtesa individuale, por edhe në nivel projektimi urban. Organizimi i hapësirave në nivel urban duhet të synojë shfrytëzimin sa më të mirë të elementëve të diellëzimit e ventilimit për të rritur efiçiencën energjitike në zonat urbane.

Bashkia, për efiçiencën energjitike do të promovojë aplikimin e këtij komponenti me anë të formave të ndryshme, e duke synuar edhe arritjen e formave të financimit me anë të partneriteteve publik privat (PPP).

Efiçienca energjitike do të lidhet me shërbimin social. Ku familjet të cilat janë me ndihmë ekonomike do t'I ofrohet këshillim i veçantë dhe ndihmë për të rritur efiçiencën energjitike të banesave të tyre.

*Energjia e Rinovueshme*
Do të nxitet përdorimi i energjisë Diellore veçanërisht në zonën e plazhit, ku hotelet duhet të parashikojnë panale diellore për ngrohjen e ujit. Gjithashtu, edhe në bujqësi nxitet përdorimi i panelve diellore. Ndërkohë, edhe në infrastrukturën e ndriçimit rrugor, vendqëndrimeve të transportit publik apo dhe parkimeve do të aplikohen panele diellore

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Vlerësimi i humbjeve energjitike të banesave në qytetin Shkodër dhe në Velipojë | Strategjik | Shumë i lartë |
| Vendosja e ndriçimit rrugor me energji diellore | Pilot | I mesëm |
| Rikualifikimi i stacioneve të transportit publik në Shkodër duke përdorur streha me panele diellore | Pilot | I ulët |
| Çertifikimi i ndërtesave nga pikëpamja energjitike | Pilot | I mesëm |

**Programi Strategjik OS4 PS12: Transporti Publik**
Transporti publik do të zgjerohet në linja urbane dhe rrethqytetase. Linjat do të parashikohen në mënyrë të tillë që të kenë mbulim të plotë të territorit dhe në mënyrë që të jenë komplementare dhe mbështetëse të njëra tjetrës. Transporti urban do të konceptohet në mënyrë të tillë që të ketë fleksibilitet gjatë periudhave të ndryshme të vitit, ku parashikohet që gjatë verës të shtohet fluksi dhe peridiciteti i linjave të cilat lidhin qytetin e Shkodrës me Velipojën dhe me Zogaj.
Gjithashtu gjatë verës do të operojnë dhe disa linja transporti publik ujore përgjatë liqenit të Shkodrës, dhe në një periudhë të dytë edhe përgjatë lumit Buna. Këto linja do të kenë një karakter turistik.
Me anë të formave të PPP dhe marrëveshjeve me operatorët do të shtohen abonetë/kartat e studentëve. Gjithashtu, do të krijohet një sistem më fleksibël biletash për ti shërbyer më mirë komunitetit dhe vizitorëve. Biletat do të jenë unike dhe do të ndahen në 1 orëshe, 3 orëshe, ditore, 3- ditore, javore dhe abone mujore.
Bashkia Shkodër synon që deri në 2030 të ketë një flotë moderne autobuzash ku 40% e flotës së autobuzave të ecin me energji miqësore ndaj mjedisit si elektricitet ose biomasë. Kjo është një sfidë e cila mund të arrihet vetëm me anë të partneriteteve të suksesshme.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Sistemi i Biletave Ditore për transportin publik | Pilot | I mesëm |
| Vendosja e sistemit të aboneve për studentët | Pilot | I mesëm |
| Autobuzi me energji miqësore | Pilot | I ulët |
| Portal online mbi sistemin e transportit public | Pilot | I mesëm |




**Programi Strategjik OS3PS13: Biçikletat**

Shkodra ka një traditë të shquar në përdorimin e biçikletës e cila do të përdoret edhe për të promovuar dhe branduar qytetin dhe Bashkinë. Në qytetin e Shkodrës do të plotësohen hapësirat e pedalimit në rrugët kryesore si dhe do të shtohen stendat për marrjen me qera të biçikletave dhe ose për parkimin e tyre. Hapësirat e pedalimit brenda qytetit do të jenë duke përdorur konceptin e "shared space" duke qënë se është një traditë unike e kulturore e qytetit të Shkodrës.

Ndërkohë do të zgjerohet dhe rrjeti i pedalimit jashtë zonës urbane, ku për shkak të shpejtësisë më të lartë të lëvizjes së makinave do të jetë me korsi të ndara. Në këtë kontekst do të shtohen itinerarët:

- Shirokë-Zogaj
- Shkodër- Dajç- Velipojë
- Shkodër- Ura e Kirit- Vau Dejës

Përgjatë këtyre itinerareve do të ketë dhe hapësira "rekreacioni" dhe shërbimi të tilla si vende për piknik apo dhe aktivitete të tjera.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Zgjerimi i rrjetit të parkimit të biçikletave në Shkodër dhe Velipojë | Strategjik | I lartë |
| Itinerari Peizazhistik i Biçikletave Shkodër- Velipojë | Pilot | I lartë |
| Itinerari Peizazhistik i Biçikletave Shkodër- Gur i Zi | Pilot | I mesëm |
| Itinerari Peizazhistik i Biçikletave Shkodër-Prekal | Pilot | I mesëm |

**Programi Strategjik OS4PS14: Gjallëria Urbane**

Synimi i këtij programi është të krijojë një kalendar evenimentesh për të rritur cilësinë e aktiviteteve dhe për të promovuar identitetin e qytetit, duke e bërë me atraktiv nga ana turistike,si dhe për të rritur cilësinë e jetesës së banorëve të saj.

Shkodra si një Qytet Studentor dhe turistik duhet të promovojë gjallërinë urbane. Për këtë do të zhvillohen në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm dhe me qëndrat rinore/ multifunksionale një

listë aktivitetesh për qytetin. Është e rëndësishme që të zhvillohen aktivitete dhe të promovohen më fuqishëm evente të tilla si Festivali i Jazz, Festivali i Filmit të Animuar, Festivali i Fëmijëve etj. Si dhe të pasurohet lista me aktivitete të tjera gjatë gjithë vitit.
Gjithashtu, do të promovohen festat ujore përgjatë liqenit të Shkodrës. Në planin e përdorimit të tokës do të përcaktohet edhe 1 zonë për "jetën e natës" për të rinjtë e Shkodrës. Zona do të përcaktohet e tillë që të mos jetë larg qëndrës por njëkohësisht të mos shkaktojë prishjen e qetësisë publike.
Në Shkodër do të promovohet arti urban. Në kuadër edhe të brandimit të Bashkisë do të përcakohet një "logo"/"mascot" për Shkodrën e cila më pas do të vendoset në formën e statujave edhe në qytet. Këto të fundit duhet të jenë fleksibël dhe të lejojnë qytetarët apo grupe të ndryshme rinore/artistike që në periudha të caktuara kohore nën drejtimin e bashkisë ose me iniciativë të tyre të ndërrojnë ngjyrat dhe të krijojnë një identitet të ri. Gjithashtu në zona të caktuara do të përdoret edhe vizatimi mural si mënyrë për të përmirësuar imazhin.

- Krijmi I Tregjeve Lokale Shkodër
- Krijmi I Tregjeve Lokale Postribë
- Krijmi I Tregjeve Lokale Velipoje
- Krijmi I Tregjeve Lokale Berdicë
- Rikualifikimi I statusit të kalasë së rozafës si pikë fokale e organizimit të aktiviteteve social-kulturore

*Zgjerimi i rrjetit Kembesorë*
Synimi i kësaj politike është të ruaj identitetin historik të qytetit dhe të nxisë levizjen këmbesore,në zona me karakter historik.Një nga elementet më të rëndesishe për këtë politikë është edhe shtrirja e rrjetit për të krijuar një lidhje midis zonave.
Kjo politike mbeshtetet në parimet e barazisë në levizjen alternative në qytet dhe ruajtjen e pasurive kulturore dhe historike.Shtrirja e këtyre rrjeteve do të sigurojë hapsira për të promovuar aktivitete rekreative në hapsirat e përbashketa dhe rritjen e cilësisë së jetesës.
Kjo politike duhet të jetë paralel me planin e mobilitetit dhe skenaret e levizjes për të siguruar qe levizja të devijoi në hapsira të tjera dhe të zgjidhen ngërcet në trafikun e përditshëm për të përfituar një lëvizje të mirë për të gjithë.

- Shtrirja e rrugëve pedonale në pjesë të tjera të qytetit
- Vendosja e orareve të ndalim kalimit për makinat në rrugët afër institucioneve dhe qendrave të kulturës
- Krijmi i rrjetit transit në zonën gjatë orave të ndalim kalimit

**Programi Strategjik OS4PS15: Parkimet**
Duke u bazuar në skema të PPP dhe/ose duke përdorur instrumentin e transferimit të të drejtës për zhvillim do të përcaktohen në planin e përdorimit të tokës:

- 4 parkime në Qytetin Shkodër,
- 2 Parkime në Velipojë,
- 1 Parkim për Autobuzat në Kalanë Shkodër (do të konceptohet si zonë edhe për shërbimet turistike, ku do të ketë mundësi të tregtohen suvenire dhe produkte të tjera turistike)
- 2 Parkime të bazuara në Konceptin "Park & Ride" në hyrjet e Shkodrës (do të jenë të lidhura me transport publik dhe me mundësinë për marrjen me qera të biçikletave)
- 

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Park&Ride (Ura e Bunës) Rikualifikim ish Gurorja | Pilot | I mesëm |
| Hapësirë Parkimi dhe Shërbimi tek zona C e Kalasë | Strategjik | I lartë |
| Ndertim i parkimeve elektronike prane Sheshit Plazh, Velipoje | Pilot | I lartë |

**Objektivi Strategjik 5- Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore**

**Programi Strategjik OS5PS1: Mbrojtja e Mjedisit**

Permiresimit te cilesise dhe reduktimin e ndotjes se ajrit dhe ndotjes akustike ne zonat kryesore urbane dhe zonat turistike. Parandalimit dhe kontrollit te integruar te ndotjes dhe rreziqeve nga ndotja dhe aksidentet industriale duke monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e normave dhe standarteve te shkarkimeve ne mjedis nga operatoret industrial. Mbrojtjes dhe menaxhimit te qëndrueshëm të biodiversitetit, shtimit të sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura dhe zonave pyjore. ”

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, kujdes i veçantë do të tregohet edhe për zonat e mbrojtura natyrore si **Parku i Alpeve, Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna (Park Kombëtar sipas PPK), Lumi Buna-Velipoja (Peizazh i Mbrojtur).**




Do të mbrohen burimet ujore nga ndotjet. Në këtë kuadër do të ndalohet derdhja e mbetjeve në mjediset ujore. Gjithashtu do të ofrohen infrastrukturat e nevojshme nëntokësore për të ndaluar derdhjen e ujërave të zeza në ujëra. Gjithashtu do të rikualifikohen hotspotet mjedisore dhe mbyllen pikat ilegale të depozitimit të mbetjeve. Në fund, ishvendepozitimet e mbetjeve në Bardhaj dhe Pulaj do të rigjenerohen.

**Programi Strategjik OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet**

Do të hartohet Plani i Masave që bashkia duhet të ndërmarrë për mbrojtjen nga përmbytjet dhe për menaxhimin e ujërave si dhe rekomandimet për institucionet e qeverisjen qendrore dhe entet e pjera publike e private që kanë ndikim në sistemin e menaxhimit të ujërave me synimin që të bashkërendohet një zgjidhje përfundimtare dhe në “sistem” për të gjithë problematikën e ujërave. Praktika e deritanishme ka treguar që ndërhyrjet pikësore vetëm sa e zhvendosin problemin në një zonë tjetër dhe nuk e zgjidhin atë. Për këtë arsye do të vlerësohet fillimisht rreziku dhe ndërhyrjet e

propozuara e më pas do të gjenerohen një sërë masash dhe rekomandimesh të cilat synojnë të japin një zgjidhje përfundimtare të problemit i cili nuk mund të zgjedhet vetëm me ndërhyrje në territorin e bashkisë Shkodër por kërkon një angazhim më të gjerë në nivel rajonal dhe kombëtar.

**Programi Strategjik OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane**

Shërbimi i mbulimit të mbetjeve urbane do të zgjerohet në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Në bazë të popullsisë dhe të sasisë së prodhimit të mbetjeve do të përcaktohen edhe frekuencat e mbledhjes së tyre. Në disa raste, veçanërisht për zonat të cilat kanë vështirësi në akses do të përcaktohen disa pika (stacione) transferimi të mbetjeve. **Më pas mbetjet do të depozitohen në landfillin e Bushatit bazuar edhe në Strategjinë e PPK e cila synon rritjen e mbetjeve të depozituara në Lendfill.**

Bashkia Shkodër, duhet të reduktojë mbetjet në burim të cilat në mënyrë që të reduktohet edhe sasia e mbetjeve të cilat shkojnë në landfill. Për të arritur këtë do të:

*Riciklimi*

Do të vendosen koshat e ndarë sipas llojit të mbetjeve të ngurta veçanërisht në qytetin e Shkodrës dhe në Velipojë si dy zonat urbane më të mëdha dhe me fluksin më të madh të mbetjeve. Koshat do të jenë të ndarë në plastikë, qelq, letër dhe të përgjithshme. Më pas do të me anë të bashkëpunimit dhe formimit të PPP do të garantohet riciklimi i tyre.

Gjithashtu, institucionet shtetërore dhe organizatat do të sensibilizohen për të ricikluar dhe reduktuar mbetjet. Në këtë kontekst synohet që deri në 2030 të kemi 100% riciklim të letrës, 100% përdorim të letrës së ricikluar, reduktim me 50% të përdorimit të letrës duke përdorur shërbime dixhitale.

Bashkia gjithashtu do të zhvillojë fushata të ndryshme sensibilizuese me bizneset në mënyrë që edhe ato të reduktojnë sasinë e mbetjeve dhe të riciklojnë. Bizneset të cilat riciklojnë më shumë do të promovohen dhe incentivohen.

*Kompostimi*

Në kuadër të synimit për të reduktuar sasinë e mbetjeve do të përdoren dy politika për kompostimin:

*a. Kompostimi në bazë ferme/familje/bujtine*

Kjo politikë do të aplikohet kryesisht në njësitë administrative Postribë, Pult, Shosh dhe Shalë. Fermerët/familjet/bujtinat do të ofrohen “kutiza” kompostimi të madhësisë $1m^3$ të cilat do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve organike. Lënda e përftuar më pas mund të përdoret për qëllime bujqësore.

*b. Kompostimi në bazë njësie administrative*

Njësitë administrative të Rrethinave, Postribës, Gurit të Zi, Ana e Malit, Bërdicës, Dajçit dhe Velipojës janë ndër prodhuesit kryesorë të mbetjeve organike duke qënë se kanë dhe sipërfaqen më të madhe të tokave bujqësore. Si rrjedhojë do të krijohen qëndra të posaçme kompostimi. Materialet e përfituara prej tyre më pas do të përdoren si bazë për prodhimin bujqësor.

Për çdo fermë do të ofrohet një “kutizë” me material ekologjik ku do të vendosen mbetjet organike. Më pas Bashkia (njësia administrative) do të kryejë transferimin e tyre tek qëndrat e kompostimit. Bazuar në sasinë e depozituar nga secili fermer ose grupim fermerësh, më pas do të kryhet dhe shpërndarja e plehut në mënyrë që të ketë një shërbim sa më cilësor dhe të drejtë.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Pikë Transferimi Mbetjesh në | Pilot | I lartë |

| | | |
|---|---|---|
| Postribë | | |
| Qëndër Kompostimi në bazë njësie Administrative | Pilot | I mesëm |
| Kompostimi në bazë familje | Pilot | I mesëm |
| Riciklimi në institucione publike dhe OJQ | Pilot | I lartë |
| Ndarja e mbetjeve në burim Zona Qëndrore Shkodër | Pilot | I mesëm |

**Programi Strategjik OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja**
Shfrytëzim i kontrolluar dhe i planifikuar i ujrave nëntokësorë. Kontroll i burimeve të ndotjeve në pellgjet ujembledhës, uëjrat sipërfaqësore dhe luginat përkatëse. Zbatim i legjislacionit për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore. Përpunim dhe rishfrytëzim i ujrave të ndotur.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Rikualifikimi i ish-venddepozitimit të mbetjeve Shkodër pranë varreza të Dëshmorëve | Strategjik | I lartë |

**Programi Strategjik OS5PS5: Qëndra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve**
Ky program synon të ofrojë një sërë alternativash për te parandaluar dhe menaxhuar rrezikun e përmbytjeve.Ndikim i kësaj politike do të jetë si në aspektin e rrijtjes së sigurisë në investime dhe në rritje të cilësisë së jetës, ku do të ndikojë drejtë për drejtë në sigurinë e pronës dhe individit. Kjo politike duhet të koordinohet me politikat në nivel shtetror për menaxhimin e emergjencave,por gjithashtu duhet të vendos disa prioritete për të kontrolluar specifikat e përmbytjes, kjo përfshin shumë grupe aktoresh që nga banoret e zonës, NGO-të të ndryshme, bashkinë, Autoritetet shtetrore dhe agjensitë qe merren me menaxhimin e ujërave dhe emergjencave.
Për të realizuar këtë politikë, duhen një sër hapash të qartë,përfshirje qytetare dhe analizim të të dhenave për historikun e përmbytjeve dhe tendencat e ndryshimeve klimatike të së ardhmesh.Në këtë pjesë nuk bën pjesë vetëm menaxhimi,por edhe masat afatgjatë për parandalimin e përmbytjeve të ardhshme duke u mbeshtetur në tendencat e së ardhmesh dhe zgjidhjet hidro-inxhinjerike.Për të arritur këto rezultate na duhet të implementojmë këto veprime:

- Ruajtja e fashës së lumit sipas specifikimeve ligjore
- Trasferimi i ndërtimeve që ndodhen Brënda fashës së mbrojtur të lumit në zona zhvillimi nëpërmjet instrumentave të zhvillimit
- Vendosja e sanksioneve financiare dhe mos dëmshperblimi i ndërtimeve që zhvillohen Brënda fashës.
- Krijmi i një rripi/brezi të gjelbër,me pyllezim të dendur në të gjithë gjatësinë e fashës së mbrojtur
- Pastrimi i fundit të lumit dhe thellimi periodik i tij
- Zgjerimi i shtratit të lumit në pikat e tencionit(kthesa, ose bashkimit të tij me lumin Kiri)
- Pyllëzimi i zonave ku ka erosion në shtratin e lumit për të administruar riskun
- Krijmi i një database per monitorimin e sistemit të përmbytjes në vite,tendencat e së ardhmes dhe ndryshimeve klimatike
- Krijmi i një stacioni të paralajmerimit të emergjencave,kur ka rezikshmeri të lartë
- Krijmi i pikave të emergjencës për të strehuar dhe evakuar banorët
- Krijmi i stacioneve për trajnimin mbi situatat emenrgjente,masat dhe si të veprohet

- Ngritja e forumeve për këshillimin mbi kulturen e mbjelljes për tokat në rezik përmbytje sipas kushteve agro teknike
- Pastrimi dhe rehabilitimi i sistemit te drenazhimit dhe ujitjes për tokat bujqësore
- Lidhja e sistemit të drenazhimit me kënetën e kllomës
- Rivitalizimi i rrjetit duke aktivizuar: Kënetën e Shlirës, Kënetën e Pemtarit, Kënetën e Casit, Kënetën Nerliz, Kënetën e Gjeneralit dhe Liqenin e Muriemës.
- Krijmi i rrjeteve të gjërë me kanale dhe këneta të vogla për të administruar presionin e ujit me aktivizim sezonal
- Ruajtja e ligatinave (ëetlands) dhe lidhja me rrjetin e kanaleve dhe rrjetin e rezervuarëve për të administruar rrezikun
- Sigurimi i një transporti alternativë ujorë në rastet e përmbytjeve për të rritur sigurinë qytetare
- Vendosja e barierave (prita)natyrore,periodike të tarracuara brenda lumit për të ulur shpejtësinë e rrjedhës së lumit,vendosja e tyre sipas standarteve të sigurisë
- Vendosja e argjinaturave të lehta në pika të caktuara për të orientuar shkarkimin në kanalet dhe sistemin plotësues të kënetave.

*Instrumentat e Menaxhimit te Tokës*

Këto instrumenta do të perdoren si mundësi negocimi midis gjëndjes aktuale dhe ku duam të shkojmë.Këto instrumenta do të përdoren si mënyra për të adesuar ploblematikat e zhvillimeve në zona të rrezikuara nga përmbytjet ose zona që janë të mbrojtura me ligj. Përcaktimi i zonave marrëse dhe dhënëse do të ndihmojë të ri-orientoje zhvillim,duke rritur sigurinë mbi individin dhe pronën.

| **Emërtimi i Prioritetit** | **Lloji i Projektit** | **Prioriteti** |
|---|---|---|
| Hapja e një qëndre Menaxhimi të Rreziqeve | Pilot | I mesëm |




**Programi Strategjik OS5PS6: Menaxhimi i Rreziqeve Natyrore**

Ky program synon që Bashkia Shkodër të jetë e përgatitur për përballimin e fatkeqësive dhe eventeve ekstreme natyrore. Për çdo njësi do të përcaktohen pikat e sigurta të grumbullimit të qytetarëve në rast të eventeve ekstreme si përmbytje, zjarre masive, tërmete etj. Zonat e sigurisë do të jenë të pajisura më shërbime bazë si tualete, q. shëndetësore, qëndër për rezervat ushqimore, si dhe një numër i caktuar çadrash të mjaftueshme për të mbuluar popullsinë e njësisë.

Në çdo njësi do të instalohen sistemet e alarmit dhe paralajmërimit. Një herë në vit do të kryhet testimi i sistemit të alarmit dhe paralajmërimit dhe një trajnim/provë për evakuimin e popullsisë drejt zonave të sigurisë.




**Programi Strategjik OS5 PS7: Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave**

Pyjet dhe kullotar përbëjnë një aset të rëndësishëm ekonomik për zonat rurale dhe gjenerimin e të ardhurave në Shkodër. Në këtë kontekst do të hartohen planet e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që ato të mbrohen dhe njëkohësisht të shfrytëzohen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetet lokale. Fillimisht do të shikohet edhe mundësia e ngritjes së kooperativave të Bashkëpunimit Lokal në lidhje me mbledhjen e gështenjave, frutave të pyllit dhe bimëve medicinale.

| Emërtimi i Prioritetit | Lloji i Projektit | Prioriteti |
|---|---|---|
| Plani i menxhimit të pyjeve | Strategjik | I lartë |
| Qëndër Grumbullimi Gështenja | Pilot | I lartë |
| Ndërtimi i Qëndrës së Grumbullimit të Gështenjave dhe Bimëve | Pilot | I lartë |

| | | |
|---|---|---|
| Medicinale në Pult | | |
| Pyllëzimi i Kurorës së Gjelbër të Bashkisë Shkodër në Malin e Taraboshit<br><br>Zbatimi i Projektit " Pyllezimi i Kodrave te Taraboshit". | Strategjik | I lartë |

Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shume funksional të burimeve pyjore dhe kullosore që sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm te tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për te përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale ne nivel lokal, kombëtar dhe global pa cenuar ekosisteme të tjera. Gjithashtu bazuar në strategjinë e ministrisë së Mjedisit, do të ngrihet dhe një sistem GIS për menaxhimin e pyjeve.

**Programi Strategjik OS5 PS8: Ndryshimet Klimatike**

Forcimin e kapaciteteve ne Bashkinë Shkodër per hartimin e politikave për klimën, me prioritet ngritjen e sistemit te monitorimit dhe të raportimit vjetor te GHG-ve në përputhje me kërkesat e BE-së. Mbështetjen e krijimit të partneriteteve rajonal e lokal për përmirësimin e teknologjisë, politikave dhe strategjive per mitigim në të gjitha sektorët e ekonomisë. Integrimi i masave te përshtatjes (adaptimit) dhe reduktimit te GHG në hartimin e planeve vendore të detajuara, menaxhimin e ujrave dhe tokës duke përfshirë bujqësine, pyjet dhe ruajtjen e natyrës.

# Kapitulli 5- Plani i Veprimit dhe Konsiderata Financiare

## 5.1 Konsiderata Financiare

Bashkia e re Shkodër, për nga niveli i të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta, paraqet një nivel të ulët autonomie financiare përgjatë pesë viteve të konsideruara. Në vijim të ndarjes së re administrative territoriale (shtimit të 11 njësive administrative) dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia e re e Shkodër përballet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale.

Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performances financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së taksueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative). Ligji ri për buxhetin vendor të viti 2016 solli disa risi në kuadrin nivelit, llojit dhe numrit të taksave.

Përgjithësisht, në periudhën afatshkurtër efektet e heqjes së disa taksave dhe futjes/modifikimit të disa të tjera vlerësohet të do të kundërbilancojnë njëra tjetrën duke u përkthyer në një efekt pothuajse neutral për buxhetin vendor. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi I instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës, fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfË, ËBIF, DLPD etj) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

Një burim tjetër të ardhurash i cili kërkon ngritje të kapaciteteve lokale është i lidhur me programet e huaja të tilla si programi për Bashkëpunimin Ndërkufitar IPA me Malin e Zi, IADSA, IPA ADRI-ION, HORIZON 2020. Në të dy këto programme është e rëndësishme që të krijohen strukturat e duhura të bashkëpunimit në mënyrë që të përfitohen projekte dhe të ardhura shtesë për realizimin e tyre.

## 5.2 Plani i Veprimeve

| Objektivi strategjik | PROGRAMI STRATEGJIK | Treguesit e monitorimit | Projektet | VLERA | Burimi Mundshëm Kryesor i të ardhurave | Burimi i mundshem dytesor | Tregues Vlerësimi | FAZAR E ZBATIMIT | | | | Prioriteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | I | II | III | IV | |
| Objektivi Strategjik 1- Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale | Programi Strategjik OS1PS1: Terminalet Multimodale | Nr pasagjerë<br>Nr Mjete<br>Nr Biznese pranë terminalit<br>Frekuenca e Udhëtimeve | Terminali Ndërkombëtar Shkodër (Stacioni i Trenit) | 50 000 000 Lekë | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Ndërtimi i Terminalit | | | | | I lartë |
| | | | Terminali Sezonal Velipojë | 8 000 000 Lekë | FZHR | Bashkia/ Donatorë/ Privatë | Ndërtimi i Terminalit | | | | | Shumë i Lartë |
| | | | Terminali Ujor Turistik Liqeni Shkodër | 5 000 000 Lekë | Agjencia Rajonale e Zhvillimit | Fondi Zhvillimit Rajonal | Ndërtimi i Terminalit | | | | | I mesëm |
| | | | Aplikacioni online "Shkodra Transport" | 5 000 000 Lekë | Bashkia | Donatorë | Aplikacion | | | | | I ulët |
| | | | Terminali Multimodal Interurban Shkodër (Stacioni i Trenit) | | | | | | | | | I lartë |
| | Programi Strategjik OS1PS2: Rregullimi i portave hyrëse në Shkodër | Projekte të Zbatuara<br>Fluksi i Lëvizjes<br>Nr Aksidente | Rregullimi Estetik/Peizazhistik i rrugës Muriqan-Ura e Bunës | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Projekti Teknik Rregullim i i Rrugës | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Rregullimi i Hyrjes Bërdicë Bahçallëk | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Projekti Teknik Rregullim i i Rrugës | | | | | I mesëm |
| | | | Rregullimi Estetik/Peizazhistik i rrugës Vau i Dejës-Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Projekti Teknik Rregullim i i Rrugës | | | | | I mesëm |
| | **Programi Strategjik OS1PS3: Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare** | Projekte të Zbatuara<br><br>Fluksi i Lëvizjes<br><br>Probleme Trafiku (Pika të zeza) | Aksi Rrugor Shirokë- Zogaj Pikë Doganore (Drejtim Virpazar) | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Projekti Teknik Rregullim i i Rrugës | | | | | I mesëm |
| | | | Kompletimi i Unazës Shkodër- Shalë Theth-Bogë Koplik<br><br>Aksi Shkodër-Theth | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Projekti Teknik Rregullim i i Rrugës | | | | | Shumë I lartë |
| | | | Velipojë- Pika e kalimit kufitar, doganë (drejtim Ulqin) | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Shëngjin Velipojë - Pikë doganore (Drejtim Ulqin) | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | IPA Cross Border Shqipëri Mal i Zi | Aksi Rrugor | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | By-Pass Lindor Qyteti Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR/ ARrSH | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Aksi Rrugor | | | | | I lartë |
| | | | Aksi turistik Prekal-Koman | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Aksi Rrugor | | | | | I mesëm |
| | | | Shkodër- Vau Dejës-Pukë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Aksi Rrugor | | | | | I mesëm |
| | | | Përmirësimi i sinjalistikës rrugore dhe elementëve të sigurisë në akset kryesore | 10 000 000 Lekë | ARSH | FZHR | Sinjalistika Rrugore | | | | | I lartë |
| | | | Lidhja Ujore Bexhisten Shirokë Virpazar | 5 000 000 Lekë | FSHZH | IPA Cross Border Shqipëri Mal i Zi | Fillimi i udhëtimeve me varka turistike | | | | | I lartë |
| | **Programi Strategjik OS1PS4: Bashkepunimi Nderkufitar** | Nr Projekte të Aplikuara Nr Projekte të Zbatuara Nr Aktorë të Angazhuar Shuma e Fondeve të Përftuara | Hartimi i një plani veprimi për zhvillimin rajonal midis Bashkisë Shkodër Bashkisë Malësi e Madh dhe bashkive homologe në Malin e Zi. | 500,000 Lekë | IPA Cross Border ShqipëriMal i Zi | Bashkia Shkodër | Plani i Veprimit | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Pikave kufitare Zogaj (jo kompetence e bashkise por bashkia duhet te kete rol nxitës ndaj autoriteteve të dy vendeve) | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | IPA Cross Border ShqipëriMal i Zi | | | | | | | I lartë |
| | | | Pika kufitare Pulaj | | | | | | | | | I mesëm |

| Objektivi strategjik | PROGRAMI STRATEGJIK | Treguesit e monitorimit | Projektet | VLERA | Burimi Mundshëm Kryesor i të ardhurave | Burimi i mundshem dytesor | Tregues Vlerësimi | FAZAR E ZBATIMIT | | | | Prioriteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | I | II | III | IV | |
| Objektivi Strategjik 2 - Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses | **Programi Strategjik OS2PS1: Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)** | | Projektet sipas listes se centraliteteve dhe funksioneve te reja ne dokuentin e Strategjise Territoriale per Bashkine Shkoder | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Agjencia Rajonale e Zhvillimit | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Plani i Veprimit | | | | | I lartë |
| | **Programi Strategjik OS2PS2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane** | | Rregullim i segmenteve rrugore nder-urbane | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Agjencia Rajonale e Zhvillimit | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Plani i Veprimit | | | | | I lartë |
| | **Programi Strategjik OS2PS3: Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale** | Nr Qëndra me një Ndalesë<br>Nr staf për qëndër<br>Nr përdorues<br>Nr staf i trajnuar | Hapja e zyrave me një ndalesë në të gjitha njësitë administrativ e | 5,500,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë | Hapja e Zyrës | | | | | I lartë |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Cilësia e Shërbimit të ofruar<br><br>Kënaqësia e Qytetarëve nga shërbimi | Projekt 'arkitekti im', njësia Rrethina | 20,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë | Trajnimi i stafit/ Hapja e Zyrës | | | | | I mesëm |
| | | | Projekt 'plan veprimi' komunitar | 1,000,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë | Plani i Komunitar Pilot | | | | | I mesëm |
| | | | Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV Shkodër | 20,000,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë/ Angazhim Privat | Të paktën 10 PDV të hartuara | | | | | Shumë i lartë |
| | | | Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV Velipojë/ Rrjoll | 5,000,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë/ Angazhim Privat | Të paktën 2 PDV të hartuara | | | | | Shumë i lartë |
| | | | Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV Shirokë/ Zogaj | 5,000,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë/ Angazhim Privat | Të paktën 2 PDV të hartuara | | | | | Shumë i lartë |
| | | | Nxitja e Zhvillimit nëpërmjet hartimit të PDV fshatra me presion zhvillimi | 10,000,000 Lekë | Bashkia Shkodër | Donatorë/ Angazhim Privat | Të paktën 10 PDV të hartuara | | | | | I lartë |
| | **Programi Strategjik OS2PS4: Qeverisja Elektronike** | Nr funksioneve të shtuara<br><br>Nr Shërbimeve online<br><br>Nr përdoruesit onlin | Projekti "taksat online" | | Bashkia Shkodër | Donatorë | Website Online | | | | | I lartë |
| | | | Projekt "këshillim për zhvillimin online" | 1 000 000 | Bashkia Shkodër | Donatorë | Website Online | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Programi Strategjik OS2PS5: Qëndrat Multifunksionale dhe shërbimet Sociale** | Nr Projekte të zbatuara<br><br>Nr Përdorues<br><br>Cilësia Fizike e ndërtesave | Përmirësimi i cilësisë së Shkollave<br><br>Projekti “Shkolla si Qëndër Multifunksionale” Postribë<br><br>Zhvillimi i Qëndrës Multifunksionale Adem Haxhija | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I lartë |
| | | | Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” (lagjia Mark Lula) | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I lartë |
| | | | Projekti “Qëndër Multi funksioanle Kiras”- rikualifikim i ish-shkollës së veterinarisë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I lartë |
| | | | Projekti “Qëndër Multifunksionale Dajç” | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I lartë |
| | | | Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” Bërdicë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I mesëm |
| | | | Projekti “Shkolla si qëndër komunitare” Gur i Zi | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Projekti "Shkolla si qëndër komunitare" Ana e Mali | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Agjencia Rajonale Shkodër | Qëndra Multifunksionale | | | | | I mesëm |
| | | | Rehabilitimi i Shkollave të mesme | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Bashkia/ Donatorë | Të paktën 4 shkolla gjatë 2 fazave të para | | | | | I lartë |
| | | | Rehabilitimi i Shkollave 9vjeçare | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Bashkia/ Donatorë | Të paktën 5 shkolla gjatë 2 fazave të para | | | | | I lartë |
| | | | Kopështe Çerdhe | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Bashkia/ Donatorë | Të paktën 6 shkolla gjatë 2 fazave të para | | | | | I lartë |
| | | | Përmirësimi i cilësisë së ambjeteve të qëndrave shëndetësore në njësitë administrative | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FSHZH | Bashkia/ Donatorë | | | | | | I lartë |

| **Objektivi strategjik** | **PROGRAMI STRATEGJIK** | **Treguesit e monitorimit** | **Projektet** | **VLERA** | **Burimi Mundshëm Kryesor i të ardhurave** | **Burimi i mundshem dytesor** | **Tregues Vlerësimi** | **FAZAR E ZBATIMIT** | | | | **Prioriteti** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | **I** | **II** | **III** | **IV** | |
| **Objektivi Strategjik 3- Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik** | **OS3PS1 Zhvillimi Rural** | Sip bazë e fermës<br>Nr projekte të zbatuara | Pastrimi i Kanaleve të Kullimit dhe Ujitjes<br>Studim i gjëndjes dhe Pastrimi i kanaleve vaditjes dhe kullimit në Bashkinë Shkodër | 16 000 000 | FZHR- Granti për kanalet e Kullimit dhe Vaditjes | Agjencia Rajonale Shkodër | Pastrimi i Kanaleve | | | | | Shumë i lartë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fonde për Zh. Rural | Zgjerimi i Rrjetit të Ujësjellësit Velipojë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale Shkodër | Zgjerimi i rrjetit | | | | | I lartë |
| | Zgjerimi dhe rikonstruksioni i rrjetit të kanaleve të kullimit të ujitjes | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për kanalet e Kullimit dhe Vaditjes | Agjencia Rajonale Shkodër | Zgjerimi dhe rikonstruksioni I kanaleve | | | | | I lartë |
| | Hartimi i Planit të Menaxhimit të Tokës Bujqësore në njësinë administrative | 2,500,000 Lekë | Bashkia | Donatorë | Plani i menaxhimit | | | | | I mesëm |
| | Hartimi i Planit të Peizazhit Bujqësor | 200,000 Lekë | Bashkia | Donatorë | Plani peisazhistik | | | | | I ulët |
| | Kompostimi në bazë ferme/ familje për Nj. Administrative Postribë/ Pult/ Shosh/ Shalë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale Shkodër | Perqindja e mbetjeve te kompostuara | | | | | I mesëm |
| | Nxitja e marredhënieve formale (kontraktim, bashkëpunim) ndërmjet prodhuesve, grumbulluesve dhe tregtareve | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Nr. i kontratave<br>Nr. i kooperativave bujqësore apo shoqatave | | | | | I mesëm |
| | Zgjerimi i tregut rajonal ekzistues në Shkodër<br><br>Tregu rajonal dhe thertore Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë | Tregu | | | | | Shumë i lartë |
| | Ndertim i tregut te ri (ish Parku i Mallrave)<br><br>Rikonstruksion i tregut Rus | 88,245 Euro<br><br>17,833 Euro | Bashkia | Donatorë | Tregu | | | | | I lartë |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Krijimi i qendrave të grumbullimit dhe ruajtjes së produkteve bujqësore, qëndrave frigoriferike. | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR Granti për tregjet rajonale | Donatorë | Nr i bizneseve të rëja agro përpunuese. Numri i qendrave te grumbullimit dhe ruajtjes se produkteve bujqesore, qendrave frigoriferike. Nr i serave te krijuara. | | | | | I lartë |
| | | | Hapja e tregut BIO në Postribë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë | Tregu | | | | | I lartë |
| | | | Hapja e tregut rajonal Bërdicë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë | Tregu | | | | | I mesëm |
| | | | Thertore Berdicë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Donatorë | Thertorja | | | | | I mesëm |
| | | | Ndërtimi i Nyje shërbimi Bujqësore në Bërdicë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Donatorë | Nyeja e sherbimit bujqesor | | | | | I mesëm |
| | | | Nyje Bujqësore në Postribe | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Donatorë | Nyeja bujqesore | | | | | I mesëm |
| | | | Rikualifikimi i Tregut lokal Zdrale | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Donatorë | Tregu | | | | | I mesëm |
| | | | PPP nyje bujqësore Ana e Malit<br><br>Nyje Shërbimi Bujqësore në Njësinë Administrative Ana e Malit | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë/ PPP | Nyje Bujqësore | | | | | I lartë |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | PPP nyje bujqësore Gur i Zi | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë/ PPP | Nyje Bujqësore | | | | | I lartë |
| | | | PPP nyje bujqësore Velipojë | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë/ PPP | Nyje Bujqësore | | | | | I lartë |
| | | | PPPi Nyje Bujqësore në Dajç | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë/ PPP | Nyje Bujqësore | | | | | I lartë |
| | | | Organizimi i pazarit javor | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia Shkoder | Donatorë | Organizimi i pazarit javor | | | | | I mesëm |
| | | | Tregu rajonal i peshkut | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR- Granti për Tregjet Rajonale | Donatorë/ PPP | Nyje Bujqësore | | | | | I ulët |
| | **Programi Strategjik OS3PS2: Zhvillimi Akuakulturës** | | Hartimi i planeve të menaxhimit të akuakulturës | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia Shkoder | Donatorë | Planet e Menaxhimit te Akuakultures | | | | | I mesëm |
| | | | Zhvillimi i ekonomise se aqua - kultures<br><br>Konvertimi i vaskave në Pulaj në funksion të Akuakulturës<br><br>Tregjet lokale per peshkim dhe aqua-kultures<br><br>Tregjet lokale Velipoje | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR Granti për tregjet rajonale | Donatorë | Certifikimi i produkteve detare dhe liqenore.<br><br>Marketimi | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Programi Strategjik OS3PS3: Zhvillimi i Turizmit** | Nr. Hoteleri sipas kategorive<br>Nr. Bujtina të Reja<br>Nr. Guida<br>Projekte të zbatuara<br>Nr Vizitorë ditorë<br>Nr Turistë<br>Nr Vizitorë sipas atraksioneve turistike<br>Evente social kulturore të zhvilluara në Shkodër<br>Nr Konferenca dhe Panaire | Inventarizimi i resurseve dhe aktorëve turistike në territorin e Bashkisë Shkodër | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Pasurimi i Database | | | | | I lartë |
| | | | Konsolidimi i forumit/bordit të turizmit për planifikimin strategjik lokal | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | | Një takim në 3 muaj, i realizuar. | | | | | I lartë |
| | | | Nxitja e bashkëpunimit ndërkufitar | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | | | | | | I lartë |
| | | | Rehabilitimi i zonave dhe vendeve arkeologjike | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Studim për zonat e ndërhyrjes. Inventarizim i perditesuar.<br>5 vende arkeologjike te rehabilituara | | | | | I lartë |
| | | | Zhvillimi i “Kuartierit të Muzeve” në qytetin Shkodër | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Zhvillimi i Kuartierit të Muzeve | | | | | I lartë |
| | | | Zhvillimi i itinerareve turistike<br>a. Rrjeti i kalave<br>b. Muzeu i bicikletave | | | | | | | | | I lartë |
| | | | Organizimi i ngjarjeve, aktiviteteve, nëpërmjet koordinimit të strukturave kulturore dhe turistike | | Bashkia | Donatorë | | | | | | I lartë |
| | | | Zhvillimi i itinerarëve për qëllime ecjen në parkun e Thethit<br>a. Evidentimi i shtigjeve të sigurta për ecje<br>b. Evidentimi i shtigjeve të sigurta për bicikleta<br>c. Itinerari i kalërimeve | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | Bashkia/ Donatorë | Të paktën 5 itinerare të reja | | | | | I lartë |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Muzeu i Flores dhe Faunes | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Agjencia Rajonale Shkodë | Bashkia/ Donatorë/MZHETTS | | | | | | I mesëm |
| | | | Zhvillimi i Itinerarit Ujor përgjatë lumit Bunë | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Itinerari | | | | | I mesëm |
| | | | Evidentimi dhe rehabilitimi i plazheve lumore dhe liqenore | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Zhvillimi i itinerarëve për Lëvizjen me biçikletë për qëllime turistike përgjatë Liqenit të Shkodrës, Lumit Buna, Liqenit të Vau Dejes dhe Velipojës | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Të paktën 4 itinerare në 2 fazat e para | | | | | I lartë |
| | | | Inegrimi i produkteve tipike në paketat turistike. Akses i ekonomisë rurale në produktin turistik. | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Integrimi i vizitave në ferma dhe pikave të soditjes | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Zhvillimi i një qëndre për panaire, konferenca dhe evente madhore<br>a. Krijimi i paketave dhe ofertave të vecanta për organizimin e panaireve dhe konferencave | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR/ Agjencia Rajonale | Donatorë/ Investitorë | Qëndra | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nxitja e Ekoturizmit: Vëzhgimi i zogjve | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Trajnimi i kapaciteteve njerëzore<br>a. Trajnimi i Guidave<br>b. Trajnimi i kapaciteteve njerëzore për përmiresimin e shërbimeve turistike<br>c. Trajnime për gratë për menaxhimin e bujtinave | 1500 000 | Bashkia | Donatorë/ Universiteti | Trajnimi i të paktën 30 guidave lokale dhe 150 punonjësve të akomodimit | | | | | I mesëm |
| | | | "Kopështari – Kuzhinë – Bujtinë" – Tradita e Familjes | | | | | | | | | I mesëm |
| | | | Permiresimi i aksesit ne zonat turistike<br>a. Përmirësim i Plazheve në aksin Shirokë-Zogaj<br>b. Pastrimi i plazheve<br>c.Permiresimi i aksesit në plazhet publike Velipoje<br>d. Aksesi në zonën Prekal-Theth | 5 000 000 | Bashkia | Donatorë/ PPP | 3 monumente kulturore, 2 natyrore, dhe të paktën 5 plazhe me akses të përmirësuar | | | | | I mesëm |
| | | | Ndërtimi i Pontileve për lëvizje detare | 2 000 000 | FZHR/ Agjencia Rajonale e Zhvillimit Shkodër | Bashkia/ Donatorë | Një pontil Detar | | | | | I mesëm |
| | | | Certifikimi i produkteve | | | | | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Perdorimi i teknologjive inovative ne promovimin e turizmit<br>a. Aplikacioni Shkodra Turizëm | 500 000 | Bashkia | Donatorë | Aplikacioni online | | | | | I mesëm |
| | | | Mbështetja e zinxhirit të produkteve lokale (pijet, bulmeti dhe kulturat e tjera bujqësore)<br><br>**a**.Promovimi i itinerarit gastronomik pergjatë Liqenit të Shkodrës<br>**b**.Mbështetja dhe perpunimi i bimëve medicinale | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | ARZH/PPP | 150 fermerë të trajnuar për rritjen e cilësisë dhe certifikimit të produkteve.<br>Marka e produkteve.<br>tudimi mbi bimet medicinale, organizimi i rrjetit të bimëve të Shkodrës, strategjia për prom.dhe marketimin e tyre | | | | | I mesëm |
| | | | Mbeshtetja e artizanatit | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | | Panaire | | | | | I mesëm |
| | | | Hartimi dhe publikimi i materialeve promocionale | Për t'u përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | Bashkia | Donatorë | Harta TN, TK, Guide e perditesuar, broshura, harta itineraresh | | | | | I mesëm |
| | | | Hartimi i planit të tabelave orientuese turistike për Bashkinë Shkodër<br>a. Përmirësim i sistemit të tabelave orientuese dhe informuese për turizmin | 7 000 000 | Bashkia | Donatorë | Tabelat orientuese | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zhvillimi i inkubatorit të biznesit Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit | FZHR | Donatorë | Inkubatori | | | | | I lartë |
| | | Nr i sipermarrje të reja në vit | Zgjerimi i Rrjetit të Internetit me shpejtësi të lartë në të gjithë qytetin Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit | FZHR | Donatorë/ Kompani Telekomunika-<br>-cioni | Zgjerimi i rrjetit | | | | | I mesëm |
| | | | Shërbime të e-qeverisjes | Për të përcaktuar gjatë hartimit | FZHR | Donatorë/ Kompani Telekomunika-<br>-cioni | Ofrimi i shërbimeve online në cdo pikë dhe distance | | | | | I mesëm |
| | **Programi Strategjik OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja** | Nr i sipërmarrje të cilat kanë akses në trajnime | Studim strukturor i ekonomisë dhe prespektivave të zhvillimit. | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Bashkia. Donatorë. Programe te BE | Hartimi i dokumentave strategjik dhe planeve për zhvillimin ekonomik. | | | | | I lartë |
| | | Nr sipërmarrje të reja sipas sektorit ekonomik | Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qellim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekszistuese. | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Bashkia, Donatorë, Programe te BE | Aplikimi i taksave lehtësuese për bizneset e reja. Ndërmjetësim për sherbime bankare, financiare.<br><br>Numri aktiviteteve mbështetëse për komunitetin e biznesit në 3 nivele: fillestar, arritje dhe zhvillim i bizneseve të vogla | | | | | I lartë |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Hartimi dhe zhvillimi i programeve te trajnimit. | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Donatorë | Bashkia | Hartimi i planeve individuale të veprimit . Nr. i trajnimeve të organizuara. Nr i të trajnuarëve. Ngritja e kapaciteteve njerëzore të specializuara. | | | | | I mesëm |
| | | | Organizimi i panaireve me bizneset dhe fermerët në nivel rajonal çdo vit për promovimin dhe zhvillimin e biznesit dhe tregun e punës. | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Bashkia, Donatorë, Programe te BE | Nr. i panaireve të organizuara | | | | | I mesëm |
| | | | Forcimi i rrjetit të bashkëpunimit (vleresim i përbashkët i nevojave dhe ofertës së tregut të punës) | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Bashkia, Donatorë, Programe të BE | Partnertiteti me sektorin privat, arsimin, trajnimin profesional dhe kerkimeve shkencore Kurset e formimit profesional të organizuara çdo vit. | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nxitja dhe promovimi i bizneseve krijuese | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Bashkia, Donatorë, Programe te BE | Subvencionimi dhe lehtësimi për krijimin e bizneseve kreative | | | | | I lartë |
| | | | Mbështetja dhe lehtesimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare | Për të përcaktuar gjatë hartimit | Bashkia | Donatorë Bashkia, Programe të BE | Dhënien e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm.<br><br>Përmirësimi i marredhënieve midis institucioneve financiare dhe bashkisë për kreditimin e bizneseve<br><br>Rritje e konkurueshmerisë dhe inovacionit të bizneseve në tregjet rajonale. (shërbime, industri e lehtë, agropërpunim) | | | | | I lartë |
| | **Programi Strategjik OS3PS5: Zhvillimi i Zonave Ekonomike** | Nr i bizneseve të reja në zonën ekonomike<br><br>Sip toke të rigjeneruar | Zona e ish-fushës së aviacionit- zonë e lirë ekonomike | Për të përcaktuar gjatë hartimit të projektit të detajuar | FZHR | PPP/ Donatorë | Rikualifikimi i ish-fushës së aviaionit<br>Nr. i bisneseve<br>Nr. i të punësuarëve<br>Volumet tregtare | | | | | I mesëm |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rikualifiki Mjedisor i ish-zonës industriale Shkodër | Për të përcaktuar gjatë hartimit | FZHR | PPP/Donatorë | Rikualifikimi i ish zonës industriale | | | | | I lartë |
| Pershkrimi i projektit | Sektori i Bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Bashkisë Shkodër. Edhe pse është një ndër sektorët e rëndësishëm të ekonomisë, fermerët vazhdojnë të hasin probleme në gjetjen e tregjeve dhe shitjen e produkteve të tyre. Një tjetër problematikë është dhe mungesa e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve apo dhe informaliteti në këtë sektor. Ndërkohë, edhe agro-përpunimi që është një potencial i madh për këtë zonë është në nivele shumë të ulëta, pjesërisht si rrjedhojë e vështirësisë për të grumbulluar produkte.<br>Projekti parashikon ndërtimin e një qëndre unike në llojin e saj. Kërkon të integrojë në një zonën ekzistuese të tregut rajonal të Dobraçit edhe një thertore dhe qëndrën e kontrollit të ushqimit. Kombinimi i këtyre dy aspekteve, pra thertore dhe tregtim rrit efiçiencën dhe mundësitë e produkteve për të arritur në tregje më të gjera. Gjithashtu, në kuadër të thertores do të vendosen dhe aparaturat e nevojshme për kontrollin e cilësisë. Në këtë mënyrë dhe produktet të cilat më pas kalojnë në tregun rajonal mund të shfrytëzojnë të njëjtat facilitete. Thertorja do të shërbejë edhe si zyrë këshillimore për blegtorët. Gjithashtu, tregu do të ketë dhe një seksion të dedikuar për farat.<br>Ky kompleks i integruar, Thertore dhe Treg, do të ketë edhe ambjentet e nevojshme për trajtimin e mbetjeve organike me anë të kompostimit. Në këtë mënyrë krijohet një cikël i plotë i trajtimit të produktit si dhe i reduktimit të mbetjeve. |
| Qellimi dhe objektivat | Qëllimi i projektit është mbështetja e prodhimeve vendase.<br>- Siguri për produktet bujqësore.<br>- Rritje e tregtimit të produkteve bujqësore<br>- Mbështetje ndaj fermerëve<br>- Ngritje kapaciteti (duke operuar edhe si qëndër trajnimi) |
| Rezultatet e pritshme | - Krijimi i vendeve të reja të punës në kuadër të Tregut Rajonal<br>- Mbështetja e fermerëve (trajnime, konsultime, kontroll sigurie të produkteve etj)<br>- Pastërti dhe siguri ushqimore |
| Rendi prioritar | 7 |
| Qendrueshmeria e projektit | Projekti fillimisht do të menaxhohet nga Bashkia. Më pas do të ngrihen strukturat për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tij me anë të partneriteteve publike-private. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:<br>- Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik)<br>- Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU<br>- Ndërtimi i thertores<br>- Ndërtimi i ambjenteve të tregut<br>- Ngritja e zyrës për kontrollin e cilësisë dhe këshillimit të |

| | |
|---|---|
| | fermerëve<br>- Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike me anë të kompostimit<br>- Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Projekti duhet të shoqërohet me një Vlerësim të ndikimit në Mjedis. Një ndër çështjet më kryesore e cila lidhet me mbetjet organike që mund të gjenerohen nga thertorja dhe tregu është parashikuar në projekt. Qëndra parashikohet të ndërtohet në ambjentet ekzistuese të tregut duke përmirësuar cilësinë e tyre dhe zbutur ndikimin në mjedis. Gjithësesi, një VNM duhet hartuar pasi të ketë mbaruar faza e projektimit të qëndrës dhe tregut. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është ende në fazën e konceptit. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten:<br>a. Studim fizibiliteti<br>b. Projekt Teknik<br>c. VNM |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është në kuadër të strategjisë së Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për ngritjen e tregjeve dhe qëndrave të grumbullimit. Gjithashtu bazohet në hartën e rajonalizimit të produkteve bujqësore dhe përbën një incentivë për zbatimin e kësaj politike. |



**Projekte Pilote**

**Projekti nr 11 Vlerësimi Eficiences Energjitike**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emërtimi i Projektit | Vlerësimi Eficiences Energjitike |
| Tipi i Projektit | Studim |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër |
| Buxheti total i projektit | 15 000 000 lek |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Donatorë<br>Bashkia<br>Ministria e Energjisë dhe Industrisë<br>FZHR<br>Agjencia Rajonale për Zhvillim SHkodër<br>Enti Kombëtar i Banesave |
| Përshkrimi i projektit | Në bashkinë Shkodër rreth 28.6% e ndërtimeve janë të ndërtuara para vitit 1991, ndërsa 39.1% e tyre janë pas viteve 1991. Sipas legjislacionit të ri për energjetikën, LIGJ Nr. 9379, datë 28.4.2005 ''PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË'', objektet nuk i plotësojnë kushtet për efiçencën energjitike. Ky projekt synon krijimin e një databaze të integruar në sistemin infomatik gjeografik (GIS). Ky projekt do të shërbej si bazë më pas për ndërhyrjet në ndërtesa në përmirësimin e cilësisë së tyre. |
| Qëllimi dhe objektivat | Qëllimi i projektit është:<br>- Krijimi i një databaze<br>- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese<br>- Hartimi i projekteve të mëtejshme |
| Rezultatet e pritshme | - Njohuri me e mirë mbi standaret e ndërtesave<br>- Krijimi i databazës<br>- Rritje e ndërgjegjsimit për eficentimin e energjis.<br>- Platformë për hartimin e projekteve të tjera |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qendrueshmeria e projektit | Ky projekt është në ndërthurje me projekte të tjera të cilat janë të integruara me njëra-tjetrën. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:<br>- Ngritjen e grupit të punës;<br>- Inspektimet në terren;<br>- Ngritja e sistemit të GIS;<br>- Hartimi i rekonamdimeve per permiresime të mëtejshme. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është ende në fazën e konceptit. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten:<br>d. Termat e referencës<br>e. Gjetja e donatorve |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Është në përputhje me ligjin për efiçencën energjetike (**LIGJ Nr. 9379, datë 28.4.2005 ''PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË''**. Planin e Përgjithsëm Kombëtarë dhe Pincbregdeti. |

**Projekti nr 12. Hartimi i Strategjisë së Branding të Bashkisë**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Hartimi I Strategjisë së Branding të Bashkisë |
| Tipi i Projektit | Zhvillim ekonomikë/Turizëm |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër |
| Buxheti total i projektit | |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Bashkia Shkodër<br>Donatorë<br>OJF<br>Agjencia Kombëtare e Turizmit |
| Përshkrimi i projektit | - Bashkia Shkodër një traditë për kultivimin e produkteve lokale si duhan, perime, produkte BIO. Gjithashtu ajo zotëron potenciale të mëdha natyrore, peizazhistike, kulturore e historike. Promovimi i këtyre aseteve dhe rritja e vizitorëve do të ndihmojë në qëndrueshmërinë e projektit. Gjithashtu do të ketë dhe një tarifë simbolike për nga bizneset të cilat do të përfitojnë reklamim/ promovim.<br>Projekti synon rritjen e vizibilitetit të Bashkisë Shkodër dhe promovimit të potencialeve. Projekti përbëhet nga disa hallka të lidhura me njëra tjetrën si krijimi i një “marke” të dedikuar për shkodrën. Krjimi i një faqeje interneti për komunikimin me publikun, vizitorët dhe promovimin e potencialeve e aktiviteteve që zhvillohen në brënda bashkisë. Krijimin e një kalendari aktivitetesh me synim promovimin e shkodrës bazuar në vizionin dhe prioritetet e saj. Prodhimin e broshurave, materialeve informative, vendosjen e tabelave informuese për potencialet e bashkisë.<br>Ky projekt ka si qëllim të marketojë vecoritë e bashkisë shkodër dhe të rrisë vizibilitetin për atraksionet e saj. |
| Qëllimi dhe objektivat | Qëllimi i projektit është promovimi i potencialeve të Bashkisë Shkodër.<br>Objektivat janë:<br>- Krijimi i një brand (markë) për Bashkinë<br>- Promovimi i produkteve bujqësore dhe potencialeve për agro-turizëm<br>- Promovimi i potencialeve natyrore<br>- Promovimi i potencialeve historike dhe kulturore<br>- Promovimi i itenerarëve malorë<br>- Promovimi i aktiviteteve sportive<br>- Krijimi i një kalendari aktivitetesh me fokus promovimin e potencialeve të Shkodrës |
| Rezultatet e pritshme | Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e Bashkisë pasi ky marketim do të sjellë rritjen e numrit të vizitorëve dhe statusit rajonal për bashkinë.<br>- Rritja e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e investitorëve<br>- Promovimi i Bashkisë në nivel kombëtar e ndërkombëtar<br>- Rritja e atraktivitetit për investime në bashki<br>- Rritja ekonomike dhe e cilësisë së jetës |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qëndrueshmeria e projektit | Ky projekt është një ndër masat e buta të cilat duhen marrë për zhvillimin afatgjatë ekonomik të Bashkisë. Ai është i ndërlidhur me |

| | |
|---|---|
| | projektet e tjera në funksion të zhvillimit ekonomik, zhvillimit rural e zhvillimit të sektorëve turistikë. Gjithashtu, promovimi i potencialeve natyrore, kulturore e historike rrit vetëdijen e banorëve për rëndësinë e tyre si dhe ndihmon në mbrojtjen e tyre nga dëmtimi dhe në krenarinë për qytetin. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti do të ketë një imaktë afatgjatë në marketimin e shkodrës dhe vlerave historike e kulturore të saj. dhe përfshin aktivitetet e mëposhtme:<br>- Krijimi i një liste aktivitetesh promovuese si panaire, festivale, konferenca, seminare që mund të zhvillohen në ambjentet e kalasë<br>- Krijimi i faqes elekronike që ofron informacionin për aktivitetet e bashkisë<br>- Ndërtimi i Faqes së internetit<br>- Hartimi i Broshurave për eventet vjetore<br>- Faqe në rrjetet sociale si facebook, tëitter etj<br>- Promovimi i vazhdueshëm |
| Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis | N/A |
| Përshkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është në fazë koncepti dhe nevojtet një koordinim I mirë nga ana e bashkisë,për të nxitur sa më shumë organizimin e eventeve në kala,duke ruajtur gjithmon vlerat historike dhe kulturore. Disa nga hapat lidhet me krijimin e databazave përsa i përket aktiviteteve, festive,festivaleve dhe koncerteve të ndryshme që mund të organizohen aty. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombetar | |









**Projekti nr 13 Itinerari me Bicikleta Shkodër Velipojë**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Itinerari me Bicikleta Shkodër Velipojë |
| Tipi i Projektit | Zhvillim ekonomikë/Turizëm |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër |
| Buxheti total i projektit | Për tu përcakuar gjatë hartimit të projektit të detajuar |
| Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga Qeveria Vendore | Bashkia Shkodër<br>Donatorë<br>OJF<br>Agjencia Kombëtare e Turizmit |
| Përshkrimi i projektit | Bashkia Shkodër ka një traditë të madhe në pedalim. Gjithashtu relievi dhe struktura e territorit lejon që të ketë një përdorim të gjerë bicikletash. Ka pasur disa tentative për të përdorur pedalimin edhe për promovimin e bashkisë dhe të turizmit. Në këtë kontekst do të zhvillohet itinerari me bicikleta SHkodër-Velipojë. Itinerari ndjek kryesisht rrjedhën e lumit Buna. Në të do të vendosen dhe hapësira për rekreacion dhe për kamping apo dhe aktivitete të tjera. Përgjatë itinerarit do të ketë dhe vende për vetë-shërbim për të rregulluar apo riparuar bicikletat. Ky itinerar do të shërbejë edhe për qëllime turistike dhe promovimit të Bashkisë. |
| Qëllimi dhe objektivat | Zhvillimi i Itinerarit me bicikleta Shkodër Velipojë.<br>- Promovim i Territorit<br>- Itinerar Peizazhistik/Turistik<br>- |
| Rezultatet e pritshme | Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e Bashkisë pasi ky marketim do të sjellë rritjen e numrit të vizitorëve dhe statusit rajonal për bashkinë.<br>- Rritja e vizibilitetit të potencialeve dhe tërheqja e turistëve<br>- Promovimi i Bashkisë<br>- Rritja e atraktivitetit |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qëndrueshmeria e projektit | Ky projekt është një ndër masat e buta të cilat duhen marrë Bashkia. Ai është i ndërlidhur me projektet e tjera në funksion të zhvillimit zhvillimit rural e zhvillimit të sektorëve turistikë. Gjithashtu, promovimi i potencialeve natyrore, kulturore e historike rrit vetëdijen e banorëve për rëndësinë e tyre si dhe ndihmon në mbrojtjen e tyre nga dëmtimi dhe në krenarinë për qytetin. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti ka një kohëzgjatje prej 6 muaj<br>- Përzgjedhja e itinerarit<br>- Hartimi i projektit<br>- Zbatimi<br>- Promovimi |
| Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis | N/A |
| Përshkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është në fazë koncepti dhe nevojtet një koordinim I mirë nga ana e bashkisë për zhvillimin e tij. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombetar | Projekti është i ndërlidhur me konceptin e “rrjetit kombëtar të bicikletave” të propozuar në PPK. |


SHKODER
ZOGAJ
SHIROKA
GURI ZI
DAJC
VELIPOJE

**Projekti nr 14 Kompostimi në bazë ferme/familje për Nj. Administrative Postribë/ Pult/ Shosh/ Shalë**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Kompostimi në bazë ferme/familje për Nj. Administrative Postribë/ Pult/ Shosh/ Shalë |
| Tipi i Projektit | Infrastrukturë/ Mjedis |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Postribë, Nj. A Pult, Nj. A Shosh, NJ. A Shalë |
| Buxheti total I projektit | 20 000 Euro |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | FZHR- Granti konkurues për infrastrukturën vendore<br>Donatorë<br>OJQ<br>Programe ndërkombëtare në fushën e mjedisit |
| Pershkrimi i projektit | Menaxhimi i mbetjeve mungon në Njësitë Administrative të Pultit, Shalës, Shoshit dhe Postribës. Në disa raste ai kryhet nga njësia administrative por është i pamjaftueshëm, duke çuar shpesh fermerët në hedhjen e mbetjeve në lumenj e prrenj. Këto njësi administrative janë në zona kryesisht malore, ku aksesueshmëria është e ulët. Gjitashtu, mbetjet e gjeneruara janë më së shumti të karakterit organik dhe vijnë nga bujqësia në shkallë të vogël. Për këtë arsye, për të shmangur hedhjen e mbetjeve në lumenj dhe uljen e Ulja e impaktit mjedisor të shkaktuar nga rryma e mbetjeve si dhe rritjen e ndërgjësimit te banorëve për gjurmën ekologjike në mjedis. Promovimi i kompostimit në bazë ferme është një përpjekje për të ulur sasinë e mbetjeve në bashkinë Shkodër. Gjithashtu ky projekt do të përdoret më pas si një shembull dhe një model i mirë për t`u shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë. Projekti do të fokusohet kryesisht në promovimin e kompostimit kryesisht në zonat malore e rurale duke që në se për shkak edhe të karakteristikave ato janë e më të përshtatshme për ta zhvilluar këtë lloj aktiviteti. Kompostimi në familje konsiston në trajtimin vetëm të mbetjeve organike të gjeneruara nga ajo. Kompostimi ë shtë një proces i thjeshtë dhe efikas për të ulur rrymën e mbetjeve që depozitohet në kosha e në të njëjtën kohë i kthen mbetjet organike në pleh i cili mund të përdoret më vonë në bujqësi. Për kryerjen e kompostimit nevojitet një kosh me përmasa $1m^3$ i cili mund të pozicionohet në pjesën e mbrapme të shtëpisë , proçesi i formimit të kompostit final konsiston në : hedhejen e produkteve me përmbajtje azoti (mbetje drusore,gjethe,kashtë) dhe produkteve me përmbajtje karboni (mbetje kafe, mbetje ushqimore,bar i prerë) këto produkte përzihen në praninë e ujit në mënyrë që të jenë gjithmonë të lagështa dhe të ajrosura me oksigjen. Në fund, produkti mund të përftohet për një kohë relativisht të shkurtër dhe më pas të përdoret sërish në bujqësi. |
| Qellimi dhe objektivat | Ndërgjegjësimin e fermerëve në lidhje me mbetjet dhe aplikimi i kompostimit në bazë ferme/familje |
| Rezultatet e pritshme | - Fillimisht nga projekti do të përfitojnë 200 fermerë/familje<br>- Ndërgjegjësim në lidhje me mbetjet organike<br>- Mundësi të reja nga kompostimi |
| Rendi prioritar | |
| Qendrueshmeria e projektit | Projekti është i qëndrueshëm pasi lidhet ngushtësisht me politikat dhe programin e menaxhimit të mbetjeve. Pas aplikimit të tij do të monitorohet në mënyrë konstante për të parë rezultatet. Qëndrueshëmria e projektit garantohet edhe nga fakti se një rol të rëndësishëm do të luajnë dhe vetë fermerët në këtë proces. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 6 muajsh dhe parashikohen disa aktivitete:<br>- Përzgjedhja e fermerëve/familjeve<br>- Trajnimi i tyre |

| | |
|---|---|
| | - Shpërndarja e koshave<br>- Diseminimi i njohurive tek fermerët e tjerë |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është në fazën e konceptit. Është e nevojshme që të përzgjidhen fermerët. Të përgatiten kurikulat për trajnimin e tyre. Të shpërndahen koshat dhe më pas të monitorohet ecuesshmëria e projektit |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | |



**Projekti nr 15 Rregullimi i Sheshit Kryesor Gomsiqe**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Rregullimi i Sheshit Krysor Gomsiqe |
| Tipi i Projektit | Rikualifikim Urban |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër, njësitë administrative |
| Buxheti total I projektit | Për tu vendosur gjatë projektit teknik |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | FZHR- Fondi i Zhvillimit të Rajonave |
| Pershkrimi i projektit | Bashkia Shkodër tashmë është një entitet i ri, i përbërë nga 11 Njësi Administrative kryesisht rurale. Në vizionin e bashkisë është integrimi territorial dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të saj. Për këtë arsye është e rëndësishme që të aplikohen edhe disa projekte të tipit "akupunturë" urbane në njësitë administrative. Projektet synojnë rregullimin e shesheve qëndrore të fshatrave kryesore të njësive administrative dhe në rastin konkret rregullimin e sheshit qëndror në:<br>- Gomsiqe<br><br>Rikualifikimi urban duhet të përfshijë materiale lokale dhe të synojë të ofrojë një hapësirë sociale sa më të këndshme për banorët e zonës dhe vizitorët potencial. Përreth sheshit mund të ketë disa aktivitete sociale ose ekonomike të cilat zhvillohen por duhet të jenë gjithnjë në harmoni me sheshin. |
| Qëllimi dhe objektivat | - Përmirësim i cilësisë së jetës<br>- Përmiësim i cilësisë urbane<br>- Rikualifikim urban |
| Rezultatet e pritshme | - Përmirësim i cilësisë së jetës<br>- Përmiësim i cilësisë urbane<br>Rikualifikim urban |
| Rendi prioritar | |
| Qëndrueshmeria e projektit | Projekti është i ndërlidhur me një sërë politikash dhe programesh të tjera për të promovuar policentrizmin dhe qëndrueshëmrinë sociale. |
| Aktivitetet e projektit | - Hartimi i projektit teknike<br>- Aplikim për fonde FZHR, granti për infrastrukturën lokale<br>- Zbatim i projekteve |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Përshkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është ende në fazën e konceptit. Mund të zbatohet në faza ose si një program i tërë. |
| Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar | |


Baks I Ri
SH27
Gomsiqe
MBISUKA

**Projekti nr 16 Terminali Ujor Turistik Liqeni Shkodër**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Terminali Ujor Turistik Liqeni Shkodër |
| Tipi i Projektit | Infrastrukturë/ Shërbime/ Rigjenerim |
| Vendndodhja e projektit | Liqeni Shkodër (Bexhisteni) |
| Buxheti total I projektit | Për tu vendosur në projektin teknik |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | FZHSH/ FZHR/Donatorë/ PPP/ Bashkia/ IPA Cross Border |
| Pershkrimi i projektit | Shkodra ka pasur një Port Historik i cili shërbente për lidhjen e saj dhe transportin e mallrave e udhëtarëve me vendet fqinje. Ky projekt synon të risjellë këtë facilitet urban por tashmë me një karakteristikë më shumë turistike. Vendi i portit është shumë strategjik pasi ndodhet pranë akseve kryesore të qytetit si dhe zonës së Pazarit të vjetër. Ndodhet gjithashtu pranë kalasë dhe ofron hapësira të mjaftueshme edhe për parkimin e autobuzëve turistik apo dhe kombinimin me transport public. |
| Qellimi dhe objektivat | - Ndërtimi i një porti të ri në Liqenin e Shkodrës për të lidhur Shkodrën me Malin e Zi. Ndërkohë, në planin afatgjatë mund të shërbejë edhe në lidhjen me lumin Buna. |
| Rezultatet e pritshme | - Rritje e Turistëve<br>- Përmirësim i Lidhjeve<br>- Atraksion Turistik<br>- Zhvillim të aktiviteteve |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qendrueshmeria e projektit | Projekti është i ndërlidhur me një sërë masash në fushën e turizmit si krijimi i itinerareve turistike. |
| Aktivitetet e projektit | - Hartimi i Projektit të dejuar<br>- Aplikimi për fonde<br>- Zbatimi i projektit |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Koncept |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është në përputhje me PPK |


Terminali Ujor Turisik
Buna
Hotel Arifi
Frigoriferi
Sheshi Kryepazar
Restaurant Riviera
ETERIT KAPUÇIN
Shtepia E Birres Kaon
Bar Restaurant Taverna Bexhisteni
Amerika
Rruga 6 Maji
Rruga Qafes
Rruga 9 Nuset
Rruga e Terzive
SH24
Google

**Projekti nr 17 Tregu Rajonal BIO në Postribë**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Tregu Rajonal BIO në Postribë |
| Tipi i Projektit | Zhvillim ekonomik/ Zhvillim rural |
| Vendndodhja e projektit | Njësia Administrative Postribë |
| Buxheti total I projektit | Për tu vendosur në momentin e hartimit të projektit teknik |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | Bashkia<br>Format PPP<br>FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU |
| Pershkrimi i projektit | Njësia Administrative Postribë ka një potencial të madh për produktivitet me rreth 1040 hektarë tokë bujqësore të cilësisë së lartë. Aksesueshmëria në tregje më të mëdha për prodhuesit është shumë e vogël. Pjesa më e madhe e popullsisë së Postribë është e varur nga sektori i bujqësisë.<br>Projekti konsiston në ngritjen e një tregu për produktet vendase BIO. Ndër problemet e tjera për këtë sektor është kostoja e lartë e dërgimit të këtyre produkteve në tregun e madh. Në mungesë të një tregu për të gjitha produktet e prodhuara në Postribë bën që prodhuesit të kenë kosto të larta transportit lidhur me sasinë e ulët të produktit që ata tregtojnë individualisht, ndaj fitimi është shumë i ulët për të mos thënë inekzistent. Tregu do të mbështesë prodhimet kryesore të zones të cilat janë organike. Gjithashtu do të kryejë dhe çeritifikimin e produkteve dhe përgatitjen e tyre për konsumatorin ose për agro-përpunuesit. Qëndra do të ngrihet në formën e një PPP midis bashkisë, fermerëve dhe me anë të mbështetjes në grantet konkuruese të FZHR. Gjithashtu, kjo tregu do të shërbejë dhe për fermerët e tjerë të njësive administrative Pult, Shalë, Shosh. |
| Qellimi dhe objektivat | Qëllimi i projektit është mbështetja e prodhimeve vendase BIO. |
| Rezultatet e pritshme | - Siguri për produktet bujqësore<br>- Çertifikim i produkteve bujqësore<br>- Mbështetje dhe grumbullim i fermerëve vendas<br>- Tregtim dhe promovim i produkteve BIO |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qendrueshmeria e projektit | Zona e Postribës ka një potencial për një produktivitet të madh bazuar në 1040 hektarë tokë bujqësore. Tregu do të ofrojë siguri për fermerët dhe blerësit, në këtë mënyrë incentivohet prodhimi më i madh dhe jetëgjatësia e qëndrës. |
| Aktivitetet e projektit | 12 muaj<br>- Përgatitja e vendit për ngritjen e Tregut<br>- Përgatitja e projektit teknik<br>- Aplikim për Fonde (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave) |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | - |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është ende në fazën e konceptit. Është parashikuar vendi për zhvillimin e projektit gjithësesi duhet të përgatitet projekti i detajuar teknik e më pas të aplikohet për fonde tek FZHR. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | |


Tregu rajonal bio-Postribë

**Projekti nr 18 Tregu lokal Zdrale**

| | |
|---|---|
| Titulli/Emertimi i Projektit | Tregju lokal Zdrale |
| Tipi i Projektit | Zhvillim ekonomik/ Zhvillim Rural |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Shkodër |
| Buxheti total i projektit | Për tu përcaktuar në projektin teknik |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | FZHR<br>Bashkia<br>PPP |
| Pershkrimi i projektit | Shkodra ka një sistem të konsoliduar tregjesh, gjithësesi ato nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Do të promovohet zhvillimi i tregjeve lokale veçanërisht në Shkodër (të paktën nga një treg për Rajon). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Si rrjedhojë në PPV duhet të shoqërohen edhe me hapësira të nevojshme rekreative si bar/kafene/ristorante apo dhe ambulantë ushqimi. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km. Projekti do të zhvillohet në formën e PPP, ku një kontribut të veçantë do të luajnë dhe aktivitetet shtesë të parashikuara në kuadër të tregut. |
| Qellimi dhe objektivat | Qëllimi i projektit është mbështetja e peshkimit dhe akuakulturës.<br>- Siguri për produktet<br>- Rritje e tregtimit të produkteve<br>- Mbështetje ndaj tregtarëve dhe formalizim i sistemit |
| Rezultatet e pritshme | - Krijimi i vendeve të reja të punës në kuadër të Tregut<br>- Mbështetja ndaj tregtarëve<br>- Pastërti dhe siguri ushqimore<br>- Tregu si katalist për zhvillimin e zonës |
| Rendi prioritar | I lartë |
| Qendrueshmeria e projektit | |
| Aktivitetet e projektit | Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë:<br>- Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik)<br>- Rregullim i ambjenteve të tregjeve<br>- Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike<br>- Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është ende në fazën e konceptit. Për këtë është e nevojshme që të përgatiten:<br>f. Studim fizibiliteti<br>g. Projekt Teknik<br>h. VNM |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është në kuadër të strategjisë së Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për ngritjen e tregjeve dhe qëndrave të grumbullimit. Gjithashtu bazohet në hartën e rajonalizimit të produkteve bujqësore dhe përbën një incentivë për zbatimin e kësaj politike. |




**Projekti nr 19 Urbanizimi i Zonës Informale në Rrethina**

| Titulli/Emërtimi i Projektit | Urbanizimi i Zonës Informale në Rrethina |
|---|---|
| Tipi I Projektit | Urbanizim/ Zhvillim Urban |
| Vendndodhja e Projektit | Njësia Administrative Rrethinat. |
| Buxheti total i projektit | Për tu vendosur në projektin e detajuar |
| Kontributi në rastin e bashkë financimit nga Qeveria Vendore | Bashkia Shkodër<br>MZHUT - Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit<br>ALUIZNI - Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale<br>FZHR<br>Agjencia e Zhvillimit Rajonal |
| Përshkrimi I projektit | Me Reformën e Re Administrive (Ligji 115/2014) kjo Bashki ka pësuar një rritje të popullsisë me gati dyfishimin e numrit dhe si pasojë rritjen e nevojave për trajtim të veçantë me politikat e Strehimit Social gjithashtu edhe ato komunitete (komuna) të cilat deri dje nuk ishin pjesë përbërëse e Bashkisë Shkodër.<br>Një ndër to është njësia administrative Rrethinat, e shtrirë në veri të |

| | |
|---|---|
| | kufirit të vjetër të Bashkisë. Kjo njësi administrative, ashtu si edhe proçesi i ndërtimeve informale konfirmon, ka tërhequr për gati 20 vitet e fundit një numër gjithnjë e në rritje të banorëve të rinj, duke arritur në 23 000 banorë (INSTAT 2011). Në rast se do të shohim renditjen nga numëri i banorëve do të vërejmë se njësi administrative Rrethina gjëndet e dyta, krahasuar me Bashkinë e Vjetër Shkodër dhe 9 njësitë administrative të tjera.<br>Përtej këtij përshkrimi të një popullsie më të madhe e të përfshirë, ish komunat paraqiten si një territor me karakteristika tërheqës, si në faktin e ndërlidhjeve sociale (familjare) por edhe ekonomike të lidhura me vendbanimin. Shtrirja e vazhdueshme territoriale përgjatë këtyre viteve, e përbërë gjithnjë nga zmadhimi i këtyre ndërlidhjeve, çoji edhe në një zhvillim urban dhe infrastrukturore të vazhdueshem ndërmjet qytetit Shkodër dhe njësis administrative Rrethina. Sipas Hartës së Kalimit të Pronësisë dy zonat më mëdha të vendbanimive informale shtrihen pikërisht në vazhdimësite veriore të qytetit të Shkodrës (konkretisht zona A dhe zona B) , aty ku edhe nevojat për strehim të gjeneruara në 20 vitet e fundit janë prehur.<br>Ky projekt synon rikualifikimin dhe rigjenerimin e zonës informale duke shtuar infrastrukturën rrugore, infrastrukturën e kanalazimeve, rritjen e hapësirave publike etj. |
| Qëllimi dhe objektivat | - Urbanizimi i Zonës Informale Rrethina për të ofruar një cilësi jetese më të mirë për komunitetet |
| Rezultatet e pritëshme | - Përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës<br>- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit me ujë të pishëm<br>- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me kanalizime<br>- Përmirësimin e hapësirave publike |
| Rendi prioritar | Shumë i Lartë |
| Qëndrueshmëria e projektit | Projekti është i ndërlidhur me një sërë politikash të tjera për përmirësimin e cilësisë urbane në Shkodër |
| Aktivitetet e projektit | **Projekti do të ketë një kohëzgjatje 12 muaj. Mund të zbatohet në faza ose si një i tërë** |
| VleresimiiNdikimit ne Mjedis | - Projekti ka nevojë për hartimin e një VNM dhe VSM |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është në fazë koncepti. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar VKM "Për Zhvillimin e Territorit"<br>PPK |




**Projekti nr 20 Zhvillimi i Qëndrës Multifunksionale Mark Lula**

| **Titulli/Emertimi i Projektit** | **Zhvillimi i Qëndrës Multifunksionale Mark Lula** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Shërbime/ Sociale |
| Vendndodhja e projektit | Shkolla 9-vjeçare Mark Lula |
| Buxheti total I projektit | Për tu përcaktuar në projektin teknik |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | FZHR- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar. |
| Pershkrimi i projektit | Gjatë vizitave në terren dhe intervistave me banorë të ndryshëm të Bashkisë Shkodër, dallohet qartë që në zonë ka një mungesë të theksuar të aktiviteteve, sidomos në periferinë e qytetit. Kjo gjë vjen si rrjedhojë e ambjenteve jo të përshtatshme dhe mungesës të qëndrave kulturore dhe mangësive organizative të aktiviteteve. Ndërkohë, ka një numër të lartë të papunësisë tek të rinjtë, dhe një segregim të lartë të |

| | |
|---|---|
| | grave nga aktivitetet social-kulturore. Gjithashtu, shkolla Mark Lula sapo është ndërtuar dhe ka shumë hapësira të cilat nuk shfrytëzohen. Po ashtu, pas orarit të mësimit shkolla nuk përdoret për qëllime komunitare.<br>Për këtë arsye, projekti synon zhvillimin e një qëndre multifunksionale sociale në lagjen Mark Lula e cila do ti shërbejë të gjithë qytetarëve, por me një fokus të vecantë tek të rinjtë, të rinjtë të gjinisë femërore dhe femrat. Për këtë projekt do të përdoret ndërtesa e shkollës 9-vjeçare e cila duhet fillimisht të plotësohet me disa punime të cilat nuk kanë përfunduar dhe me përshtatjen e disa hapësirave në mënyrë që të akomodojë të gjitha aktivitetet e parashikuara. Qëndra multi-funksionale duhet të ketë, sallë për shfaqje, sallë biblioteke, sallë për muze, salla/klasa të një madhësie më të vogël për trajnime dhe kurse të tilla si muzikë, vizatim/pikturë, IT, zhvillim biznesi etj. Gjithashtu, Shkolla në katin e sipërm mund të ofrojë zyra për shoqata të ndryshme të cilat operojnë në zonë. Terrenet sportive të shkollës mund të përdoren në funksion të të rinjve në komunitet dhe ngritjes së klasave sportive. Gjitashtu, në një pjesë të saj, mund të ngrihet dhe një kopësht por gjithmonë duke garantuar akses të veçantë nga nxënësit e shkollës si dhe ndarje të sigurtë midis grupmoshave. |
| Qellimi dhe objektivat | Rritja e aktiviteteve social-kulturore në zonën Mark Lula<br>Përmirësim i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore në zonën Mark Lula |
| Rezultatet e pritshme | - Banorët e Bashkisë Mark Lula<br>- Rritja e angazhimit të të rinjve në jetën social kulturore<br>- Trajnime dhe mundësi për zhvillimin e kapitalit social<br>- Gjenerim idesh dhe "start-up"<br>- Zhvillim aktivitetesh social kulturore<br>- Mbështetje ndaj grave<br>- Aktivitete sportive për komunitetin |
| Rendi prioritar | |
| Qendrueshmeria e projektit | Projekti është i ndërlidhur me një sërë masash që ndërmerr bashkia. Gjithashtu, projektet e parashikuara në strategjinë ndërtojnë mbi njëri tjetrin dhe janë të ndërlidhur edhe me qëndrën multifunksionale. Bashkia do të ngrejë strukturat administrative për drejtimin e qëndrës multifunksionale si dhe do të akordojë fondet për mirëmbajtjen e saj. |
| Aktivitetet e projektit | Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 5 muajsh. Në të parashikohen:<br>- Përgatitja e projektit teknik<br>- Plotësimi i punimeve<br>- Plotësimi me bazën material<br>- Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është në fazë koncepti. Është e nevojshme që të përgatitet një projekt i detajuar për implementim dhe më pas të gjenden fondet. Gjithashtu, duhen krijuar marrëdhënie me OJF, programe ndërkombëtare, ministri, agjenci në mënyrë që të ngrihen disa marrëveshje të cilat do të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve për drejtimin dhe zhvillimin e aktivteteve në qëndër. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, | |

| | |
|---|---|
| kombetar | |


Stacioni i Trenit
Rruga Rinia
Rruga Beselidhja
Rruga Ded Gjon Luli
Hotel Floga
Rruga Besnik Ceka
Rruga Kole Prela
Rruga Qafa e Bishkazit
Hotel Bicaj
Sheshi Mark Lula
Rruga Gjon Buzuku
Rruga Vllaznimi
Rruga Gjon Buzuku
Google
Imazhet ©2016 CNES / Astrium, Të dhënat e Hartës ©2016 Google




**(**afatet kohore të projekteve janë të përcaktuara në planin e veprimeve. Gjithësesi projektet pilote të paraqitura më sipër duhet të zbatohen brenda dy fazave të para të planit)**

# Kapitulli 6- Monitorimi dhe implementimi

## Monitorimi dhe implementimi

Strategjia Territoriale e Bashkisë Shkodër do të implementohet me anë të projekteve të drejtpërdrejta, parashikimeve në PBA, si dhe parashikimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të rregullores. Në këtë kontekst ngarkohen drejtoritë përkatëse për zbatimin e politikave të Strategjisë. Ndërkohë, në të njëjtën kohë, në mënyrë periodike dhe sistematike duhet bërë monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe të planit. Bazuar në parashikimet ligjore të 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", bashkitë kanë detyrim ligjor të hartojnë një raport vjetor në lidhje me zhvillimin e territorit. Ky raportim duhet të shërbejë dhe për qëllime të brendshme të bashkisë ku në bazë të treguesve të bëhet monitorimi strategjisë dhe planit. Çdo vit, bashkia duhet të masë treguesit e mëposhtëm, dhe çdo tre vjet duhet hartuar një raport i brendshëm në lidhje me zbatimin e strategjisë. Në varësi të rezultateve të monitorimit, mund që më pas të bëhet ndryshimi dhe alternimi i politikave dhe programeve për t'ju përgjigjur dinamikave të reja. Qëllim i monitorimit nuk është vetëm evidentimi i situatës ekzistuese por edhe matja e shkallës së zbatimit të strategjisë.

Për monitorimin e strategjisë do të përdoren 2 lloj indikatorësh. Fillimisht, janë indikatorët e përcaktuar në vkm 671 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" në shtojcën tre të cilat masin ndryshimet në bazë sistemi:

| Sistemi | Indikatorë |
|---|---|
| Sistemi Urban | 1. Sipërfaqja e territorit urban (Stu. të përgjithshme);<br>2. Sipërfaqja e infrastrukturës/banore<br>3. Popullsia (ekzistuese dhe e parashikuar/piramida e popullsisë);<br>4. Strehimi privat/social<br>5. Shërbime administrative;<br>6. Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë;<br>7. Transporti publik dhe privat (nr. makina/ familje)<br>8. Ndarja në zona;<br>9. Sipërfaqet e gjelbra/ banorë dhe sportive/ banorë;<br>10. Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banore; monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore;<br>11. Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare;<br>12. Intensiteti për ha;<br>13. Parkime/banore;<br>14. Indikatorët ekonomikë (GDP / sektorë / lloji bizneseve/çmimet/punësimi/ punësimi për sektor /taksat vendore/borxhi/shpenzimet sipas sektorit);<br>15. Pronat publike dhe private;<br>16. Tendencat e zhvillimit në territor |
| Sistemi Bujqësor | Sip. Territor bujqësor;<br>Sip. Primar (Boniteti I-IV);<br>Sip. Territor Bujqësor Dytësor (Boniteti V-X);<br>Sip. T Bujqësor me sistem ujitjeje;<br>Sip. T Bujqësor pa sistem ujitjeje;<br>Sip. T. Pafryt |

| | |
|---|---|
| Ujor | Ujëra tokësore<br>Ujëra Bregdetare |
| Infrastrukture | Sip. rrugë kombëtare<br>Sip. rrugë interurbane<br>Sip. rrugë urbane parësore<br>Hekurudha<br>Porte Aeroporte<br>Gazdote<br>Elektrodote<br>Ujësjellës-Kanalizime |
| Natyror | Sip. e përgjithshme<br>Sip. pyjore<br>Sip. Kullota<br>Sip. të gjelbra (jo urbane)<br>Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm |

Përtej këtyre indikatorëve janë përcaktuar dhe një sërë indikatorësh në bazë të 5 objektivave strategjike të Strategjisë të Zhvillimit të Territorit:

| **Objektivi** | **Programi** | **Treguesit e monitorimit** |
|---|---|---|
| *Objektivi Strategjik 1 Përmirësimi i Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale* | *Programi Strategjik OS1PS1:* Terminalet Multimodale | Nr Pasagjerë<br>Nr Mjete<br>Nr Biznese pranë terminalit<br>Frekuenca e Udhëtimeve |
| | *Programi Strategjik OS1PS2:* Rregullimi i Portave hyrëse në Shkodër | Projekte të Zbatuara<br>Fluksi i Lëvizjes<br>Nr Aksidente |
| | *Programi Strategjik OS1PS3:* Lidhjet Strategjike Rajonale e Kombëtare | Projekte të Zbatuara<br>Fluksi i Lëvizjes<br>Probleme Trafiku (Pika të zeza) |
| | *Programi Strategjik OS1PS4:* Bashkëpunimi Ndërkufitar | Nr Projekte të Aplikuara<br>Nr Projekte të Zbatuara<br>Nr Aktorë të Angazhuar<br>Shuma e Fondeve të Përftuara |
| **Objektivi Strategjik 2 Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses** | ***Programi Strategjik OS2PS3:*** Qëndrat me një Ndalesë dhe Ngritja e Kapaciteteve Lokale | Nr Qëndra me një Ndalesë<br>Nr staf për qëndër<br>Nr përdorues<br>Nr staf i trajnuar<br>Cilësia e Shërbimit të ofruar<br>Kënaqësia e Qytetarëve nga shërbimi |
| | ***Programi Strategjik OS2PS4:*** Qeverisja Elektronike | Nr funksioneve të shtuara<br>Nr Shërbimeve online<br>Nr përdoruesit online |
| | ***Programi Strategjik OS2PS5:*** Qëndrat Multifunksionale dhe shërbimet Sociale | Nr Projekte të zbatuara<br>Nr Përdorues<br>Cilësia Fizike e ndërtesave |
| ***Objektivi Strategjik 3*** | ***Programi Strategjik OS3PS1*** | Nr I Fermave |

| | | |
|---|---|---|
| ***Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik*** | Zhvillimi Rural | Sip bazë e fermës<br>Nr projekte të zbatuara<br>Fonde për Zh. Rural |
| | ***Programi Strategjik OS3PS3:*** Zhvillimi i Turizmit | Nr. Hoteleri sipas kategorive<br>Nr. Bujtina të Reja<br>Nr. Guida<br>Projekte të zbatuara<br>Nr Vizitorë ditorë<br>Nr Turistë<br>Nr Vizitorë sipas atraksioneve turistike<br>Evente social kulturore të zhvilluara në Shkodër<br>Nr Konferenca dhe Panaire |
| | ***Programi Strategjik OS3PS4:*** Mbështetja e sipërmarrjeve të reja | Nr sipërmarrje të reja në vit<br>Nr sipërmarrje të cilat kanë akses në trajnime<br>Nr sipërmarrje të reja sipas sektorit ekonomik |
| | **Programi Strategjik OS3PS5:** Zhvillimi i Zonave Ekonomike | Nr biznese të reja në zonë ekonomike<br>Sip toke të rigjeneruar<br>Nr punonjës në z.ekonomike<br>Nr. Biznese në zonë ekonomike sipas sektorëve<br>Nr Biznese sipas madhësisë |
| | ***Programi Strategjik OS3PS6:*** Branding i Bashkisë Shkodër | Nr broshura<br>Nr. Turistë<br>Nr. Përdorues të Logo<br>Nr. Spote<br>Publiciteti |
| **Objektivi Strategjik 4 Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban** | ***Programi Strategjik OS4PS1:*** Rikualifikimi i Ballinave Ujore | Vlera e tokës në zonë<br>Vlera e apartamenteve<br>Vlera e qerasë sipas zonës<br>Sip Apartamente boshe<br>Sip Hapësira për shërbime boshe<br>Sip Hapësira tregtare boshe |
| | ***Programi Strategjik OS4PS4:*** Urbanizimi i Zonave Informale | Sip Rrugë të asfatuara<br>Nr Rrugë me mbulim ndricim<br>Sip të mbuluara me kanalizime<br>Nr Banesa me akses në ujë të pishëm<br>Sip hapësira publike<br>Shërbime Publike të ofruara në zonë<br>Nr Biznese aktive në zonë<br>Numeri i Legalizimeve te kryera ne nje vit. |
| | ***Programi Strategjik OS4PS6:*** Përmirësimi dhe Integrimi i | Cilësia e Banesave<br>Nr të punësuar |

| | | |
|---|---|---|
| | Komuniteteve Rome | Hapësira sociale në zonë |
| | ***Program Strategjik OS4 PS7:*** Përmirësimi i qendrave të Njësive Administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban | Nr Projekte të zbatuara |
| | ***Programi Strategjik OS4PS8:*** Hapësirat Publike; Hapësirat Rekreative dhe Sportive | Sip Hapësira Publike<br>Sip Hapësira Rekreative<br>Sip Hapësira Sportive |
| | ***Program Strategjik OS4PS9:*** Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ | Mbulimi me rrjet të ujit të pishëm sipas zonave<br>Mbulimi me kanalizime ujëra të zeza sipas zonave<br>Mbulimi me kanalizime ujëra të bardha sipas zonave |
| | ***Programi Strategjik OS4PS10:*** Strehimi Social dhe i Përballueshëm | Nr të strehuar në vit<br>Nr kërkesa në vit<br>Nr banesa sociale në vit sipas llojit |
| | ***Programi Strategjik OS3PS11:*** Efiçienca Energjitike dhe Energjia e Rinovueshme | Përmirësimi i EE<br>KË të harxhuar në vit<br>KË të prodhuar me energji diellore<br>KË të prodhuar me energji erë |
| | **Programi Strategjik OS4 PS12:** Transporti Publik | Nr autobuzë<br>Nr linja<br>Nr udhëtarë<br>Nr përdorues abone<br>Nr përdorues bileta sipas kategorive<br>% e mbulimit të zonave me transport public |
| | **Programi Strategjik OS3PS13:** Biçikletat | Gjatësia korsi bicikleta urbane<br>Gjatësia korsi bicikleta interurbane<br>Përdorues bicikleta në vit |
| | **Programi Strategjik OS4PS15:** Parkimet | Sip Parkime publike në rrugë<br>Sip Parkime publike<br>Përdorues parkimi public |
| **Objektivi Strategjik 5 Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore** | ***Programi Strategjik OS5PS3:*** Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane | Sasia Ton Mbetje në Lendfill<br>Sasia Ton të kompostuara<br>Sasia Ton sipas kategorisë të ricikluara |
| | ***Programi Strategjik OS5 PS7:*** Menaxhim i pyjeve dhe Kullotave | Sip pyjore<br>Fidanë të mbjellur në vit |

Kjo listë me tregues mund të përditësohet dhe të pasurohet me indikatorë nga bashkia gjatë vitit dhe punës.

# Shtojca 1 – Raport mbi degjesta dhe konsultimet

**Hyrje**

Kjo Shtojcë komunikimi dhe Gjithëpërfshirje vjen si nevojë për të dokumentuar në mënyrë transparent ate cka eshte konsultuar dhe marre ne shqyrtim nga te gjithe ata qe me perkushtim dhe pergjegjshmeri profesionale kane mundesuar arkivimin dhe perpunimin e metejshem te infomacioneve mbi Bashkine Shkoder dhe, duke filluar nga Agjensia Kombetare e Planifikimit, Ministrite e ndryshme (si ajo e Mjedisit), Bashkia Shkoder, Administratore te njesive bashkiake, Drejtore te Agjensive Rajonale dhe Drejtorive Bashkiake, grupe interesi, profesioniste te ndryshem, intelektuale, grupe rinore dhe studentore, dhe banore te ndryshem te bashkise Shkoder te cilet u jane pergjigjur pyetesoreve. Ky dokument, ashtu si edhe indeksi tregon, eshte i ndare ne pese (5) kapituj e qe ne menyre plotesuese reflekton punen dhe vullnetin e te gjithe atyre aktoreve te lartepermendur.

Raport mbi komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të PPV Bashkia Shkodër.

**1.0 Dëgjesat Publike.**
1.1 Dëgjesë Publike për Procesin e Planit dhe gjetjet e analizave
1.2 Dëgjesë Publike për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit për Bashkinë Shkodër.

**2.0 Fokus Grupe.**
2.1 Me Përfaqesues te njesive admnistrative Postribe, Shosh, Shale, Pult.
2.2 Me Perfaqesues te njesive aministrative Velipoje.
2.3 Me Perfaqesues te njesive administrative Dajç, Anë e Malit.
2.4 Me Perfaqesues te qëndrave kulturore, sociale dhe organizatave jo qeveritare te cilat operojne ne zone.

**3.0 Takime me Administratore, Drejtori Lokale/Rajonale dhe Keshill Bashkiak.**
3.1 Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM). – Z. Julian Beqiraj
3.2 "Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" - Keshill Bashkiak
3.3 "Financat Vendore" - Keshill Bashkiak
3.4 Drejtoria mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore. – Z. Ridvan Bushati
3.5 Drejtoria e Basenit “Drin” e “Bune”. – Z. Martin Pellumbi
3.6 Drejtoria e Bujqesise Shkoder. – Z.Fiqiret Xhabiaj
3.7 Drejtoria Rajonale e Mjedisit. - Eduard Terthora

4.0 **Takime Nderkufitare.**
4.1 Takim Ndëkufitare – Shkodër
4.2 Takim Ndërkufitar- Podgorice

**5.0 Komunikimi ne Internet dhe ne Media.**
5.1 Pyetësor Online
5.2 Emision Televiziv 1
5.3 Emision Televiziv 2
5.4 Mbulim i drejtpërdrejtë i dëgjesave publike në media

**Raporti mbi komunikimin dhe pjesmarrjen e qytetareve ne procesin e hartimit te PPV Bashkia Shkoder**

Bazuar në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe në VKM 671 dt 29.27.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", neni 8, pikat 3a, 3c:

> *"Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon një ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi përpara çdo vendimmarrjeje që ka lidhje me planifikimin, dhe i përsërit ato, sipas nevojës, me qëllim informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve."*

dhe

> *"Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, dhe njoftohet së bashku me të nëpërmjet botimit në regjistër dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit"*

Bashkia Shkodër ka ngritur një platformë të hapur dhe transparente komunikimi dhe këshillimi me publikun. Platforma bazohet në disa shtylla komunikimi, e ku grupi i punes se Univeristetit Polis ka qene i pranishem;

- Prezantime të mëdha publike
- Konsulta me grupe interesi
- Fokus Grupe
- Takime me persona të rëndësishëm të cilët kanë dhënë kontribut në Shkodër
- Komunikim me anë të internetit në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe në atë të facebook
- Media audiovizuale

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur të gjithë hapat e ndjekur për këshillimin dhe komunikimin me publikun gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër dhe grupit te punës së hartimit te Planit te Pergjithshem Vendore.

**Dëgjesat Publike**

**Dëgjesë Publike për Procesin e Planit dhe gjetjet e analizave**

Dëgjesa e parë publike mbi gjetjet e procesit te Analizes u zhvillua në dt 15 Mars 2016 në ambientet e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Te pranishëm në këtë Dëgjesë Publike ishin:

Znj. Voltana Ademi – Kryetare e Bashkisë Shkodër, Z. Dritan Meta – Zv. kryetarë i Bashkisë Shkodër, Anetare te Forumit Keshillimore Vendore, sipas dispozitave ligjore (v.k.m 671 date 20.07.2015), Ekperte te Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit (AKPT), Nenpunes te Administrates Publike Vendore e Rajonale, Grupi I punes per Hartimin e Planit Vendor (Polis University, Arizona State University), Ekperte te DLDP dhe AADF, etj. Nje pjese te rendesishme ne kete degjese e zuri edhe Shoqeria Civile, Shoqata te ndryshme, kryesisht ne sektorin e mjedisit, qe veprojne ne Shkoder. Te ftuar te tjere ishin gjithashtu nga organizata dhe grupe interesi te ndryshem por gjithashtu edhe nga bota akademike, si profesore te universitetit "Luigj Gurakuqi", ku dhe u mbajt ky takim. Kjo Degjese Publike, ashtu si edhe dispozitat ligjore percaktojne, eshte shpallur 30 dite perpara saj dhe

eshte transmetuar ne kohe reale si nga kanalet televizive lokale si edhe ata shteterore, nder to permendim: tvsh, startv, abc dhe rozafa tv.
Degjesa Publike u hap ne oren 12:00 dhe fjalimin e pare e mbajti Kryetarja e Bashkise Shkoder, zonja Voltana Ademi, e ftuar nga zv. Kryetari z. Dritan Meta.
Mbas nje falenderimi te ngrohte per te ftuarit e pjesemarresit e tjere per pranine e tyre znj. Ademi nenshtroji disa ceshtje te cilat rendesia e tyre vjen nga Hartimi I planit, si:
a) zhvillimi I nje plani sa me gjitheperfshires ne te miren e interesave te qytetareve te Shkodres,
b) sfidat te cilat plani duhet te konsideroje e qe rrjedhin nga reforma e re administrative dhe nga zgjerimi I kufirit bashkiak, duke konsideruar edhe pikat e forta e shtrirjes se re.
Dy elemente te tjere te cilet znj. Ademi I perkufizoje si sfida te rendesishme te shtrirjes se re territorial jane te lidhura me sektorin bujqesore dhe ate te menaxhimit te situatave te emergjences, si permbytjet te shkaktura nga kryzeqezimi I degeve ujore me ate te liqenit.
Ne mbyllje te fjalimit te saje, e duke garantuar nje vazhdimesi te konsultave me publikun, Kryetarja e Bashkise Shkoder ftoj grupin e punes te universitetit Polis e ate te Arizona State University.
Te paret te cilet filluan ishin 3 perfaqesues te Arizona State University, David Pijaëka, Braden Kay e Michael Umderhill I cili mbajti edhe fjalimin mbi punen e bere.
Ky prezantim u pasqyruar ne dy kapituj, a) njeri i lidhur mbi ngritjen e pyetjeve te cilat grupi i punes i vlereson si sfidat te cilat plani duhet ti marre ne konsiderate, b) dhe e dyta mbi prezantimin e disa shembujve te padeshirueshem te krijuar ne ShBA e qe rasti I Shkodres mund te evitoje, si psh shperhapja urbane dhe problemet qe rrjedhin nga ky fenomen, si menaxhimi i transportit publik apo mbledhja e mbetjeve urbane.
Disa nga sfidat te cilat grupi i punes se Arizona State University ngriti jane te lidhura me: punesimin (inkubatore formimi profesional), dendesine dhe perqendimin e sherbimeve publike, transportin, perfshirjen e shoqerise aktive ne Shkoder ne promovimin e kultures dhe sipermarrjes ushqimore.
Me pas prezantimi I punes se kryer u vijua nga pasqyrimi I ‘Analizes se thelluar te territorit’ dhe ate te ‘Metabolizmit Urban’ ashtu si edhe dispozitat ligjore ne v.k.m 671 date 15.03.2015 ‘Mbi hartimin e PPV-s’.
Per kete grupi i punes se Universitetit Polis shfaqi zbulimet me te reja mbi territorin e ri te Bashkise Shkoder, duke filluar nga skaji me veriore i Republikes se Shqiperise (qe eshte edhe pjese e Bashkise Shkoder) deri ne Velipoje, perfshire qytetin e Shkodres.
Disa nga keto harta te prezantuara ishin:
a) Prezantimi I Planeve te hartuar me pare, si ato te miratuar si edhe ata jo te miratuar (si psh: Plani I Pergjithshem Kombetare, PINS Bregdeti, PPV vjeter Shkoder, EPTISA per zhvillimin e Qarkut Shkoder e Lezhe sebashkuj), b) Hartat e Metabolizmit Ujore, Ushqimore dhe Energjise, c) Sistemi klimaterik, ç) Gjeoinxhenieria, d) Boniteti tokave, dh) Sistemet territorial (zonat e mbrojtura/biodiversiteti), e) Sistemi ujore, ë) Sistemi infrastrukturore, f) Harta periferialitetit etj.
Ne vijim grupi punes se Universitetit Polis pasqyroi nje bashkesi analize mbi tipologjite e vendbanimeve, te ndara ne 8 klasa, si; tipologjia bregdetare, tipologjia rurale-bujqesore, tipologjia suburbane liqenore e lumore, periferike urbane, qyteti, periferike informale, rurale kodrinore, rurale malore. Se fundi analiza urbane per qytetin e Shkodres pershkroji akset kryesore rrugore ne nje hulutim te bazuar ne karakteristikat morfologjike e funksionale, te kateve perdhe e gjithashtu te shesheve 'rruazore' te unazes se brendeshme te qytetit.
Ne mbyllje te prezantimin e te gjetjeve me te reja ne fazen e analizes fjala kaloi te pranishemeve te cilet ndoqen kete prezantim.
Karakteri i ketyre nderhyrjeve ishte si i llojit ‘koment’ por edhe ‘pyetje’. Nder to te shumta ishin komentet te cilat vleresonin nevojen e njohjes se pjeses kulturore te qytetit te Shkodres, te ekzistences se pjeseve historike por gjithashtu edhe territoreve rurale - si bujqesia dhe turizmi i paeksploruar.

Disa nga pyetjet dhe komentet kryesore të ngritura në takim ishin:

- Cili është raporti i komprimisit që duhet të bëjë ky plan në lidhje me të dhënat? Duke qënë se mungon një databazë e integruar e të dhënave në territor? (grupi i punës është duke punuar për ngritjen e një databaze informacioni. Jemi të ndërgjegjshëm që nuk do të jetë e plotë por do të jetë e mjaftueshme për të plotësuar fazën e planifikimit. Nëse presim në pafundësi për të pasur momentin perfekt për të planifikuar nuk do të arrijmë ta bëjmë kurrë)
- Cilat janë afatet e planit? Plani ka një kohëzgjatje 10 vjeçare. Bazuar në termat e kontratës ne si grup pune kemi një afat prej 18 javësh.
- Cilat janë parashikimet për zgjerimet e zonave urbane të Shkodrës? Nuk mund të japim një përgjigje në këtë fazë për parashikimet
- A janë marrë në konsideratë planet e mëparshme të hartuara për Shkodrën? A janë analizuar faktorët të cilat kanë cuar në moszbatimin e tyre? Planet e mëparshme janë marrë në konsideratë. Janë analizuar dhe prej tyre janë nxjerrë konkluzione për elementë të cilat mund të përdoren edhe në këtë plan.
- A duhet të ketë Shkodra një zhvillim policentrik apo monocentrik? Është shumë shpejt për të dhënë një përgjigje mbi këtë gjë. Gjithësesi ne mendojmë që zhvillimi policentrik është i nevojshëm në mënyrë që të garantohet që popullsia qëndron pranë burimeve.
- A janë analizuar avantazhet konkuruese të Bashkisë Shkodër? Po avantazhet konkuruese të bashkisë shkodër janë marrë në konsideratë. Si në aspektet sektoriale ashtu dhe në raport me vendet e tjera në rajon.
- A është marrë në konsideratë fakti i bashkë-jetesës fetare në Bashkinë Shkodër? Po është marrë në konsideratë dhe ne e shohim si një pikë të favorshme për zhvillimin e bashkisë.
- A mund të zhvillohet Shkodra si një qytet port? Në të shkuarën Shkodra ka pasur një port i cili lejonte anijet tregtare deri tek Bexhisteni... Jemi duke e marrë në konsideratë që të ketë një port për qëllime të lëvizjes së turistëve. Por kurrsesi port mallrash.
- A është marrë në konsideratë trashëgimia kulturore dhe çfarë planesh keni ju për të ardhmen në lidhje me këtë çështje? Ne kemi analizuar problematikat në lidhje me trashëgiminë kulturore. Pa dyshim përmirësimi i aksesit dhe promovimit të tyre do të jenë pjesë e planit tonë. Gjithësesi në fazën e strategjisë do të shihen alternativat se si mund të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme në funksion të shoqërisë dhe zhvillimit të turizmit.
- A është marrë në konsideratë trashëgimia natyrore? Çfarë po ndodh me planin e alpeve? Po trashëgimia natyrore është një faktor i rëndësishëm në lidhje me zhvillimin e Shkodrës. Plani i Alpeve është në fazën fillestare. Ne kemi marrë kontakt me studion dhe do të vijojmë më tej bisedimet dhe bashkërendimin.
- A do të rregullohet infrastruktura Shkodër-Velipojë? Gjatë verës është një problem shumë i madh edhe si rrjedhojë e lëvizjeve për qëllime bujqësore në këtë aks... Është një ndër problematikat që kemi evidentuar. Do të shihen alternativat në momentin e hartimit të planit të infrastrukturës rrugore për përmirësimin e këtij aksi.
- Në Velipojë duhet parashikuar një nën-stacion elektrik (Ok do të kryejmë verifikimet për madhësinë e nënstacionit dhe më pas do të parashikohet në plan)
- Duhet të merrni në konsideratë ndërtimin e një miniporti në Pulaj
- Çfarë do të bëhet me titujt e pronësisë? Një pjesë shumë e madhe e territorit nuk kanë tituj pronësie, duke përfshirë zona me interes të madh zhvillimi si Velipoja, Shirokë dhe Zogaj. (është një cështje që shkon përtej planit. Ne gjithësesi do të japim rekomandimet mbi këtë cështje.)

- A do të përfshijë ky plan dhe plane për menaxhimin e territorit? Veçanërisht për zonat pyjore dhe ato bujqësore? (Po ky plan do të përfshijë edhe plane për menaxhimin e territorit)
- A do të koordinoheni me Malin e Zi në lidhje me menaxhimin e liqenit? (Po)
- Universiteti Luigj Gurakuqi ka një softëare të ri në lidhje me transportin dhe ne kemi të dhëna të cilat duam ti vendosim në dispozicionin tuaj
- Duhet që në këtë plan të shihni dhe një rrugë alternative për lidhjen me kosovën (Është kopetence kombetare, gjithësesi ne do te mundohemi te japim nje variant tonin)
- Duhet që në këtë plan të hartoni dhe një strategji në lidhje me ujrat dhe përmbytjet duke qënë se është një problem shumë serioz për Bashkinë Shkodër. (e kemi ne konsiderate per te hartuar nje set masash per nderhyrje)
- Ujësjellësi i Dobracit është mbuluar me zhvillime informale. Kanë kaluar zonën e rreptësisë së puseve dhe kjo kthehet në një problem për cilësinë e ujit (eshte nje problematike qe kemi evidentuar edhe ne. Do te shihet alternativa per zgjidhje te problemit ne fazen e hartimit te planit te detajuar)
- A është marrë në konsideratë plani i EPTIZËS? Po eshte marre ne konsiderate

Persa i takon pyetjve ato u drejtuan qofte mbi analizen aktuale qofte mbi pritshmerite e planit - nese do te kete nje zhvillim monocetrik apo policentrik, apo mbi bypass-in perendimore aktual dhe e ardhmja e tij.


PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA SHKODËR

Z./Znj.______________

Kemi kënaqësinë t'ju ftojmë në dëgjesën publike, mbi ecurinë e procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër.

**Data:** 15 Mars, 2016
**Adresa:**
*Salla e Konferencave, pranë Rektoratit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër*

Programi:

12:00 - 12:10
Hapja e dëgjesës publike, fjalë përshëndetëse nga Znj. Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër

12:10 - 12:15
Përshkrim i procesit të hartimit të PPV nga Prof. Besnik Aliaj, Rektor i Universitetit POLIS

12:15 - 12:25
Eksperienca ndërkombëtare dhe raste studimore nga Braden Kay, Arizona State University

12:25 - 13:00
Analizat e territorit të Bashkisë Shkodër dhe gjetjet kryesore nga Ledian Bregasi dhe Ledio Allkja, Universitetit POLIS

13:30 - 14:00
Komente, pyetje dhe përgjigje

AKPT
POLIS
MetroPOLIS
ASU Arizona State University



*(Shkoder, 15 Mars 2016)*

**Dëgjesë Publike për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit për Bashkinë Shkodër**

Dëgjesa e dytë publike u zhvillua në dt 27 Prill 2016 në ambjentet e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Te pranishëm në këtë Dëgjesë Publike ishin:

Znj. Voltana Ademi – Kryetare e Bashkisë Shkodër, Z. Dritan Meta – Zv. kryetarë i Bashkisë Shkodër, Anetare te Forumit Keshillimore Vendore, sipas dispozitave ligjore (v.k.m 671 date 20.07.2015), Ekperte te Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit (AKPT), Nenpunes te Administrates Publike Vendore e Rajonale, Grupi i punes per Hartimin e Planit Vendor (Polis University, Arizona State University), Ekperte te DLDP dhe AADF, qytetare te ndryshem e shume te tjere. Te ftuar te tjere ishin gjithashtu nga organizata dhe grupe interesi te ndryshem por gjithashtu edhe nga bota akademike, si profesore te universitetit "Luigj Gurakuqi", ku dhe u mbajt ky takim.

Znj. Voltana Ademi ne fjalimin e hapjes se Degjeses Publike nenvizoje rendesine e Hartimit te ketij Plani si nje domosdoshmeri qe vjen fill pas Reformes Territoriale. Ne kete domosdoshmeri Ajo parashtroji nevojen e nje vizioni dhe te nje shtrirje sa me horizontale ne territorin e ri te Bashkise Shkoder – per te qene me afer komuniteteve dhe qytetareve. Nje rendesi te vecante Ajo i dha edhe

nevojes per nje zhvillim sa me ekologjik, qe respekton natyren dhe qe ve ne levizje ato potenciale natyrore, turistike dhe ekonomike kaq te rendesishme per banoret ne zonat me rurale te Bashkise. Ballinat ujore, jane nje pjese e integruar e ketij zhvillimi me karakter ekonomik dhe turistik, por gjithashtu edhe ne cilesine e jeteses per ato banore te cilet i jetojne keto hapesira – si urbane por edhe rurale. Inovacioni teknologjik, dhe aksesueshmeria ne portalet e sherbimeve publike jane dhe do te mbeten nje nga prioritet per Bashkine Shkoder dhe hartimin e ketij plani.
Ne mbyllje te fjalimit te saj, Znj. Voltana Ademi kryetare e Bashkise Shkoder, ftoji grupin e Universiteti Polis per te prezantuar ‘Hartimin e Strategjise se Zhvillimit’.
Ne prezantimin e Strategjise se Zhvillimit kater (4) ishin kolonat kryesore te cilat u shtri hartimi i ketij plani strategjik:

1. Roli rajonal i Bashkise Shkoder me bashkite kufitare dhe shtetet fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova, ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***
***a. te Nxisë kohezionin territorial nëpërmjet zhvillimit të balancuar ekonomik e social të rajoneve dhe përmirësimin e konkurrencës.***

2. Forcimi i brendeshem ne Bashkine Shkoder, persa i perket levizjes dhe sherbimeve, ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***
***b. të Përkrah zhvillimin e gjeneruar nga funksionet urbane mixe dhe përmirësoje marrëdhënien mes zonave urbane dhe zonave rurale,***
***c. te Promovojë aksesibilitet, dhe***
***d. te Rrise aksesin në njohuri dhe informacion.***

3. Mjedisi dhe zhvillimi i tij ne menyre sa me ekologjike dhe te nderthurur me sistemin natyrore (si pjese e integruar e problematikave te nderlidhura me emergjencat natyrore), ***në përputhje me Qëllimet e Hartimit të P.P.K (Planit të Përgjithshëm Kombëtar), në pikat e mëposhtëme:***
***e. te Reduktojë dëmet mjedisore,***
***f. te mbroje dhe përforcojë resurset natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.***

4. Cilesia e jeteses e lidhur me a. **sherbimet** dhe b. **rikreativitetin/ vlerat natyrore**, ne perputhje me Axhenden Evropiane te Territorit 2020, Strategjia Evropa 2020 ,Vizionin Territorial i Evropës 2050 dhe Planit te Pergjitheshme Kombetare. Keto dokumente synojne te orientojne zhvillimin hapësinor (policentrizmin përkundrejt pabarazive hapësinore), dhe të garantojnë akses të njëjtë rajonal per njerëzit, në infrastrukturë dhe ne njohuri, ne menyre qe banoret lokale te menaxhojnë burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore në mënyrë të zgjuar e në funksion të ripërtëritjes (resilience). Ne perputhje me Udhezimet dhe Rekomandimet e mesiperme vizioni strategjik perkrah dhe i bashkengjitet konceptit te policentrizmit te shtire ne polet e vendbanimeve te komunave te vjetra, dhe orienton zhvillimin e bypass-it perendimore si barriere natyrore dhe zhvillimi i ketij territori si zone rikreative per banoret.
Nje pergjigje e vecante e ne kete faze ju dha edhe atyre shqetesimeve e komenteve te ngritura ne prezantimin e Analizave nga degjuesit, si e ardhmja e bypassi-it perendimore dhe zhvillimi Policentrik vs. Monocetrik. **Rritja e sherbimeve** ne shkalle Bashkie dhe **Perforecimi i vlerave natyrore** ishte edhe strategjia e propozuar ndaj problematikave te gjeneruara nga Reforma Territoriale, nga rreziqet natyrore, dhe nevojave ne rritje per nje nivel jetese me te larte jo vetem ne ish komunat e vjetra por edhe ne qytet.
Ne mbyllje te prezantimit fjala kaloi te pranishemeve te cilet ndoqen kete prezantim. Karakteri i ketyre nderhyrjeve ishte si i llojit ‘koment’ por edhe ‘pyetje’. Nder to te shumta ishin komentet qe

sygjeroin nje shtrirje sa me te gjere te sherbimeve administrative me rol ekonomik, social dhe gjitheperfshires ne qeverisjen vendore.


PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA SHKODËR

**Prezantimi i Vizionit dhe Strategjisë së Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Shkodër.**

Z/Znj.__________



*(Shkoder, 27 Prill 2016)*

Pyetjet dhe komentet e ngritura në këtë takim:

1. Strategjia ka nevojë që të ketë disa prioritete të qarta, dy-tre, në mënyrë që më pas dhe politikat dhe programet te cilat ju keni ngritur të jenë të koordinuara dhe të harmonizuara. Përshembull prioriteti ekologjik- do të bënte që edhe projektet të fokusoheshin me një pikëpamje sa më miqësore ndaj mjedisit. (Po shumë e drejtë. Ne nuk mund të përcaktojmë prioritete për ju. Prandaj zhvillohen dëgjesat publike. Gjithësesi do të reflektohet në dokumentin e strategjisë: tre prioritete Shkodra e Gjelbër (Green and Resilient); Shkodra Smart; Shkodra e Jetueshme;)
2. Nuk jam shumë e sigurtë përsa i përket propozimit tuaj për by-pass lindor. Duke llogaritur që unaza ka vetëm pak kohë që ka përfunduar dhe nuk ka hyrë ende në efiçiencë të plotë mendoj se mund të ishte një shpenzim i tepërt i cili do të shtonte qarkullimin e makinave. (Plani hartohet për një periudhë 10-15 vjeçare. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të parashikohen infrastruktura të cilat i kalojnë problematikat afatshkurtër. By-pass lindor do të jetë në dy faza, e para e cila e lidh me unazën ekzistuese, dhe e dyta e cilat kalon përtej qytetit Shkodër dhe lidhet në Shtoj me aksin Shkodër-Koplik. Gjithashtu, bypass është i nevojshëm edhe si rrjedhojë e PPK e cila parashikon si aks prioritar Han i Hotit-Shkodër. Në këtë kontekst duhet një devijim i trafikut jashtë qytetit. Bypass lindor është një zgjidhje më ekologjike dhe më e mirë për qytetin sesa ai perëndimor. )
3. A është marrë në konsideratë plani EPTISA? Përse duhen hartuar plane çdo dy vjet? A garanton afati juaj kohor që nuk do të kemi një plan të nxituar i cili do të krijojë probleme në zbatim? (Po, Plani EPTISA është marrë në konsideratë. Ky plan vjen edhe si rrjedhojë e reformës territoriale, e cila tashmë ka ndryshuar totalisht territorin e bashkisë Shkodër. Nevojitet një vizion i përgjithshëm për bashkinë. Ne jemi të ndërgjegjshëm për afatet kohore. Ato janë të përcaktuara me VKM nga qeveria qëndrore e cila është dhe financuese e tyre. Gjithësesi, ne do të bëjmë maksimumin për të kapur afatet kohore pa kompromentuar

cilësinë. Nëse e shohim të arsyeshme do të kërkojmë dhe një shtyrje të planit. Deri tani kemi qënë në kohë me të gjitha kërkesat ligjore dhe kontraktuale.)

4. Mendoj se është e rëndësishme që të zhvillohet peshkimi në liqen. Nëse shohim Malin e Zi e kanë shumë të zhvilluar këtë sektor. (Po shumë e drejtë. Për këtë është parashikuar edhe programi strategjik për zhvillimin e akuakulturës)
5. Mendoj që propozimi juaj për By-Pass Lindor është shumë i mirë. By-pass perëndimor është një dëm ekologjik dhe peizazhistik i qytetit të Shkodrës.
6. Projekti i pazarit të vjetër nuk është bërë siç duhet. Është shumë kitç. A keni menduar për të bërë një projekt të ri për këtë zonë? (Ne e kemi përfshirë edhe Bexhistenin si pjesë e programit për rigjenerimin e Ballinave Ujore. Në këtë kontekst do të jetë pjesë e një masterplani më të detajuar i cili do të saktësojë dhe ndryshimet që mund të ndodhin me këtë zonë. Në këtë faze është shumë e vështirë të japim një përgjigje të detajuar se si do të duket më vonë. Ne e shohim si pjesë të integruar me ballinën ujore)
7. Mendoj se ½ e Bashkisë Shkodër mund të zhvillohet me anë të konceptit të turizmit të qëndrueshëm. Këto përjashtoj Velipojën e cila është qëndër turizmi masiv dhe 10-fishohet gjatë periudhës së verës. (Ne kemi parashikuar zhvillimin e ekoturizmit dhe agriturizmit në pjesën e njësive administrative postribë/ Gur i Zi/ Shosh/ Shalë/ Pult. Gjithashtu dhe si koncept i integruar me agroturizmin në njësitë e nënshkodrës.)
8. Mendoj se duhet të shtoni disa pika të tjera në itineraret tuaja turistike:
    a. Gjeokompleksiteti i Shkodrës
    b. Artizanatin si një degë me potencial ekonomik dhe me potencial turistik
    c. Kultura dhe zonat arkeologjike (komentet tuaja do të merren parasysh dhe do të reflektohen në strategji. Gjithësesi në këtë fazë më shumë jepet koncepti, janë projektet ato të cilat saktësojnë edhe itineraret)
9. Liqeni i Shkodrës duhet të ketë një trajtim shumë të kujdesshëm pasi vërehet eutrofikimi i tij. (Po është pjesë e politikave tona për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu në konsultime me palën malazeze kemi rënë dakord që duhet shumë më shumë ndërveprim. Një ndërhyrje do të jetë ndalimi i të gjitha derdhjeve të ujërave të zeza në liqen. Ndërkohë në plan do të ketë dhe masa më të detajuara se në strategji përsa i përket kësaj ceshtje.)
10. Zefjana është një zonë jashtë Bashkisë Shkodër të cilin duhet ta shihni me prioritet për të propozuar një fabrikë tullash (ok, është jashtë kompetencave tona. Hapja e fabrikës së tullave vjen si kërkesë e privatit, është pak e vështirë që ta përcaktojmë ne. Ajo që mund të bëjmë është që të parashikojmë një zonë industriale/ekonomike në momentin e hartimit të planit të përdorimit të tokës.)
11. Përse hidhen poshtë planet dhe hartohen plane të reja çdo dy vjet? A nuk është shpenzim parash? Kush garanton që ky plan nuk duhet hartuar sërish? (Reforma territoriale dhe ndryshimet ligjore në planifikimin e territorit kanë shkaktuar këtë konfuzion. Ne jemi të angazhuar maksimalisht për të dorëzuar një produkt cilësor. Kemi dhe angazhimin e bashkisë përsa i përket zbatimit të këtij plani)
12. Duhet të shihni mundësinë e ndërtimit të një porti dhe disa pontileve në Bashkinë Shkodër (Po është marrë në konsideratë)
13. Është e rëndësishme që të shpreheni për parkimet (po janë marrë në konsideratë, janë reflektuar tek raporti)
14. Zhvillimi ekonomik, duhet të krijohen inkubatorë për sipërmarrjet e reja (po është marrë në konsideratë, është reflektuar tek raporti)
15. Duhet që Shkodra të ketë një aeroport sezonal. Është një fushë e vjetër fluturimi e cila mund të përdoret (qëllimi nuk justifikon shpenzimin. Kemi tre aerporte shumë pranë si Podgorica, Ulqin dhe Aeroporti i Rinas. Gjithashtu fusha që ju thoni tashmë nuk ka asgjë të ngjashme

me një fushë për aeroport, vetëm emri i ka mbetur, është kthyer në një pikë depozitimi inertesh)
16. Duhet të parashikoni kurrën e gjelbër të Shkodrës dhe pyllëzime në tarabosh (po është e parashikuar)
17. Çfarë parashikimesh keni për Rrjollin? (zonë turistike elitare me impakt sa më të vogël në mjedis dhe në natyrë)
18. Çfarë do të ndodhë me ujërat e zeza ? (është parashikuar qëndra e trajtimit të ujërave të zeza)
19. Çfarë do të bëni për përmbytjet?(është pjesë e masave të cilat do të rekomandohen në plan gjatë fazës tjetër. Gjithësesi nuk mund të japë plani i shkodrës zgjidhjen përfundimtare. Është një kombinim me institucione të tjera përtej shkodrës.)
20. Duhet mbështetur zejtaria. Është premtuar në fushatë ngritja e një qëndre panairesh tek bexhisteni? (po shumë e drejtë)
21. Gjatë hartimit të planit të kaluar, është parashikuar ndërtimi i një terminali ndërkombëtar tek pika 2.5, pranë bypass lindor. Është zgjidhja optimale për Bashkinë Shkodër. (Ai stacion është në një zonë të urbanizuar dhe banimi. Do të shtonte trafikun. Propozojmë rigjenerimin e stacionit të trenit për të promovuar dhe infrastrukturën hekurudhore)

## Fokus Grupe

**2.1 Fokus Grup 1-** përfaqësues të njësive administrative Postribë, Shosh, Shalë, Pult. Takimi u zhvillua në njësinë administrative Postribë më 21 Mars 2016.
Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave ( 15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill) si pjese e degjesave e konsultimeve e me nevojat lokale te komunave te reja te Bashkise Shkoder, qe tashme jane ndarje administrative te te njejtes bashki. Ne kete takim grupi i punes se Universitetit Polis prezantoji analizat e realizuara dhe te punuara per degjesen e pare te kesaj faze te leximit te territorit te ri bashkiak.
Ne kete takim ishin te pranishëm, zv. Kryetari i Bashkise Shkoder Z. Arben Gjuraj, perfaqesues te njesive administrive dhe anetare te tjera te Bashkise Shkoder sebashku me banore te zones dhe mesues te profileve te ndryshme.
Ne kete takim tre ishin drejtimet te cilat keto komunitete ngriten arsyetimet e tyre te nevojshmerise per te trajtuar ne Planin e Pergjithshem Vendore: a) Arsimi, dhe b) Menaxhimii pyjeve dhe bujqesia. C) zhvillimi rural.
Persa i takon arsimit nevojat u shtruan si domosdoshmeri e rritjes se aksesisit ne shkolla dhe situata e ofrimi i hapesirave te nevojshme per mesimdhenie.
Persa i takon menaxhimit te pyjeve dhe bujqesise, banoret e ngriten nevojen e pikave te grumbullimit bujqesore dhe atij pyjore per te pasur mundesine e tregetimit te ketyre produkteve. Nje element tjeter, por jo me pak i rendesishem, ishte edhe ai i ngritur nga perfaqesues te njesive administrative me veriore te bashkise Shkoder – si bashkimi ne akse rrugore e kufitare me Malin e Zi dhe Kosoven, per te afruar keto vendbanime sa me afer me qendrat shqipfolese.
Komentet kryesore:
1. Lidhja me Kosovën nga Drisht dhe Prekal
2. Rajone Historike të Kushtëzuar nga Basenet Ujore
3. Infrastruktura rrugore problematike (janë 40 fshatra dhe nga këto vetëm 10 të lidhura me rrugë)
4. Ka disa kështjella të cilat duhet të merren në konsideratë për itinerare turistike
5. E nevojshem qëndra e informacionit dhe përgatitja e guidave

6. Duhet të ketë projekte për energjinë elektrike duke promovuar mullinjtë me erë si dhe mullinjtë e vegjël të cilët funksionojnë me ujë
7. Promovimi i Ushqimeve BIO shihet si një potencial i rëndësishëm për këtë zonë, madje mund të ketë një projekt përsa i përket tregut të produkteve BIO
8. Mbetjet Urbane mbeten një problem. Nuk qëndron problematika tek sasia e gjeneruar por tek edukimi i qytetarëve për të mos i hedhur ato në lumenj
9. Parku i thethit duhet 3-fishuar
10. Shkolla e mesme Mes+Dragoç ka nevojë për shtim ambjentesh. Gjithashtu e nevojshme është dhe shtimi i fondeve për mirëmbajtjen
11. Është e rëndësishme të ketë një projekt përsa i përket terreneve sportive
12. Pylli i Gështenjave është një potencial i mirë për zhvillimin e zonës. Janë 4000 hektarë gështenja të cilat nuk shfrytëzohen. Duhet parashikuar një qëndër grumbullimi gështenjash
13. Është e nevojshme të promovohet agro-përpunimi pasi është një nga mënyrat për të rritur vlerën e produkteve vendase
14. Është një zonë shumë e favorshme për turizmin sidomos për turizmin malor dhe ekologjik
15. Është e nevojshme një qëndër grumbullimi për bimët medicinale
16. Duhen mbështetur produktet tradicionale si qepa, pjepri dhe perimet
17. Shkollat duhen pajisur me laborator dhe palestër
18. Është i nevojshëm rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Theth dhe rritja e sigurisë rrugore në këtë aks
19. Është e nevojshme ruajtja e arkitekturës tradicionale e cila është duke humbur gjatë kësaj periudhe
20. Duhen rritur potencialet për gjenerim të ardhurash. E shoh të domosdoshëm një treg rajonal dhe një qëndër kooperative/grumbullimi për gështenja dhe bimë medicinale
21. Është e nevojshme të hartohen plane për menaxhimin e pyjeve
22. Kooperativat blegtorale janë një mundësi e mirë për zonën
23. Pyjet duhet të përdoren përmes shoqatave të pyjeve



(Postribe, 21 Mars 2016)

**2.2 Fokus Grup 2-** përfaqësues të njësive administrative Velipojë. Takimi u realizua me 21 Mars 2016

Takimi u zhvillua ne njesine administrative Velipoje me 21 Mars 2016.
Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave ( 15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill) si pjese e degjesave e konsultimeve me nevojat lokale te komunave te reja te Bashkise Shkoder, qe tashme jane ndarje administrative te te njejtes bashki. Ne kete takim grupi i punes se Universitetit

Polis prezantoji analizat e realizuara dhe te punuara per degjesen e pare te kesaj faze te leximit te territorit te ri bashkiak.
Disa nga argumentet e shqyrtuar ne kete takim ishte e lidhur me sektorin e turizmit dhe te mirat ekonomike te cilat rrjedhin nga zhvillimi i metejshem i ketij sektori si nje burim te ardhurash te qendrushme per banoret e ish komunes Velipoje.
Disa nga problemet e ngritura ne kete takim nga banoret ishin te lidhur me potencialin turistik qe njesia administrative Velipoje ofron si;
a. rrjeti infrastrukturore i pamjaftueshem per te perballuar fluksin turistik gjate pushimimeve verore. Shpesh here, sipas komenteve te pranishmeve, ky rrjet i fluksit turistik (Shkoder - Velipoje) ndeshet ne te njetin segment me fluksin e praktikave ditore (kryesisht ne sektorin e bujqesise) te banoreve ne fshatrat qe kjo rruge pershkron - duke u kthyer ne burim aksidentesh dhe humbje ne sektorin e turizmit**. Nevoja per krijimin e disa segmenteve lidhes nga Velipoja me Shkodren (per funksione dhe fluks te ndryshem) dhe me aksin kryesore Lezhe - Shkoder ne hyrje te njesise adminsitrative Berdice, perbenin argumentin dominues dhe me karakter propozues te banoreve te zones.**
dhe b. **roli turistik i Velipojes ne shkalle rajonale, perkrah Shengjini-t dhe Ulqinit.**

Komentet e Takimit:

1. Rruga e amortizuar dhe trafiku që krijohet gjatë verës. Gjithashtu përdorimi i rrugës kryesore edhe për qëllime bujqësore ngadalëson trafikun. Duhet një degëzim ose një rrugë bujqësore e re
2. Duhet përmirësuar lidhja me Shëngjinin nga Rrjolli
3. Duhet të shihet mundësia për krijimin e një Porti të vogël në Pulaj
4. Duhet parë mundësia e përdorimit të Diellit për prodhimin e energjisë
5. Laguna e Mortenës është një potencial i rëndësishëm natyror i cili duhet mbrojtur
6. Problematikë shumë e madhe e zonës është e lidhur me titujt e pronësisë. Mungojnë certifikatat e pronësisë
7. Duhet parë mundësia e hapjes së një dege profesionale për turizmin
8. Duhet parë mundësia e një depo grumbullimi të produkteve bujqësore
9. Duhet kufizuar patjetër shpërhapja urbane në dëm të tokës bujqësore
10. Duhet parashikuar rruga Ulqin-Velipojë-Shëngjin
11. Duhen ndërtuar disa parqe lokale në Velipojë
12. Duhen ndërtuar tregje urbane në velipojë gjatë verës
13. Lartësia e ndërtesave në brezin bregdetar duhet kufizuar
14. Dokumentat e pronësisë janë shumë problem në zonën e plazhit
15. Kanalizimet. Është bërë qëndra e trajtimit por nuk janë lidhur me ndërtesat
16. Trotuaret duhet të parashikohen për secilën rrugë
17. Sinjalistika rrugore
18. Parking në qëndër të velipojës
19. Duhen pastruar kanalet e kullimit dhe riparuar hidrovoret
20. Duhen parashikuar korsitë e emergjencave. Janë shumë të nevojshme gjatë verës
21. Nënstacioni i velipojës duhet parashikuar
22. Grumbullimi i mbetjeve



(Velipoje, 21 Mars 2016)

**2.3 Fokus Grup 3-** përfaqësues të njësive administrative Dajç, Anë e Malit.

Takimi u zhvillua ne njesine administrative Dajç me 21 Mars 2016.
Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave ( 15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill) si pjese e degjesave e konsultimeve me nevojat lokale te komunave te reja te Bashkise Shkoder, qe tashme jane ndarje administrative te te njejtes bashki. Ne kete takim grupi i punes se Universitetit Polis prezantoji analizat e realizuara dhe te punuara per degjesen e pare te kesaj faze te leximit te territorit te ri bashkiak.
Disa nga argumentet e shqyrtuar ne kete takim ishte e lidhur me menaxhimin e resurseve natyrore dhe hidrike ne dobi te sektorit te bujqesise dhe tregtimit te produkteve lokale, por gjithashtu edhe te sektorit te ecoturizmit.
**Mirembajtja e kanaleve vaditese e kulluese, mbrojtja nga permbytjet e tokes bujqesore, dhe mundesia per te tregtuar produktet (afersia nga nyje infrastrukturore kryesore ne shkalle rajonale), ishin disa nga problematikat e nevojat e shprehura ne kete fokus grup.**



(Dajç, 21 Mars 2016)

Komentet e këtij takimi:

1. Turizmi Kulturor duhet parë si potencial në zonën e anës së Malit
2. Qëllimi i planit duhet të jetë që të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve të zonës
3. Fluksi i lëvizjeve është shumë i madh. Duhet të ketë një rrugë dytësore nga bërdica në Velipojë

4. Duhet të krijohen lidhjet e prodhuesve vendas me prodhues të tjerë jashtë vendit
5. Është shumë e rëndësishme që të përmirësohet lidhja e fshatrave periferike me bashkinë qëndër
6. Është i rëndësishëm rehabilitimi i ujësjellësave në zonën e Anës së malit
7. Pastrimi i Prrenjve dhe i kanaleve kulluese duhet të kryhet në mënyrë periodike pasi janë burim përmbytjesh
8. Qëndra e njësisë duhet rregulluar. Gjithashtu qëndrat e fshatrave/ sheshet kryesore duhen rregulluar
9. Ana e Malit është portë hyrëse e Shqipërisë! Duhet rregulluar rruga dhe estetika e saj
10. Zona e nënshkodrës shquhet për prodhimin e perimeve. Duhet të ketë disa pika grumbullimi
11. Sherebela zhvillohet natyrale në Tarabosh. Duhet promovuar si produkt autentik dhe bio
12. Është e nevojshme që nga ura e bahcallëkut deri në bërdicë të konsiderohet si një hapësirë për shëtitore gjatë Drinit. Të ketë një korsi për këmbësorë dhe bicikleta
13. Zona buzë lumi duhet të parashikohet për argëtim
14. Është i rëndësishëm një terminal transporti në Bërdicë
15. Siguria rrugore është shumë e dobët. Duhet rregulluar sinjalistika
16. Harku i Bërdicës ka nevojë të ketë një zgjidhje për trafikun. Burim aksidentesh dhe trafiku gjatë verës

**2.4 Fokus Grup 4-** takim me përfaqësues të organizatave jo qeveritare të cilat operojnë në zonë.

Në këtë takim kishte dhe përfaqësues të institucioneve kulturore në Shkodër si drejtuesit e muzeve. Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave ( 15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill). Ne kete takim grupi i punes se Universitetit Polis prezantoji analizat e realizuara dhe te punuara per degjesen e pare te kesaj faze te leximit te territorit te ri bashkiak dhe diskutoji mbi nevojat te cilat plani i pergjithshem vendore mund te plotesoje ne menyre qe Shkodra te kete nje vizibilitet turistik me te larte dhe nje nivel kulturore produktiv ne shkalle kombetare dhe ndekombetare.
Te shumta ishin edhe propozimet - nder to ishte edhe ai i Bibliotekes se Qytetit per te shtrire sherbimin e saj edhe ne rrjete kulturore te kohes se lire dhe mesimore.



(Salla e Keshillit Bashkiak Shkoder, 22 Mars)

Komentet e takimit:

1. Kalaja e Shkodrës është e rrethuar nga ndërtimet. Duhet të shihet mundësia që ato të strukturohen e rregullohen ose në disa raste të zhvendosen

2. Sinjalistika kafe (objekteve kulturore) duhet të jetë një prioritet për bashkinë
3. Shkodra është një qytet muze, duhet të ketë një përqasje të integruar të turizmit kulturor. Duhet një qëndër informacioni
4. Aksesi në Kalanë e Shkodrës për autobuza është shumë problematik. Duhet parashikuar një zonë shërbimi ku parkimi të kombinohet me shitjen e suvenirëve.
5. Zona e liqenit është shumë problematike për ndotjen nga derdhja e ujërave të zeza
6. Cfare do të bëni me komunitetin rom pas urës së Bunës? Mendoj që duhet ti trajtoni në mënyrë për ti integruar me qytetin. Duhen përmirësuar kushtet e jetesës
7. Duhet zgjeruar rrjeti i bibliotekës edhe në shkolla. Duhet parë mundësia e dixhitalizimit të bibliotekës. Gjithashtu gjatë verës mund të zhvillohet bibliobus në zonat turistike. Gjithashtu ka nevojë për shtim hapësire.
8. Lulishtet janë të mbyllura dhe të rrethuara
9. Parkingjet në qytet duhen parë me prioritet
10. Duhet një hapësirë për jetën e natës
11. Disa shkolla janë të nënshfrytëzuara. Duhet parë mundësia për ti përdorur edhe si hapësira multifunksionale
12. Duhen hartuar projekte edhe në funksion të njerëzve me aftësi të kufizuara
13. Duhen zhvilluar më shumë aktivitete social kulturoe
14. Duhen një zyrë e mirëfilltë për koordinimin e projekteve me OJQ

**2.5 Fokus Grup 5-** takim me përfaqësues të rinjve të Shkodrës i zhvilluar tek Qëndra Rinore Arka.

Në këtë takim kishte përfaqësues të shoqatave kulturore në Shkodër dhe me te rinj te ndryshem. Ky takim u zhvillua ndermjet Prezantimit te Analizave ( 15 Mars) dhe Hartimit te Strategjive (27 Prill).
Ne kete takim te hapur ndaj qytetareve shkodrene u diskutuan tre tematika; a) Jeta nates, b) sipermarrja, c) universiteti.
Komentet e para te cilat u shprehen nga te pranishmit kishin te benin pikerisht me jeten kulturore, muzikore dhe artsike per nje qytet qe di te shijoje ne menyre qytetare jeten e nates.
Sipermarrja, kryesisht per te rinjte, ishte nje nga temat tjera te cilat u ngriten ne kete takim.
Zhvillimi i nje kampusi universitare, me sherbime te ndryshme, ishte nje nga kerkesat e vecanta te cilat degjuesit ja adresuan planit.



(Qendra Rinore Arka, 26 Mars)

Komentet e marra në këtë takim
1. Duhet të shihni të dhënat në open street map. Ju ndihmon në përditësimin e të dhënave

2. Duhet të rritet kontrolli publik i shpenzimeve dhe transparenca ndaj publikut
3. Duhet një zonë për jetë nate duke qënë se shkodra ka shumë të rinj dhe është qytet studentor
4. Shkodra si qytet studentor. Duhet parë mundësia e hapjes së një dege arti. Gjithashtu nuk ka nevojë për një kampus universitar. Banesat për studentë le të jenë të shpërndara në qytet. Ndërkohë të parashikohen zgjerime për universitetin.
5. Duhet një sallë për aktivitete social kulturore për të rinjtë
6. Duhet të zhvillohen sportet ujore
7. Duhet të ketë një hapje të institucioneve publike edhe në zona të tjera përtej qëndrës së qytetit
8. Shumë e rëndësishme hapja e qëndrave me një ndalesë

1. **Takime me Administratore, Drejtori Lokale/Rajonale.**

### 3.1 Drejtoria e Pergjithshme e Mjedisit (MM). – Z. Julian Beqiraj / Sulejman Xhepa/ Silvanka Alshabani

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e territoreve te rendesise kombetare ne Bashkine e re Shkoder. Ne kete takim u fol mbi menaxhimin e zonave te mbrojtura dhe kryesisht mbi problematikat mjedisore te liqenit te Shkodres. Niveli i larte i metaleve te renda ishte nje nga problematikat e ngritura persa i takon ketij territori liqenore. Studimi i faktoreve ndotes, perfishire bashkepunimin me Malin e Zi, do te çonte ne orientim me te sakte te nderhyrjeve qe duhen marre ne shkalle kombetare se pari e ma pas ate lokale.
**Së fundi u fol për kurorën malore të Alpeve dhe potencialin turistik që ka kjo zonë veriore e Bashkisë Shkodër ka, ndaj edhe mbrojtja dhe promovimi i vlerave natyrore, të biodiversitetit dhe të klimës të mbeten një prioritet i rëndësisë Kombëtare.**

### 3.2 "Pergjegjesite Bashkiake dhe pjesemarrja qytetare" - Keshill Bashkiak

Ky takim u realizua me date 20/05/2016 dhe i organizuar nga Fondacioni Gjerman Konrad Adenauer dhe Friedrich Ebert sebashku me Bashkine Shkoder ne sallen e Keshillit Bashkiak. Ky takim u organizua si pjese e programit te ketyre dy fondazione mbi pergjegjesite bashkiake dhe pjesemarrjen qytetare. Sipas nje sondazhi, me mbi 800 te intervistuar vetem ne qytetin Shkoder, shprehet optimiste per transformimet qe kane fokus hapsirat publike dhe te gjelberta.
Nje vecori tjeter per te cilin u zgjodh Shkodra te behej ky takim ishte edhe fakti se Bashkia e ketij qyteti rezultoji si bashkia me niveli me te larte te informimit ne nivel te qeverisjes vendore ne rang republike. (ligji 119/2015 mbi "Te drejten e infomimit ne nivel te qeverisjes vendore").
Pas prezantimit te rezultatit, Keshilli Bashkiak diskutoji mbi menyrat te ndryshme qe mund te adresojne qytetaret persa i takon problemeve te ndryshme dhe afrimi i tyre ne axhenden e Keshillit Bashkiak.




(Salla  Keshillit Bashkiak Shkoder, 20 Maj)

### 3.3 "Financat Vendore" - Keshill Bashkiak Shkoder

Takimi mbi projekt buxhetin e Bashkise Shkoder e realizua nga Bashkia Shkoder me date 29 Mars 2016 ku ishin te ftuar anetare te Keshillit Bashkiak dhe qytetare te ndryshem. Takimi u realizua ne forme tematikash ku fjaline hyrese Znj. Ademi ja dedikoje rendesise se hapesirave publike dhe ndergjegjesimit te komunitetit. Me pas drejtorite perkatese, si ajo e sherbimeve social / menaxhimit te emergjencave etj, te Bashkise shfaqen programin Bashkiak mbi financat vendore. Nje risi e ketij programi ishte edhe 'Regjistri elektronik i bizneseve' i cili synon te lidh te ardhurat me sherbimet.Persa i takon zonave veriore te Bashkise Shkoder u ngrit shqetesimi se nuk ekziston nje sistem adresash.


TAKIM KONSULTATIV PER PROJEKT BUXHETIN 2016

Tema: Shërbimet Publike

Z./ Znj. ____________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Kemi kënaqësinë t'ju ftojmë në takimin konsultativ, me temë "Shërbimet publike", në kuadër të procesit për hartimin e projekt buxhetit të Bashkisë Shkodër, për vitin 2016.

Data: 29 Mars, 2016 - 11:00

Adresa: Salla e Konferencave, pranë Rektoratit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

Falenderojmë Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", që ndihmoi në procesin e prezantimit të Projekt Buxhetit, duke vënë në dispozicion sallën për takimin konsultativ.

(Ftese Publike e Bashkise Shkoder mbi Financat Vendore)

### 3.4 Mbi Menaxhimin e Emergjencave Natyrore. - Bashkia Shkoder

Ky takim u realizua me date 20/05/2016 si pjese e mbledhjes se informacioneve prane drejtorive lokale ne menyre te hartimit te nje strategjie sa me afer problematikave territoriale te lidhur me kontekste specifike dhe te vecanta ndermejt tyre. Rasti ne fjale eshte i referuar menaxhimit te emergjencave civile dhe atyre natyrore. Ne kete takim nje rendesi e vecante e shprehur nga z. Bushati (Drejtor i Emergjencave Civile, mbrojtjes dhe shpetimit nga zjarri) ju dha menaxhimit te situatave te emergjences.

Disa nga problematikat te cilat u ngriten jane te lidhura per bashkepunimin vertikal ndermjet institucioneve te ndryshme dhe pergjigjia ne menyre te sinkronizuar ne rrjete aktoresh. Persa i takon situatave te emergjencave rurale ku aksesi eshte pothuajse i pamundur apo i veshtire per tu arritur (zona malore, zona te permbytura) z. Bushati shprehet se bashkepunimi horizontal me shoqata apo banore lokale te ndryshme (si ajo e peshkatareve), ka qene mjaft i sukseshem.

Me tej, me Reformen e Re territoriale Bashkia Shkoder perballet me nje dimension me te ndryshem te emergjencave, nga ato qe kapin flukset turistike dhe infrastrukturore tek ato me rurale malore.

Me rritjen e ketyre dinamikave te emergjencave lind gjithashtu edhe nevoja e menaxhimit ne menyre sa me gjitheperfshirëse te aktore te ndryshem, ndaj edhe nevojat e ngritura nga kjo drejtori jane ato te shtimit te; punesuareve sa me te kualifikuar ne kete drejtori, te burimeve te financimit dhe gjithashtu te kalimit te kopetencave admnistrative ne menyre qe te kete pergjigje te menjehershme ndaj emergjencave.
Nje element tjeter i rendesise se emergjencave dhe menaxhimit te tyre ishte edhe zona pergjate bypassit perendimore. Pa u futur ne ceshtje teknike te bypassit, z.Bushati u shpreh se permbyjtja nga ngritja e nivelit te liqenit jo vetem qe shkakton me shume deme ekonomike dhe njerzore (per shkak te afersise nga qyteti) por mbi te gjitha zgjat me gjate ne hark kohore se permbytja e tokave pergjate lumenjve - e kjo per shkak te vete aftesise se rrembyeshme qe lumi Drin dhe Kir ka, per te dale me pas ne Bune.



(Bashkia Shkoder - Z. Ridvan Bushati Drejtor i Emergjencave Civile, Mbrojtjes dhe Shpetimit nga Zjarri)

### 3.5 Drejtoria e Basenit "Drin" e "Bune". – Z. Martin Pellumbi

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e segmentit hidrik natyrore ne Bashkine Shkoder Drin - Bune. Disa nga tematikat te folur ne kete takim jane qofte te sferes turistike dhe shfrytezimit te lumit Buna per qellime te tilla, por edhe ato te lidhura me menaxhimin dhe evitimin e situatave te emergjencave ujore natyrore. Perforecimi i argjinatures pergajte ketij segmenti ujore dhe rritja e aksesit per qellime rikreative ishin disa nga propozimet e z.Pellumbi.

### 3.6 Drejtoria e Bujqesise Shkoder. – Z.Fiqiret Xhabiaj

Ky takim u zhvillua si pjese e informimit mbi situaten e tokes bujqesore ne Bashkine Shkoder.
Ne kete takim 2 ishin tematikat e trajtuara ne menyre te vecante, njera persa i takon aftesise prodhuese te produkteve lokale dhe ajo pjese e lidhur me tregtimin e ketyre produkteve. Persa i takon aftesise prodhuese problematikat qe shfaq Bashkia e re Shkoder jane te lidhura me teknologjine e veshtire qe sektori i bujqesise has, dhe kosto e larte e karburantit qe reflekton me pas edhe kostot e ujitjes dhe te perpunimit te tokes. Pavaresisht puneve te kryera se fundi mbi thellimin e kanaleve kullues pergjate ish komunes Dajç dhe Programeve te ofruar nga Ministria e Bujqesise, ky sektor mbetet akoma ne ritme te avashte drejte shkalles rajonale te konkurrences dhe tregtimit te produktit bujqesore. Fragmentimi i tokes bujqesore ne parcela te vogla familjare ben qe ky sektor te mbetet akoma large idese se fermes - pavaresisht disa shembujve te mire qe mund te ndiqen e qe jan realizuar fale Bashkepunimit Internacional.

### 3.7 Drejtoria Rajonale e Mjedisit - Eduard Terthora

Ky takim u realizua me date 11 Maj 2016 si pjese e informimit mbi situaten e vendgrumbullimit te mbeturinave urbane (landfill) dhe menaxhimit te tyre. Ne kete takim u diskutua kryesisht si per sistemin e grumbullimit ashtu dhe per sfidat territoriale qe has Bashkia e re Shkoder pas Reformes Territoriale. Z. Therthora foli edhe per disa projekte pilot per te ekperimentuar por pa sukses mbi pika e grumbullimit dhe transferimit nga zonat me rural drejt landfillit.
Ky takim u shoqerua edhe me nje vizite ne vend-depozitimin e vjeter te Bashkise Shkoder, prane varrezave te Deshmoreve dhe pergjate lumit Kir.

**3.8 Autoriteti Rrugor Shqiptar (Simon Prendi/ Holta Dedaj)**
Takim konsultues me autoritetin rrugor Shqiptar. Në këtë takim u diskutua në lidhje me korridorin Adriatik Jonian dhe me Bypass të Shkodrës. Sipas ArrSh Adriatik Jonian do të hyjë në Shqipëri nga Muriqani dhe jo nga Han i Hotit sic eshte percaktuar ne PPK. Gjithashtu eshte diskutuar në kete takim edhe ne lidhje me bypass lindor dhe perendimor te Shkodrës. Një tjeter teme diskutimi ishte dhe rehabilitimi i rruges se velipojes ku Arrsh eshte ne proces hartimi te projektit teknik. Ky projekt do te pasqyrohet edhe ne planin e pergjithshem vendor.

**3.8 Planin për Zonën e Rëndësisë Kombëtaretë Alpeve** Referuar bashkërendimit të PPV Shkodër me Planin për Zonën e Rëndësisë Kombëtaretë Alpeve kemi marrë kontakt me drejtuesen e projektit Znj. Albana Dhimitri. Kontakti i parë ka qënë pozitiv por për faktin se eksperti kryesor i planit të alpeve nuk ndodhet në Shqipëri, u vendos që të organizohej një takim më i thelluar në një datë të dytë. Në këtë kontekst rezultatet e bashkërendimit do të reflektohen në planin e përdorimit të tokës si dhe në planin e masave për mjedisin gjatë fazës së tretë.

## Takime ndërkufitare

**4.1 Takimi Ndërkufitar Shkodër**
Ky takim u zhvillua në qytetin e Shkodrës. Pjesë e takimit ishin Ministria e Zhvillimit Urban/ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit/ Bashkia Shkodër/ Universiteti POLIS/ REC/ GIZ/ Bashkia Ulqin/ Ministria e Turizmit dhe Planifikimit Hapësinor Mal i Zi/ Studio CAU. Ky takim u zhvillua me ndërmjetësim të MZHU për harmonizimin e planeve. Në takim fillimisht u bë një prezantim nga pala malazeze për hartimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër dhe për Hartimin e Planit për Bashkitë përreth liqenit të Shkodrës. Pas prezantimit pati një diskutim dhe pyetje nga pala Shqiptare në lidhje me Korridorin Adriatik Ionian dhe akse të tjera lidhëse. Me prioritet u pa lidhja ujore nëpërmjet liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna. Gjithashtu lidhja Zogaj Virpazar me rrugë. U pa me rëndësi lidhja midis parqeve kombëtare si dhe lidhja me një rrugë të vogël shërbimi midis Ulqinit dhe Velipojës. U ngrit si problematikë ndotja e liqenit të Shkodrës dhe përmbytjet.

Pas prezantimit të palës malazeze, u zhvilluan disa prezantimi nga pala shqiptare ku fillimisht u prezantua nga AKPT plani i përgjithshëm kombëtar dhe PINS Bregdeti. Më pas nga Universiteti POLIS u prezantua një pjesë e strategjisë për PPV Shkodër. Në këtë pjesë pati disa diskutime të rëndësishme në lidhje me masat për përmbytjet dhe aksin lidhës Shkodër-Theth. Nga POLIS u prezantua dhe një koncept për të lidhur Thethin me Valbonën i cili pati debat veçanërisht me

përfaqësues të REC mbi llojin e rrugës. Në fund të takimit u zhvillua dhe një prezantim nga AA në lidhje me shkollën verore në Shkodër.

**4.2 Takime ndërkufitare (2)**

Keto takime u zhvilluan ne Podgorice, prane Center for Architecture and Urbanism (CAU), e angazhuar ne hartimin e Planit te Pergjithshem Vendore te Bashkise Ulqin dhe Planit per Liqenin e Shkodres.

Ne kete takim, ashtu si edhe ne Shkodër, u shfaq interes i larte nga ana e Bashkise Ulqin lidhja e fluksit turistik te bregdetit Malazez me ate Shqipetare, duke afruar gjithnje e me shum lidhjet infrastrukturore me zonat turistike si nje fluk i vazhdueshem nga Ulqini ne Velipoje e me pas per ne Shengjin. Lidhja e ketyre pikave turistike kaq te rendesishem per bregdetin Shqipetare, ashtu si edhe P.P.K udhezon, jo vetem qe do te sillte nje zhvillim me te qendrueshem turizmit ne keto njesi administrative por gjithashtu do te promovonte turizmin bregdetare ne mbeshtetje te komuniteteve qe jetojne ne keto zona - sipas strategjive te PINS Bregdetit.

Nje teme tjeter e cila u trajtua ishte gjithashtu edhe lidhja ujore, ajo pergjate ketyre vendbanimeve ne bregdet por edhe te atyre vendbanimive qe pershkojne Liqenin e Shkodres deri ne te dale te Lumit Buna.



**Komunikimi në internet dhe me media**

Përtej komunikimit me anë të degjesave publike grupi i punës së bashku me Bashkinë Shkodër kanë ndjekur dhe një fushatë informimi për komunitetin me anë të mediave online.

**5.1 Televizioni**

- Emision me prezencën e Besnik Aliaj dhe Sotir Dhamo

Pas zhvillimit të dëgjesës së parë publike është bërë një emision televiziv me pjesëmarrjen e Prof Besnik Aliaj dhe Dr Sotir Dhamo nga Universiteti POLIS. Në këtë emision janë shpjeguar hapat në të cilat do të kalojë plani si dhe gjetjet e para të analizave.

- Emision me prezencën e Ledio Allkja, Dritan Meta, Taulant Dibra

